



BANKA QENDRORE E REPUBLIKES SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 14





BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

# Raporti i Stabilitetit Financiar

Numër 14



**BOTUES**

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës  
Departamenti i Analizave Ekonomike dhe i Stabilitetit Financiar  
33 Garibaldi, Prishtinë 10000  
Tel: ++383 38 222 055  
Fax: ++383 38 243 763

**Faqja e internetit**

[www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

**Adresa elektronike**

[economic.analysis@bqk-kos.org](mailto:economic.analysis@bqk-kos.org)



**SHKURTESAT:**

AJN	Asetet e Jashtme Neto
APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATM	Bankomatë ( <i>anglisht: Automated Teller Machines</i> )
ATP	Agjensionet për Transferimin e Parave
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CIS	Commonwealth of Independent States
DST	Të Drejtat Speciale të Tirazhit
EJL	Evropa Juglindore
EQL	Evropa Qendrore dhe Lindore
FKPK	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
HHI	Indeksi Herfindahl-Hirschman
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IMF	Institucionet Mikro-Financiare
ISSB	Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar
KJP	Kreditë jo-performuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
KNK	Kthimi në Kapital
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
MeF	Ministria e Financave
MNI	Margjina Neto e Interesit
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OJSHEF	Organizatata Jofitimprurëse në Shërbim të Ekonomive Familjare
POS	Pika të Shitjes ( <i>anglisht: Point of Sales</i> )
pp	Pikë Përqindje
PPT	Përgjegjësia ndaj Palës së Tretë
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
RLI	Indeksi i Sundimit të Ligjit ( <i>angl.: Rule of Law Index</i> )
TMK	Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

**Vërejtje:** Përdoruesit e këtyre të dhënave kërkohen të citojnë burimin.  
Citimi i sugjeruar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2019),  
Raporti i Stabilitetit Financiar Nr. 14, Prishtinë.  
Çdo korrigjim i nevojshëm bëhet në versionin elektronik.





**PËRMBAJTJA:**

1. Fjala hyrëse e Guvernatorit -----	13
2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar-----	15
Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar-----	20
3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme -----	22
3.1. Ekonomia e brendshme-----	23
3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve -----	27
3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare -----	30
4. Zhvillimet në sistemin financiar -----	33
4.1. Aktiviteti bankar -----	34
Kutia 2. Anketa e Kreditimit Bankar-----	39
5. Rreziqet e sektorit bankar -----	43
5.1. Rreziku kreditor -----	45
Kutia 3. Përafrimi me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 9 -----	49
5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit-----	49
5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja-----	52
5.4. Kapitali -----	53
Kutia 4. Korniza rregullative mbi kërkesat për kapital-----	56
5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit -----	57
5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza stress-test-----	61
6. Institucionet financiare jo-bankare -----	68
6.1 Sektori Pensional-----	68
6.2 Sektori i Sigurimeve-----	70
6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar -----	74
7. Infrastruktura Financiare në Kosovë-----	79
7.1. Sistemi i Pagesave -----	79
Kutia 5. Korniza rregullative në funksion të stabilitetit financiar -----	81
8. Korniza për Makroprudencë -----	83
8.1. Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës -----	83
8.2. Kapitali shtesë kundërciklik -----	83
8.3. Bankat me rëndësi sistemike -----	86
9. Shtojca Statistikore -----	89

<b>LISTA E FIGURAVE</b>	<b>16</b>
Figura 1. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare	16
Figura 2. Ndryshimi vjetor i kredive të reja	16
Figura 3. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar	17
Figura 4. Harta e stabilitetit financiar	20
Figura 5. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje	23
Figura 6. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor	24
Figura 7. Shuma e borxhit të emetuar, ndryshim vjetor	25
Figura 8. Shuma e kërkuar dhe e emetuar e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës	25
Figura 9. Pjesëmarrja në letrat me vlerë, sipas afatit të maturitetit	25
Figura 10. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës	26
Figura 11. Pjesëmarrësit në ankande të letrave me vlerë	26
Figura 12. Mbajtësit e letrave me vlerë	26
Figura 13. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial	27
Figura 14. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë	27
Figura 15. Indeksi i besueshmërisë së biznesit	27
Figura 16. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja	28
Figura 17. Borxhi i ndërmarrjeve	28
Figura 18. Normat e interesit për ndërmarrjet	30
Figura 19. Borxhi i ekonomive familjare	30
Figura 20. Depozitat e ekonomive familjare	30
Figura 21. Normat e interesit për ekonomitë familjare	31
Figura 22. Peshat e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së	33
Figura 23. Pjesëmarrja në gjithsej asetet e sistemit financiar	33
Figura 24. Pronësia e segmenteve përbërës të sistemit financiar	34
Figura 25. Pjesëmarrja në strukturën e aseteve	35
Figura 26. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake	35
Figura 27. Stoku i gjithsej depozitave dhe depozitave të reja	36
Figura 28. Pozicioni neto ndaj jo-rezidentëve	36
Figura 29. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktiviteteve me jorezidentët	36
Figura 30. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare	36
Figura 31. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare	37
Figura 32. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë	37
Figura 33. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: ndërmarrjet	38
Figura 34. Pjesëmarrja në gjithsej kreditë: ekonomitë familjare	38
Figura 35. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve	39
Figura 36. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve	40
Figura 37. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet	40

Figura 38. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare -----	41
Figura 39. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare -----	41
Figura 40. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare -----	42
Figura 41. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriterëve të rreziqeve -----	43
Figura 42. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar -----	43
Figura 43. Rritja vjetore e kredive dhe kredive jo-performuese -----	45
Figura 44. Efekti i procesit të shlyerjeve (write-offs) -----	45
Figura 45. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit -----	46
Figura 46. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave -----	46
Figura 47. Kreditë jo-performuese -----	46
Figura 48. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve -----	47
Figura 49. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione -----	47
Figura 50. Koncentrimi i rrezikut kreditor -----	48
Figura 51. Struktura e profitit të sektorit bankar -----	49
Figura 52. Kontribuuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit -----	49
Figura 53. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit -----	50
Figura 54. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit -----	50
Figura 55. Struktura e të hyrave të sektorit bankar -----	50
Figura 56. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar -----	51
Figura 57. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	51
Figura 58. Hendeku kumulativ i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit -----	51
Figura 59. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit -----	52
Figura 60. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë -----	53
Figura 61. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj -----	53
Figura 62. Kapitalizimi i sektorit bankar -----	54
Figura 63. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit -----	54
Figura 64. Struktura e kapitalit rregullator -----	54
Figura 65. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej aseteve të sektorit -----	55
Figura 66. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut -----	55
Figura 67. Klasat e aseteve sipas peshës së rrezikut -----	55
Figura 68. Struktura e financimit -----	58
Figura 69. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar -----	58
Figura 70. Struktura e depozitave -----	58
Figura 71. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit -----	58
Figura 72. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive -----	59
Figura 73. Indikatorët e likuiditetit -----	60
Figura 74. Rezervat e likuiditetit -----	60
Figura 75. Hendeku i likuiditetit -----	61

Figura 76. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit, sipas skenarëve-----	62
Figura 77. Rezultatet e stres testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi -----	63
Figura 78. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit-skenari 1 -----	66
Figura 79. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit -skenari 2 -----	66
Figura 80. Asetet e sektorit pensional -----	68
Figura 81. Struktura e investimeve të sektorit pensional-----	68
Figura 82. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale -----	68
Figura 83. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës -----	69
Figura 84. Performanca financiare e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve -----	69
Figura 85. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve -----	70
Figura 86. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	70
Figura 87. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë-----	71
Figura 88. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve -----	71
Figura 89. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve -----	72
Figura 90. Primet bruto të arkëtuara -----	72
Figura 91. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara -----	73
Figura 92. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	74
Figura 93. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar -----	75
Figura 94. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit -----	75
Figura 95. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik -----	75
Figura 96. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve -----	76
Figura 97. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar -----	76
Figura 98. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar-----	76
Figura 99. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik-----	77
Figura 100. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	77
Figura 101. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar -----	77
Figura 102. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditorë -----	78
Figura 103. Hendeku i kreditimit -----	85
Figura 104. Kapitali shtesë kundër-ciklik-----	85
Figura 105. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike-----	86
Figura 106. Kriteri i madhësisë -----	86
Figura 107. Kriteri i zëvendësueshmërisë -----	87
Figura 108. Kriteri i ndërlidhjes -----	87
Figura 109. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit -----	88

<b>LISTA E TABELAVE</b>	<b>15</b>
Tabela 1. Rreziqet e sektorit bankar	15
Tabela 2. Vlerësimet dhe parashikimet e FMN- së për treguesit e zgjedhur makroekonomikë të partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës	22
Tabela 3. Treguesit e borxhit ndaj bankave dhe performancës së ekonomive familjare	32
Tabela 4. Numri i institucioneve financiare	34
Tabela 5. Rreziqet e sektorit bankar	44
Tabela 6. Supozimet e rrezikut kreditor	61
Tabela 7. Koeficienti i elasticitetit të normës së KJP-ve	62
Tabela 8. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor	65
Tabela 9. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit	66
Tabela 10. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit	67
Tabela 11. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit	73
Tabela 12. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së	79
Tabela 13. Rrjeti i sektorit bankar	80
Tabela 14. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela	81
Tabela 15. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë	86



## 1. Fjala hyrëse e Guvernatorit

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka kënaqësinë t'i prezantojë publikut numrin e 14-të të Raportit të Stabilitetit Financiar (RSF). Përmes një perspektive të analizës së bazuar në rrezik, RSF synon jo vetëm të informoj publikun mbi gjendjen e sistemit financiar, por edhe të rritë transparencën dhe të nxitë debatin profesional mbi zhvillimet dhe sfidat e sistemit financiar dhe infrastrukturës së tij.

Zhvillimet e jashtme me ndikim në stabilitetin financiar të Kosovës kanë qenë përgjithësisht të qëndrueshme, megjithëse rritja e pasigurive dhe rreziqet e shtuara për aktivitetin ekonomik dhe sektorin financiar të partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës janë reflektuar deri në një masë edhe në ekonominë e vendit.

Ekonomia e Eurozonës, si partneri kryesorë tregtar i Kosovës dhe vendi me origjinën më të lartë të remitencave, shënoi ngadalësim të rritjes ekonomike në vitin 2018 përderisa edhe prospektet për vitin 2019 nuk rezultojnë optimiste. Ballkani Perëndimor vlerësohet të ketë rritur aktivitetin ekonomik më shumë krahasuar me vitin paraprak, ndërkohë që prospektet për rritje në vitin 2019 janë më pesimiste si rezultat i reflektimit të pasigurive globale dhe pasigurive politike në shumë prej këtyre vendeve.

Stabiliteti financiar në Kosovë është ndikuar pozitivisht nga rritja ekonomike në Kosovë, që ndikoi në përmirësimin e pozicionit financiar të agjentëve ekonomik. Në vitin 2018, ekonomia e Kosovës shënoi rritje të qëndrueshme, dinamike që pritet të vazhdojë edhe në vitin 2019. Sidoqoftë, prospektet për rritje mund të ndikohen negativisht nga rritja e rreziqeve të jashtme dhe atyre të brendshme gjatë vitit 2019 si zgjerimi i vazhdueshëm i deficitit fiskal; rritja e shpenzimeve rrjedhëse të ndikuara nga presionet në skemat sociale dhe Ligji i ri i pagave; rritja e çmimeve në vend si pasojë e rritjes së çmimeve në nivel global si dhe vendimit për taksën 100% ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina si dhe rritja e deficitit

tregtar. Për vitin 2019, projeksionet fillestare sugjeruan për një rritje mesatare të BPV-së prej 4.2 përqind. Megjithatë, materializimi potencial i rreziqeve të përmendura më sipër sinjalizojnë për prospekte më pesimiste për vitin 2019.

Stabiliteti makroekonomik dhe një mjedis me kushte të favorshme të financimit ka mbështetur rritjen e kreditimit për sektorin privat edhe gjatë vitit 2018. Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portfolios kreditore, rritja e konkurrencës, fokusi strategjik në segmente të caktuara të tregut nga bankat, si dhe përvoja më e gjatë në ndërtim të raporteve me klient ishin faktorë tjerë që vazhduan të mbështesin ndërmjetësimin financiar në ekonomi.

Gjatë vitit 2018, sektori bankar ka operuar në një ambient përgjithësisht të favorshëm, me rreziqe të ulëta dhe kapacitet të kënaqshëm për përballimin e goditjeve të mundshme. Treguesit e performancës dhe shëndetit të sektorit bankar qëndrojnë në nivele të larta, përkundër rënies së lehtë në vitin 2018.

Në vitin 2018, sektori pensional i Kosovës ka rritur dukshëm ekspozimin në tregun e brendshëm përmes investimit në Letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, depozitave në sektorin bankar dhe parave të gatshme. Orientimi i investimeve në tregun e brendshëm kryesisht i'u atribuua rritjes së pasigurive politike dhe prospekteve pesimiste për rritje ekonomike në nivel global, dinamika që u reflektuan në performancën e tregjeve të jashtme financiare në vitin 2018 dhe për pasojë në performancën negative financiare që regjistroi sektori pensional në Kosovë.

Tërheqja nga tregu e një prej siguruesve jetë u reflektua në zvogëlimin e aseteve të sektorit të sigurimeve në vitin 2018. Megjithatë, ky sektor mbylli edhe këtë vit me rezultat pozitiv financiar. Me rritje të përsheptuar të aktivitetit dhe performancë të lartë është karakterizuar sektori mikrofinanciar.

Në funksion të zhvillimit të sektorit financiar dhe ruajtjes së stabilitetit financiar, gjatë vitit 2018, BQK ka vazhduar progresin drejtë avancimit të kornizës rregullative dhe

infrastrukturës financiare. Gjithashtu, infrastruktura financiare ka vazhduar zgjerimin dhe avancimin teknologjik, duke rritur shtrirjen dhe përdorimin, me theks të veçantë në shërbimet elektronike dhe ato të automatizuara.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka vazhduar punën për operacionalizimin e Politikës për Makroprudencë, e cila u adaptua

në vitin 2016 me qëllim të identifikimit, monitorimit dhe vlerësimit të rrezikut sistematik në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar. Në vitin 2018, zhvillimet e përgjithshme të indikatorëve makroprudencë në Kosovë ishin të qëndrueshme, pa ndonjë kërcënim për stabilitetin financiar të vendit.

Fehmi MEHMETI

Guvernator



## 2. Përmbledhja e rreziqeve dhe zhvillimeve kryesore të stabilitetit financiar

*Zhvillimet në ambientin makroekonomik kanë vazhduar të jenë të favorshme gjatë vitit 2018, duke mbështetur qëndrueshmërinë e sektorit financiar të Kosovës.* Sidoqoftë, gjysma e dytë e vitit është karakterizuar me rritje të pasigurive në nivel

global. Rreziqet e shtuara në ekonominë dhe tregjet e jashtme financiare, kryesisht si rezultat i konflikteve të vazhdueshme tregtare, shtrëngimit të kushteve të financimit dhe negociatave lidhur me Brexit, pritet të vazhdojnë duke rritur rrezikun për aktivitetin ekonomik dhe sektorin financiar të partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës, me ndikim potencial negativ edhe në ekonominë dhe stabilitetin financiar në vend.

**Tabela 1. Rreziqet e sektorit bankar \***

Rreziqet	Gjysma I-rë 2017	Gjysma II-të 2017	Gjysma I-rë 2018	Gjysma II-të 2018	Trendi i rrezikut
Rreziku makroekonomik					↑
Pozicioni financiar i sektorit jo-financiar					↑
Zhvillimet kreditore					↑
Qëndrueshmëria e sektorit bankar					↑
Rrezik i papërfillshëm	Rrezik i ulët	Rrezik i mesëm	Rrezik mbi mesatar	Rrezik i lartë	

Burimi: BQK (2019)

\*Metodologjia e ndërtimit të tabelës së rrezikut bazohet në metodologjinë e Hartës së Stabilitetit Financiar të Kosovës. Për dallim, në ndërtimin e kësaj tabele është shtuar treguesi i Zhvillimeve kreditore, që përfshinë nën-treguesit si: Hendeku i kreditimit ndaj BPV-së, Rritja e kreditimit të sektorit privat, Raporti i kredisë së sektorit privat ndaj BPV-së, si dhe rritjen në sektorët e veçantë si ai i ndërmarrjeve dhe atë të ekonomive familjare. Në llogaritjen e Qëndrueshmërisë së sektorit bankar, përveç treguesve të hartës si Struktura, Kapitalizimi dhe Përfitueshmëria, Likuiditeti dhe Financimi, është shtuar edhe treguesi i Ekspozimeve, i cili matë ekspozimet e sektorit bankar ndaj letrave me vlerë të qeverive, kreditë në valutë, pjesëmarrjen e detyrimeve të jorezidentëve si dhe pozicionet e hapura në valutë.


Ekonomia e Eurozonës, si partneri kryesorë tregtar i Kosovës dhe vendi me origjinën më të lartë të remitencave, ngadalësoi rritjen ekonomike. Në vazhden e pasigurive të shtuara të reflektuara në rënien e besueshmërisë së bizneseve dhe individëve, pritet për vitin në vijim janë që aktiviteti ekonomik të vazhdojë ngadalësimin. Ballkani Perëndimor vlerësohet të ketë rritur aktivitetin ekonomik më shumë krahasuar me vitin paraprak, ndërkohë që prospektet për rritje në vitin 2019 janë më pesimiste si rezultat i reflektimit të pasigurive globale dhe pasigurive politike në shumë prej këtyre vendeve. Ekonomia e Kosovës shënoi rritje të qëndrueshme, e cila pritet të vazhdojë edhe në vitin 2019. Sidoqoftë, prospektet për rritje mund të ndikohen negativisht nga rritja e rreziqeve të jashtme, si dhe atyre të brendshme siç janë: zgjerimi i vazhdueshëm i deficitit fiskal; rritja e shpenzimeve rrjedhëse të ndikuara nga presionet në skemat sociale

dhe Ligji i ri i pagave; rritja e çmimeve, të cilat filluan tendencën ngritëse qysh në tremujorin e fundit të vitit 2018, duke iu atribuar rritjes së çmimeve në nivel global si dhe vendimit për taksën 100% ndaj produkteve të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

***Borxhi i sektorit privat ka vazhduar rritjen, të mbështetur nga rritja dyshifrore e kreditimit të brendshëm, si dhe rritja e borxhit të jashtëm.*** Stabiliteti makroekonomik si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portfolios kreditore, në një ambient të kushteve të favorshme të financimit, ka mbështetur rritjen e kreditimit për sektorin privat. Rritja e konkurrencës, fokusi strategjik në segmente të caktuara të tregut nga bankat, si dhe përvoja më e gjatë në ndërtim të raporteve me klient ishin faktorë tjerë që vazhduan të mbështesin kreditimin dyshifrorë të sektorit. Kreditë e ndërmarrjeve nga sektori bankar u rritën për 11.0 përqind,

por që trendi i rritjes së kredive të reja u ngadalësua në 4.9 përqind nga 34.7 përqind në vitin 2017.

**Figura 1. Borxhi i ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare**



Burimi: BQK (2019)


Kreditë e ndërmarrjeve nga ndërmjetësit tjerë financiarë shënuan rritje prej 21.4 përqind, por që mbesin me peshë të vogël në gjithsej borxhin e ndërmarrjeve në rreth 2.7 përqind. Borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve vazhdoi rritjen dhe arriti në 21.5 përqind të gjithsej borxhit. Raporti i kredisë së ndërmarrjeve nga bankat ndaj BPV-së arriti në 26.9 përqind në dhjetor 2018 (nga 25.4 përqind një vit më parë).

Kreditë e sektorit bankar ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 11.2 përqind, ndërsa kreditë nga institucionet mikrofinanciare u rritën për 31.2 përqind (duke arritur në 12.1 përqind të vlerës së kredive nga bankat). Borxhi i jashtëm i ekonomive familjare shënoi rritje prej 13.1 përqind dhe arriti në 4.1 përqind të gjithsej borxhit. Në dhjetor 2018, gjithsej borxhi i ekonomive familjare është rritur për 13.0 përqind dhe si përqindje e BPV-së arriti në 16.7 përqind. Përkundër rritjes, nivelet e borxhit të sektorit privat në raport me BPV-në mbetën më të ulëta në rajon.

**Raporti i vlerës së kredisë së sektorit bankar ndaj vlerës së kolateralit, si dhe borxhi ndaj të hyrave, mbesin relativisht të ulëta në 36.3 dhe 38.3 përqind respektivisht. Sidoqoftë, rreziqet e sektorit bankar nga sektori privat, megjithëse të ulëta, kanë treguar tendencë rritëse.** Sektori i ndërmarrjeve është karakterizuar me rënie të lehtë të vëllimit të prodhimit industrial, përderisa tregtia ka shënuar rritje. Treguesi i klimës, si dhe i besueshmërisë së

biznesit, kanë shënuar rënie në vitin 2018, që sugjeron për performancë më të dobët si dhe pritje më pesimiste rreth aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve. Në anën tjetër, vendimi për vendosjen e taksës 100% ndaj produkteve të Serbisë si dhe Bosnjës e Hercegovinës ka shfaqur pasiguri rreth performancës së ndërmarrjeve me ndjeshmëri ndaj importeve nga këto vende, si dhe për efektet tjera që mund të shfaqen në ekonomi, si rritja e çmimeve, etj.

**Figura 2. Ndryshimi vjetor i kredive të reja**



Burimi: BQK (2019)

Rreziku ndaj bankave nga sektori i ekonomive familjare gjithashtu ka shfaqur tendencë rritëse. Kushtet në tregun e punës nuk kanë shfaqur përmirësim; përkundrazi, tregu i punës po ballafaqohet edhe me sfidën e reduktimit të fuqisë punëtore si rrjedhje e interesimit të lartë të fuqisë punëtore për pajisje me viza pune sidomos për vendet e Eurozonës. Remitencat kanë ngadalësuar trendin e rritjes, dhe mund të ngadalësohen tutje si rezultat i prospekteve më të ulëta për rritje në eurozonë. Andaj, në rrethana të tilla që nuk sugjerojnë për rritje të burimeve të të hyrave, rritja e lartë e kredive për sektorin e ekonomive familjare, mund të paraqes rrezik të ngarkesës me borxh. Në veçanti, segmenti më i ndjeshëm mund të jenë kreditë konsumuese të pakolateralizuara dhe me afat më të gjatë të maturimit, tek të cilat mund të materializohet rreziku eventual sidomos në rast të materializimit të pasigurive të shtuara politike apo kushteve jo të favorshme makroekonomike.

**Treguesit e performancës dhe shëndetit të sektorit bankar qëndrojnë në nivele të larta, përkundër rënies së lehtë në vitin 2018.** Profiti i sektorit bankar vazhdoi rritjen,


të ndikuar kryesisht nga rritja e të hyrave neto të interesit që u gjeneruan si rezultat i rritjes së volumit të kredive. Presionet mbi profitabilitetin e sektorit pritet të rriten, duke marrë për bazë zhvillimet në norma të interesit të cilat pritet të shtojnë presionin mbi ngushtimin e margjinës së interesit. Rritja e vazhdueshme e konkurrencës do të vazhdojë presionin për ulje të normës së interesit në kredi, megjithëse rënia e theksuar e normës së kredisë konsiderohet të ketë maturuar. Në anën tjetër, lufta për tërheqje të depozitave është intensifikuar, sidomos tek bankat me bazë më të ulët të depozitave dhe qasje më të vështirë në burime të jashtme të financimit, duke ndikuar në ngritjen e kostos së financimit. Rritja e lartë e kreditimit në këtë periudhë, në masë të madhe është ndikuar nga lehtësimi i standardeve përmes zgjatjes së maturimit dhe normës më të ulët, andaj vazhdimi potencial i këtij trendi mund të paraqesë sfidë për stabilitetin e nivelit të profitit. Rritja e kostos së financimit, ndikuar nga presionet e konkurrencës në tërheqjen e depozitave apo nga rritja e mundshme e normave të interesit në nivel global në afat të mesëm, mund të ndikoj në rritjen e mëtejme të presionit të shpenzimeve të sektorit, meqë kategoria kryesore e aseteve, kreditë, janë kontraktuar me normë fikse të interesit dhe kanë maturitet më të gjatë. Kjo situatë do të nxitë nevojën për ndryshime eventuale në strukturën e aseteve dhe detyrimeve të sektorit për menaxhim efektiv të rrezikut, si dhe pritet të intensifikoj tutje përpjekjet për rritjen e efikasitetit të kostove dhe digjitalizimit.

**Cilësia e portfolios kreditore ka vazhduar përmirësimin, ndikuar nga procesi i shlyerjes së kredive joperformuese nga bilancet e bankave, si dhe nga faktorët tjerë ekonomik e strukturor që kanë përmirësuar aftësinë paguese dhe mbledhëse të borxheve.** Raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive të sektorit bankar u zvogëlua në 2.7 përqind nga 3.1 përqind në vitin 2017. Rritja e stokut të kredive prej 10.9 përqind dha efekt më të lartë në rënie e raportit të KJP-ve se sa rënia e stokut të kredive jo performuese për 4.6 përqind. Sektori i ndërmarrjeve u karakterizua me përmirësim të cilësisë së portfolios kreditore në pothuajse të gjitha

veprimtaritë ekonomike. Ndërsa, ekonomitë familjare u karakterizuan me rritje të stokut të kredive joperformuese, por e cila nuk u reflektua në normën e KJP-ve për shkak të rritjes më të lartë të stokut të kredive për këtë sektor.

**Pozita e kapitalit të sektorit vazhdon të reflektoj qëndrueshmëri të lartë.** Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u zvogëlua në 17.0 përqind nga 18.1 përqind.

**Figura 3. Tregues të përzgjedhur të shëndetit financiar**



Burimi: BQK (2019)

Kjo rënie reflekton rritjen e aseteve të peshuara me rrezik si pasojë e rritjes së aktivitetit kreditor, krahas rritjes më të ngadalshme të kapitalit rregullator që u ndikua edhe nga shpërndarja e dividendës nga disa banka. Sektori bankar ka bazë të fortë të kapitalit rregullator, 91 përqind e të cilit është kapital i klasit të parë, që kryesisht rezulton nga profiti i lartë i realizuar dhe ai i mbajtur. Gjenerimi i kapitalit nga burimet e brendshme, profiti, është element i rëndësishëm që në vazhdimësi siguron mirëmbajtjen e nivelit të lartë të kapitalizimit.

**Indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për stabilitet të likuiditetit bankar.** Depozitat e sektorit privat shënuan rritje të përsheptuar prej 7.5 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së depozitave të ekonomive familjare. Në nivel sektori, depozitat tejkalojnë kreditë për 122.0 përqind. Megjithë rritjen më të shpejtë vjetore të depozitave në vitin 2018, raporti i depozitave ndaj kredive u zvogëlua për 2.5 pikë përqindje, nën ndikimet e zgjerimit më të shpejtë të aktivitetit kreditues. Asetet likuide shënuan rritje, që u reflektua gjithashtu në rritjen e raportit të tyre ndaj detyrimeve

afatshkurtra në 38.5 përqind, lartë mbi minimumin rregullator prej 25 përqind. Bilanci i rezervave të likuiditetit të bankave komerciale në BQK vazhdon të tejkalojë rezervën e obliguar për 49.7 përqind, përkundër normës negative të interesit në tepriçën e rezervës. Ambienti i normave të ulëta të interesit ka vazhduar të inkurajoj ekonomitë familjare të zhvendosin depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të përsheptimit të kreditimit afatgjatë rezultoi në theksimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve. Rritja në vazhdimësi e pjesëmarrjes së depozitave të transferueshme dhe zgjerimi i hendekut për periudhën afatshkurtër rritë ekspozimin e sektorit ndaj rrezikut të financimit në rast të tërheqjes së papritur të depozitave, apo lëvizjen e tyre ndërmjet bankave. Një situatë e tillë mund të paraqes sfidë edhe për menaxhimin e likuiditetit të bankave, pavarësisht nivelit aktual të lartë të mjeteve likuide. Kjo marrë parasysh tregun jo të zhvilluar financiar në Kosovë që mund të vonojë shndërrimin e këtyre mjeteve, si p.sh. letrave me vlerë, në mjete të gatshme financiare, si dhe mungesën e instrumenteve të politikës monetare si rezultat i eurorizimit.

***Avancimet teknologjike në fushën e financave, ndër tjera, kanë bërë sektorin më të ndjeshëm ndaj sulmeve të mundshme dhe gabimeve në sisteme, duke ngritur ekspozimin ndaj rrezikut operacional.*** Kërkesat për ndarje të kapitalit për rrezik operacional janë rritur, ndaj dhe niveli i mbajtjes së kapitalit për rrezik operacional në sektorin bankar të Kosovës ka shënuar rritje të qëndrueshme ndër vite. Bankat kanë krijuar sistem, politika dhe procedura të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut operacional, përfshirë blerjen e policave të sigurimit për transferim të këtij rreziku tek palët e treta. Andaj, përkundër rritjes së vazhdueshme të këtij rreziku, që u manifestua edhe me shtim të plaçkitjeve në degë të disa bankave, menaxhimi i këtij rreziku në vitin 2018 ishte adekuat, duke izoluar pasojat e tij.

***Sektori pensional u karakterizua me ngadalësim të rritjes, si rezultat i kthimit negativ nga investimet.*** Rritja e pasigurive

politike, shtrëngimi i kushteve të financimit si dhe prospektet pesimiste për rritje ekonomike në nivel global, ndikuan performancën e tregjeve të jashtme financiare, në të cilat sektori pensional i Kosovës ka ekspozim të lartë. Performanca e këtyre tregjeve gjatë vitit u karakterizuan me luanje ekstreme, duke mbyllur vitin me rënie të theksuar, e cila ndikoi që edhe sektori pensional i Kosovës të mbyllë vitin me humbje. Pasiguritë që po vazhdojnë rreth zhvillimeve në tregjet e jashtme financiare ndikuan që sektori pensional i Kosovës të rrisë ekspozimin në tregun e brendshëm në 27 përqind të gjithsej aseteve të tij nga 10.2 përqind një vit më parë, përmes investimit në Letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës, depozitave në sektorin bankar dhe parave të gatshme. Kontribut pozitiv në rritje të aseteve të sektorit në vitin 2018 kishte ecuria pozitive e kontributeve, që vazhdoi të ketë diferencë të lartë pozitive mes kontributeve të reja në raport me kontributet e paguara.

***Sektori i sigurimeve u karakterizua me rënie të lehtë të asteve, si dhe me nivel më të ulët të profitit.*** Asetet e sektorit të sigurimeve u ndikuan negativisht nga tërheqja nga tregu i një prej siguruesve jetë. Primet e shkruara kanë vazhduar rritjen, mirëpo rezultati më i ulët financiar në raport me vitin e kaluar pasqyron rritjen më të lartë të dëmeve të ndodhura. Asetet e sektorit të sigurimeve vazhdojnë të kenë pjesëmarrje të ulët prej 2.8 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar. Sektori vazhdon të jetë i koncentruar kryesisht në sigurime jo-jetë, respektivisht sigurime të detyrueshme ndaj palës së tretë. Niveli i penetrimit prej 1.4 përqind (primet e shkruara bruto në raport me BPV-në) vlerësohet relativisht i ulët, sidomos krahasuar me vendet e BE-së, duke reflektuar potencial për zhvillim të mëtutjeshëm.

***Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar ka vazhduar rritjen e përsheptuar, të ndikuar kryesisht nga rritja e theksuar e kreditimit, i cili kryesisht financohet nga huamarrjet në sektorin e jashtëm.*** Përkundër rritjes së shpejtë, pesha e tij në nivelin e ndërmjetësimit financiar mbetet e ulët, në 4 përqind të aseteve të gjithsej sistemit financiar. Kreditimi shënoi rritje vjetore prej 27.7 përqind, të orientuar më

shumë në sektorin e ekonomive familjare. Normat e larta të interesit me të cilin karakterizohet ky sektor, në mesatare shënuan rënie të lehtë, megjithëse kishte dallime të mëdha në normën e interesit ndërmjet institucioneve dhe produkteve. Performanca e këtij sektori ishte më e larta që u shënuar në gjashtë vitet e fundit, si rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi.

***Korniza ligjore, rregullative dhe infrastruktura financiare kanë vazhduar progresin në funksion të zhvillimit të sektorit financiar dhe ruajtjes së stabilitetit financiar.*** Gjatë vitit 2018, BQK ka vazhduar punën në plotësimin dhe avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative të sistemit financiar në përgjithësi dhe sektorit

bankar në veçanti, duke kontribuar në përafrimin e kornizës rregullative me standarde ndërkombëtare me funksion të shtuar në ruajtjen e stabilitetit financiar. Gjithashtu, është vazhduar puna në rishikimin e kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme për të përmirësuar informacionin në këtë fushë me peshë të madhe në stabilitetin e sektorit financiar, si dhe në rishikimin e rregullativës në sistemin e pagesave për të reflektuar rëndësinë sistemike të sistemit të pagesave.

Infrastruktura financiare ka vazhduar zgjerimin dhe avancimin teknologjik, duke rritur shtrirjen dhe përdorimin, me theks të veçantë në shërbimet elektronike dhe ato të automatizuara.



### Kutia 1. Harta e Stabilitetit Financiar


Harta e stabilitetit financiar<sup>1</sup> paraqet zhvillimet në treguesit kryesor të rreziqeve ndaj stabilitetit të sektorit bankar të Kosovës (figura 4). Viti 2018 në mesatare është karakterizuar me nivel të ngjashëm rreziku ndaj stabilitetit financiar nga ambienti makroekonomik, por me tendencë rritjeje në fund të vitit të rrezikut nga ekonomia e jashtme. Rreziku nga veprimtaria e agjentëve ekonomikë si ndërmarrjet, ekonomitë familjare si dhe sektori qeveritar është rritur lehtësisht, tendencë kjo që është identifikuar edhe në tremujorin e fundit të vitit, me përjashtim të sektorit të ndërmarrjeve që ka shfaqur rënie rreziku në TM4. Treguesit e brendshëm të qëndrueshmërisë së sektorit kanë reflektuar zhvillime të ndryshueshme. Kapitalizimi dhe profitabiliteti i sektorit është karakterizuar me rritje të lehtë të notës së rrezikut, por me tendencë rënese në fund të vitit. Ndërsa, rreziku nga struktura e sektorit bankar ka shënuar rënie gjatë gjithë vitit, me tendencë edhe më të theksuar rënese në tremujorin e fundit. Pozita e likuiditetit dhe financimit ka vazhduar ritmin rritës të rrezikut, por që kjo tendencë është ndërprerë në tremujorin e fundit të vitit 2018 ku nota e rrezikut ka shënuar rënie krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Përfundimisht, shumica e treguesve qëndrojnë nën apo afër nivelit të rrezikut mesatar historik, me përjashtim të treguesit të likuiditetit dhe financimit.<sup>2</sup>

Rritja ekonomike e përshpejtuar e vendeve partnere tregtare të Kosovës në vitin 2018, së bashku me rënien e papunësisë në vendet me koncentrimin më të lartë të dërgesave të remitencave, kanë dhënë kontributin pozitiv në rënien e notës së rrezikut nga ambienti i jashtëm makroekonomik. Ndërsa, zhvillimet në të gjithë treguesit e tjerë të ekonomisë së jashtme si çmimet e naftës, prospektet për aktivitetin ekonomik në Evropë sipas Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim në Evropë, si dhe normat bazë të interesit, ishin më pak të favorshme dhe ndikuan në rritjen e rrezikut duke neutralizuar kështu efektin pozitiv të rritjes ekonomike dhe papunësisë. Sidoqoftë, tremujori i fundit i vitit 2018 është karakterizuar me tendencë rritëse të rrezikut ndaj stabilitetit financiar nga

ekonomia e jashtme, të ndikuar kryesisht nga prospektet më pesimiste për aktivitetin ekonomik në Evropë si dhe nga ngadalësimi i rritjes së ekonomive të eurozonës.

Ekonomia e Kosovës ka shënuar përshpejtim të rritjes dhe hendek pozitiv të prodhimit në vitin 2018, duke ndikuar pozitivisht në notën e rrezikut.

Figura 4. Harta e stabilitetit financiar



Burimi: BQK (2019)

Në anën tjetër, deficitin më të lartë tregtar i reflektuar në raport më të lartë negativ të bilancit të llogarisë rrjedhëse ndaj BPV-së, së bashku me rënien e mesatares së normës reale efektive të këmbimit të euros në tre tremujorët e parë të vitit, kontribuan në rritje rreziku. Treguesit e tjerë të ekonomisë së brendshme u karakterizuan me zhvillime pozitive në kontekst të stabilitetit financiar dhe së bashku me rritjen më të shpejtuar ekonomike neutralizuan efektin e rritjes së rrezikut nga faktorët e mësipërm. Borxhi i jashtëm ndaj BPV-së shënoi rënie si rezultat i stokut më të ulët të borxhit si dhe rritjes më të lartë të BPV-së. Presionet inflacioniste, në mesatare ishin më të ulëta në vitin 2018 se në vitin paraprak, por që në tremujorin e fundit të vitit treguan tendencë rritëse të ndikuar nga vendosja e taksës ndaj mallrave të importuara nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina.

Sektori i ekonomive familjare dhe i ndërmarrjeve u karakterizuan me rritje të rrezikut. Kreditimi për ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet vazhdoi rritjen më të lartë në raport me BPV-në. Kjo ndikoi që hendeku i kreditimit ndaj BPV-së për këta sektorë të kaloj nga rrafshi negativ në atë pozitiv, që njëherit u reflektua me rritje të lehtë të notës së rrezikut. Në anën tjetër, cilësia e portfolios

<sup>1</sup> Harta e Stabilitetit Financiar prezanton në mënyrë grafike lëvizjen e shkallës së rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut ndaj stabilitetit financiar në sektorin bankar të Kosovës si dhe mundëson krahasimin me notën mesatare historike të rrezikut për kategoritë përkatëse. Rritja e distancës nga qendra e hartës për treguesit reflekton rritje të rrezikut dhe zvogëlim të aftësisë për përballimin e goditjeve ndaj stabilitetit financiar dhe anasjelltas. Metodologjia e plotë e modelit të Hartës së Stabilitetit Financiar

për Kosovën, i cili ka pësuar revidime të vazhdueshme në tregues dhe mënyrën e tyre të llogaritjes, paraqitet në Materialin Studimor të BQK-së Nr. 6.

<sup>2</sup> Ecuria e rrezikut nga treguesit e Hartës së Stabilitetit Financiar dhe kontributi i komponentëve përbërëse në nivelin përkatës të rrezikut paraqitet në Shtojcën 1.

kreditore vazhdoi trendin e përmirësimit në të dy sektorët, duke dhënë kontribut në rënien e rrezikut për stabilitet financiar. Zhvillim tjetër me efekt pozitiv për sektorin e ekonomive familjare ishte mesatarja më e ulët e papunësisë përgjatë vitit 2018, por që në tremujorin e fundit të vitit shfaqti tendencë rritëse. Ndërsa treguesi i trendit të remitencave, që paraqesin burim të rëndësishëm të të hyrave të sektorit, u karakterizua me rënie si rezultat i normës më të ulët të rritjes vjetore të remitencave. Në kuadër të sektorit të ndërmarrjeve, treguesi i indeksit të qarkullimit industrial, vlera e shtuar e sektorit të tregtisë në BPV-në, si dhe treguesi i besueshmërisë së bizneseve treguan rënie duke reflektuar aktivitet të ngadalësuar me vitin paraprak. Komponenti i vetëm që shënoi përmirësim krahas cilësisë së portfolios kreditore ishte bilanci neto i bizneseve të regjistruara dhe mbyllura gjatë kësaj periudhe.

Rreziku nga sektori qeveritar shënoi ngritje të lehtë. Zhvillimet kryesore që ndikuan në rritje rreziku përfshijnë rritjen e primit të rrezikut sovran, që reflekton rritjen e diferencës mes normës së bonove të thesarit të qeverisë Gjermane dhe asaj të Kosovës, rritjen e madhësisë së borxhit publik, si dhe rritjen e raportit të bilancit buxhetor negativ ndaj BPV-së. Në anën tjetër, zhvillimet me ndikim pozitiv përfshijnë rënien e kostos së borxhit, si dhe rritjen e vazhdueshme të të hyrave tatimore, që është reflektuar me nivelin ndër më të lartët të raportit të të hyrave tatimore ndaj BPV-së dhe rrjedhimisht është karakterizuar me notë të ulët të rrezikut.

Treguesi i strukturës ka pësuar ndryshimin më të theksuar në notën e rrezikut, e cila është karakterizuar me rënie si rezultat i zhvillimeve pozitive në të gjithë komponentët përbërës. Përmirësimi më i theksuar është shënuar në komponentin e devijimit negativ ndaj normës mesatare të kapitalizimit të sektorit, që nënkupton që bankat kanë konvergjuar drejt mesatares së normës së kapitalizimit të sektorit, kjo si rezultat i rritjes së normës së kapitalizimit të bankave më të vogla krahas rënies së normës mesatare të kapitalizimit të sektorit. Zhvillimet tjera pozitive përfshijnë rënien e shkallës së koncentrimit të aseteve të tri bankave më të mëdha, rënien e koncentrimit të portfolios kreditore të ndërmarrjeve, diversifikimin më të lartë të portfolios së përgjithshme kreditore si dhe të burimeve të financimit të bankave.

Pozita e kapitalizimit dhe profitabilitetit të sektorit, megjithëse e favorshme përgjatë gjithë vitit, ka shënuar rënie krahasuar me vitin paraprak. Norma

e kapitalizimit të sektorit ka shënuar rënie, duke zvogëluar diferencën ndaj normës minimale rregullative. Raporti i të hyrave neto nga interesi ndaj aseteve të sektorit, në mesatare, ka shënuar rënie, si rezultat i rritjes më të lartë të aseteve të sektorit në raport ndaj rritjes së të hyrave neto nga interesi. Sidoqoftë, në tremujorin e katërt, tendenca e këtij treguesi ishte pozitive. Ngjashëm, profiti para tatimit i sektorit është rritur gjatë kësaj periudhe me ritëm më të ngadalshëm se asetet, duke dhënë gjithashtu kontribut negativ në notën e rrezikut. Ekspozimet e mëdha të sektorit në raport ndaj kapitalit të klasit të parë, në mesatare gjatë vitit 2018 ishin më të mëdha, por që në tremujorin e fundit të vitit shënuan rënie. Komponentët me efekt pozitiv në treguesin e kapitalizimit ishin rritja e raportit të kapitalit aksionar ndaj aseteve të sektorit, së bashku me përmirësimin e vazhdueshëm të portfolios kreditore.

Rritja e përshpejtuar e kreditimit në raport me rritjen e depozitave, si dhe zgjerimi i hendekut të likuiditetit janë ndër kontribuuesit kryesorë në rritjen e rrezikut të treguesit të likuiditetit dhe financimit të sektorit. Rritja më e shpejtë e kreditimit ka ndikuar në rritjen e treguesit të kredisë ndaj depozitave, që është reflektuar me normë më të lartë të rrezikut. Kjo, së bashku me ambientin me norma të ulëta të interesit që ka nxitur migrimin e depozitave drejt kategorive me maturitet më të ulët, kanë ndikuar në thellimin e hendekut të likuiditetit për asetet dhe detyrimet deri në 3 muaj. Raporti i likuiditetit, në mesatare në vitin 2018 ishte më i ulët se vitin paraprak, por që në tremujorin e fundit të vitit raporti ka shënuar rritje. I vetmi komponentë me efekt zbutës në rrezikun e treguesit ishte rritja vjetore më e lartë e depozitave krahasuar me vitin paraprak, që është zhvillim pozitiv në kontekst të qëndrueshmërisë së burimeve të financimit. Duhet theksuar se niveli i rrezikut më të lartë të treguesit të likuiditetit dhe financimit krahas mesatares historike reflekton në masë të madhe natyrën e komponentëve të përfshirë në tregues si norma e rritjes së depozitave të ekonomive familjare e cila ishte e lartë në fillimet e funksionimit të sektorit dhe natyrshëm ka ndjekur trend rënës si rezultat i zhvillimit të sektorit dhe maturimit të rritjes së depozitave, si dhe raporti kredi/depozita i cili gjithashtu ka përcjellë trend natyrshëm rritës që nga fillimi i funksionimit të sektorit.

### 3. Mjedisi i jashtëm dhe zhvillimet në ekonominë e brendshme

Mjedisi i jashtëm ekonomik është karakterizuar me rritje të pasigurive gjatë vitit 2018. Rreziqet kryesore ndaj perspektivës ekonomike të vendeve të zhvilluara, e veçanërisht në eurozonë, ndërliken kryesisht me pasiguritë e

rritura gjeopolitike, forcimin e barrierave tregtare dhe rritjen potenciale të luhatjeve në tregjet financiare ndërkombëtare. Në rajonin e Ballkanit Perëndimor përfshirë ekonominë e Kosovës, kryesisht për shkak të bazës së ulët të prodhimit dhe konkurrueshmërisë më të dobët, deficitit të lartë tregtar vazhdon të përbëjë një ndër pengesat kryesore ndaj zhvillimit ekonomik. Rritja ekonomike në rajon vazhdoi të mbështetet kryesisht nga kërkesa e brendshme.

**Tabela 2. Vlerësimet dhe parashikimet e FMN- së për treguesit e zgjedhur makroekonomikë të partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës**

Përshkrimi	BPV-ja reale			Norma e papunësisë*			Inflacioni			Borxhi publik/BPV		
	2017	2018	2019	2017	2018	2019	2017	2018	2019	2017	2018	2019
Eurozona	2.4	1.8	1.3	9.1	8.2	8.0	1.5	1.8	1.3	86.8	85.0	83.6
Gjermania	2.5	1.5	0.8	3.8	3.4	3.4	1.7	1.9	1.3	63.9	59.8	56.9
Franca	2.2	1.5	1.3	9.4	9.1	8.8	1.2	2.1	1.3	98.5	98.6	99.2
Italia	1.6	0.9	0.1	11.3	10.6	10.7	1.3	1.2	0.8	131.3	132.1	133.4
Bosnja e Hercegovina	3.0	3.1	3.1	20.5	18.4	18.0	1.2	1.4	1.5	39.0	37.0	36.3
Kosova	4.2	4.0	4.2	30.5	29.6	n/a	1.5	1.1	2.2	16.3	17.0	19.7
Mali i Zi	4.7	4.5	2.8	16.1	15.2	n/a	2.4	2.6	0.9	66.3	72.1	70.6
Maqedonia e Veriut	0.2	2.7	3.0	22.4	19.4	18.9	1.4	1.5	1.8	39.4	39.5	40.5
Serbia	2.0	4.4	3.5	14.1	13.7	13.4	3.1	2.0	2.0	58.7	54.3	50.9
Shqipëria	3.8	4.2	3.7	13.8	12.2	13.7	2.0	2.0	2.0	71.9	68.6	65.1

Shënim: Për Kosovën dhe Malin e Zi janë përdorur janë përdorur të dhënat nga Agjencitë Statistike përkatëse sepse kanë munguar në bazën e të dhënave të FMN-së  
Burimi: Baza e të dhënave të FMN-së, WEO, prill 2019

**Mbyllja e programit të lehtësimit sasior në kuadër të politikës ekspansioniste monetare të ndjekur nga BQE**, si dhe shqetësimet e ngritura lidhur me përshkallëzimin potencial të tensioneve tregtare, janë reflektuar në një ngadalësim të aktivitetit ekonomik në eurozonë në fund të vitit 2018 dhe fillim të vitit 2019. Megjithatë, kushtet ende të favorshme të financimit, rritja e pagave, rikuperimi i kërkesës së jashtme dhe lehtësimi deri në një masë i politikave fiskale pritet të vazhdojnë të mbështesin aktivitetin ekonomik në vitin 2019.

**Dinamikat e rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor gjatë vitit 2018 vazhduan të ndryshojnë nga vendi në vend**, ndërkohë që rritja mesatare rezultoi të jetë rikuperuar kundrejt vitit paraprak (tabela 2), mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve. Megjithatë, pritjet për dinamika më të dobëta të aktivitetit ekonomik në eurozonë janë parashikuar të reflektohen në vendet e Ballkanit Perëndimor, kryesisht përmes dobësimit të kërkesës së jashtme me efekte negative në eksportet e rajonit, por edhe zvogëlimit potencial të remitencave dhe

investimeve të huaja direkte. Gjithashtu, pasiguritë e rritura politike në vendet e Ballkanit Perëndimor do të mund të pasqyrohen në rënie të mëtejme të besueshmërisë së investitorëve dhe konsumatorëve, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë rritjen reale dhe zhvillimin ekonomik. Përfundimisht, shtrëngimi potencial i politikës monetare në SHBA dhe eurozonë do të mund t'i ndikojë vendet në Ballkanin Perëndimor në vitin 2019, përmes rritjes së kostos së financimit të borxhit publik dhe shërbimeve financiare.

**Ambienti makroekonomik në Kosovë rezultoi të ketë qenë stabil në vitin 2018 dhe rreziku makroekonomik ndaj stabilitetit financiar, ngjashëm me vitin paraprak, në nivel mesatar megjithëse në rritje.** Në vitin 2019, vlerësimet për rritje të rreziqeve të jashtme dhe brendshme makroekonomike do të mund të reflektohen në ngadalësim të aktivitetit ekonomik në Kosovë kryesisht përmes rritjes së mëtejme të deficitit tregtar, rritjes së nivelit të përgjithshëm të çmimeve në vend dhe zvogëlimit të burimeve




të jashtme të financimit si remitencave, IHD-ve dhe kompenzimit të punëtorëve.

### 3.1. Ekonomia e brendshme

Pasiguritë e rritura në mjedisin e jashtëm gjatë vitit 2018 rezultojnë të kenë ndikuar edhe në dinamikat e ekonomisë së vendit, megjithëse rritja reale e BPV-së vlerësohet të ketë qenë e ngjashme me vitin paraprak. Rritja më e ngadalshme ekonomike në eurozonë dhe tek partnerët kryesor tregtarë të Kosovës në vitin 2018 dhe dinamikat në ekonominë e brendshme rezultuan në përkeqësim të pozicionit të neto eksporteve të vendit. Për pasojë, përkundër që mjedisi makroekonomik rezultoi të ketë qenë i qëndrueshëm, rritja reale e BPV-së, sipas vlerësimeve të BQK-së, rezultoi të ketë qenë 4.0 përqind (figura 5).

Figura 5. Norma e rritjes së BPV-së reale dhe kontribuesit në rritje



Burimi: ASK dhe vlerësimi i BQK-së për vitin 2018 (2019)

Rritja e kërkesës agregate gjatë vitit 2018 është mbështetur kryesisht nga rritja e konsumit dhe e investimeve. Të dhënat zyrtare tremujore për vitin 2018 të publikuara nga ASK sugjeruan rritje të vlerës së konsumit të përgjithshëm për 3.7 përqind, rritje e mbështetur kryesisht nga rritja e ndërmjetësimit financiar në vend. Përveç rritjes dyshifrore të kreditimit edhe burimeve të tjera të financimit të konsumit si remitencat dhe kompensimi i punëtorëve, edhe shpenzimet për paga në sektorin publik shënuan rritje, duke mbështetur rritjen e konsumit të përgjithshëm. Gjatë periudhës raportuese, rritja e kredive të reja investuese dhe shpenzimeve kapitale nga qeveria ndikuan në rritjen e investimeve në vend për

14.4 përqind. Në vitin 2018, si pasojë e dobësimit të kërkesës së jashtme dhe çmimeve më të ulëta të metaleve në tregjet ndërkombëtare, eksportet e mallrave Kosovare kanë shënuar rënie. Njëkohësisht, rritja e kërkesës së brendshme ka ndikuar në rritjen e vlerës së importit të mallrave, duke rezultuar kështu në përkeqësim të pozicionit të eksporteve neto (mallra dhe shërbime) për 14.7 përqind në terma real.


Për vitin 2019, parashikimet e BQK-së sugjerojnë rritje reale të BPV-së prej 4.2 përqind, rritje që pritet të mbështetet kryesisht nga stimuli i përforcuar fiskal, si dhe rritja e ndërmjetësimit financiar, flukseve hyrëse të transfereve nga jashtë në formë të remitencave dhe kompensimit të punëtorëve, si dhe IHD-ve.

Parashikimet e BQK-së për rritjen ekonomike në vitin 2019 priten të jenë subjekt i rishikimit në gjysmën e dytë të vitit, për të reflektuar mbi rritjen e rreziqeve të perceptuara të jashtme dhe të brendshme. Ngadalësimi i rritjes në Eurozonë, prospektet jo aq optimiste për Ballkanin Perëndimor si dhe rënia e çmimeve të metaleve pritet të kenë efekt në zvogëlimin potencial të burimeve të jashtme të financimit (remitencat, IHD-të, kompenzimi i punëtorëve), dhe për pasojë, në zvogëlimin e kërkesës së brendshme dhe eksporteve të mallrave. Gjithashtu, edhe rritja e rreziqeve të brendshme pritet të ketë ndikim në aktivitetin e përgjithshëm ekonomik në vitin 2019. Në kuadër të sektorit fiskal, presionet për rritje të mëtejme të shpenzimeve buxhetore kundrejt të hyrave, veçanërisht shpenzimeve rrjedhëse (presionet lidhur me rritjen e transfereve dhe Ligji i ri i pagave) në dy vitet e ardhshme, rrisin rrezikun e zvogëlimit të shpenzimeve kapitale dhe rritjen e deficitit fiskal përtej rregullës fiskale. Gjithashtu, Ligji i ri i pagave pritet të ndikojë në rritjen e pagave në sektorin publik, që përveç efekteve buxhetore, do të mund të rezultojë në presion mbi pagat e sektorit privat dhe për pasojë të ndikojë në konkurrueshmërinë e eksportuesve kosovar.

**Ngadalësimi i rritjes së çmimeve të mallrave kryesore në tregjet ndërkombëtare ndikoi në një rritje më të**

**ngadalësuar të çmimeve edhe në Kosovë gjatë vitit 2018.** Norma mesatare vjetore e inflacionit, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) shënoi rritje prej 1.1 përqind në vitin 2018 (1.5 përqind rritje në vitin 2017) (figura 6).

Figura 6. Norma e inflacionit, ndryshimi vjetor



Burimi: ASK (2019)

Përderisa gjysma e parë e vitit 2018 u karakterizua me rritje më të ngadalshme të çmimeve, gjysma e dytë dhe veçanërisht tremujori i fundit shënuan rritje të çmimeve. Për vitin 2019, projeksionet e BQK-së sugjerojnë se shkalla mesatare e inflacionit pritet të jetë rreth 2.3 përqind. Megjithatë, shkalla e inflacionit në vend në vitin 2019 është gjithashtu subjekt i rishikimit, veçanërisht kur kemi parasysh rritjen e përgjithshme të çmimeve, veçanërisht çmimeve të ushqimit prej 7.6 përqind. Vendimi politik i ndërmarrë për të vënë taksë prej 100 përqind në produktet e importuara nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, vendim që vazhdon të jetë në fuqi, ndikoi deri në një masë rritjen e çmimeve brenda vendit, me efekte potenciale në të ardhurat e disponueshme dhe fuqinë blerëse të konsumatorëve në vitin 2019.

**Në vitin 2018, dinamikat që karakterizuan sektorin fiskal rezultuan në rritje më të lartë të shpenzimeve buxhetore (10.3 përqind) kundrejt të hyrave buxhetore (4.5 përqind).** Rritja e lartë e shpenzimeve buxhetore krahasuar me vitin paraprak, por edhe kundrejt të hyrave, ka ndikuar në rritje të deficitit primar buxhetor

<sup>3</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

në 162.7 milionë euro përkatësisht në 2.4 përqind të BPV-së. Në vitin 2018, me rritje prej 9.7 përqind u karakterizua edhe **borxhi publik, që arriti vlerën prej 1.1 miliardë euro. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 17.1 përqind, nga 16.2 përqind sa ishte në vitin 2017.** Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 17.8 përqind (i cili ka arritur në 676.6 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 1.4 përqind duke arritur në 416.1 milionë euro.

**Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka shënuar vlerën prej 575.0 milionë euro, që është për 45.6 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2017. Në raport me BPV-në, deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe kapitale ka rritur në 8.5 përqind nga 6.2 përqind sa ishte në vitin 2017.** Rritja e deficitit të mallrave si dhe zvogëlimit të bilancit pozitiv të shërbimeve ishin faktorët kryesor në përkeqësimin e pozicionit të llogarisë rrjedhëse dhe kapitale në vitin 2018. Në anën tjetër, bilancet pozitive të llogarisë së të ardhurave parësore dhe dytësore kanë shënuar rritje. Rënia e eksportit të mallrave (2.8 përqind) si dhe rritja e konsiderueshme e importit (9.6 përqind) ka ndikuar që deficiti në tregtinë e mallrave të shënojë rritje prej 11.3 përqind dhe të arrijë në rreth 3.0 miliardë euro.<sup>3</sup> Në raport me BPV-në, deficiti tregtar i mallrave ka rritur në 44.1 përqind, nga 41.6 përqind sa ishte në vitin 2017.

**Bilanci në tregtinë e shërbimeve u karakterizua me rënie vjetore prej 2.0 përqind, duke shënuar prej 778.0 milionë euro.** Zvogëlimi i bilancit të shërbimeve i atribuohet rritjes shumë më të lartë të importit të shërbimeve (17.1 përqind) krahasuar me rritjen e eksportit (5.7 përqind). Struktura e shërbimeve të importuara dhe eksportuara mbeti pothuajse e pandryshuar nga viti paraprak.

**Në kuadër të bilancit të pagesave të Kosovës,** të ardhurat neto nga kompensimi i punëtorëve<sup>4</sup>, që është kategoria kryesore e të

<sup>4</sup> Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Këtu përfshihen punëtorët sezonalë apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe


ardhurave parësore, shënuan rritje për 8.9 përqind. Gjithashtu, me rritje u karakterizua edhe **bilanci i të ardhurave dytësore, kryesisht si rezultat i nivelit më të lartë të remitencave** që përbën edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore. Flukset hyrëse të remitencave shënuan vlerën prej 800.5 milionë euro në vitin 2018 dhe shënuan një rritje vjetore prej 5.4 përqind.

**Në vitin 2018, IHD-të e pranuar në Kosovë shënuan rënie vjetore prej 9.3 përqind dhe shënuan vlerën prej 231.7 milionë euro.** Rënia e IHD-ve u evidentua kryesisht tek sektori i shërbimeve financiare dhe ai i ndërtimtarisë, përderisa investimet në patundshmëri, miniera, energjetikë dhe në sektorin e tregtisë shënuan rritje.

### 3.1.1 Tregu i letrave me vlerë

**Tregu i brendshëm i letrave me vlerë vazhdon të jetë burimi kryesor i financimit të borxhit publik.**


Figura 7. Shuma e borxhit të emetuar, ndryshim vjetor



Në vitin 2018, Qeveria e Kosovës ka emetuar borxh në vlerën prej 399.8 milionë euro, e cila është për 1.3 përqind më e ulët se vitin e kaluar (figura 7). Përkundër rënies së shumës së letrave me vlerë të emetuara, kërkesa për të investuar në këto instrumente vazhdon të jetë e lartë (figura 8). Shuma e ofertuar nga subjektet pjesëmarrëse në ankande ka tejkaluar shumë e shpallur nga qeveria në çdo ankand. Në mesatare, raporti i shumës së

ofertuar ndaj shumës së shpallur ishte 1.40 (1.64 në vitin paraprak).


Figura 8. Shuma e kërkuar dhe e emetuar e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës



Burimi: BQK (2019)

**Maturiteti mesatar i letrave me vlerë ka vazhduar zgjatjen duke reflektuar interesimin e shtuar për borxh më afatgjatë.** Struktura e letrave me vlerë në dy vitet e fundit është dominuar nga obligacionet qeveritare. Bonot e thesarit (me maturim ‘deri 1 vit’), të cilat në të kaluarën dominuan strukturën e letrave me vlerë, në vitin 2018 zvogëluan pjesëmarrjen në 39.9 përqind (46.9 përqind në vitin 2017) të gjithsej letrave me vlerë.

Figura 9. Pjesëmarrja në letrat me vlerë, sipas afatit të maturitetit



Burimi: BQK (2019)


Emetimet në formë të obligacioneve qeveritare me afat maturimi ‘prej 5 vite’ shënuan rritjen më të lartë vjetore (prej 89.0 përqind), dhe dominuan strukturën e gjithsej letrave me vlerë (figura 9). Zhvillim i rëndësishëm këtë periudhë është realizimi për herë të parë i ankandit për emetim të obligacioneve

punëtorët kufitarë të cilët qendrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

qeveritare me afat maturimi dhjetë vite. Ndërsa, për herë të parë që nga fillimi i emetimit të letrave me vlerë, këtë vit nuk ka pasur emetim të bonove të thesarit me maturim 'prej 91 ditësh'.

**Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës ka shënuar rritje për të gjitha kategoritë e maturimit, e shprehur më shumë tek obligacionet.** Në kuadër të obligacioneve, ato me maturitet prej 5 viteve shënuan rritjen më të lartë të normës së interesit prej 142 pikë bazë. Ndërsa, bonot e thesarit me afat maturimi 6 muaj kanë shënuar rritjen më të ulët prej 18 pikë bazë (figura 10).


Figura 10. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës, sipas maturitetit



Burimi: BQK (2019)

**Pjesëmarrësit kryesor në ankande të letrave me vlerë vazhdojnë të jenë bankat komerciale, pasuar nga fondet pensionale të cilat rritën konsiderueshëm pjesëmarrjen (figura 11 dhe 12).** Pjesëmarrja e bankave komerciale në ankande ka shënuar rënie në vitet e fundit, që është reflektuar edhe në rënien e ekspozimit të sektorit bankar ndaj letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës (nga 6.6 përqind pjesëmarrje të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës në gjithsej asetet e sektorit bankar në dhjetor 2016, ekspozimi është zvogëluar në 6.2 përqind në dhjetor 2018). Fondet pensionale kanë rritur pjesëmarrjen theksueshëm në përpjekje për të rritur ekspozimin në vend, në kohën kur performanca e investimeve të tyre në tregjet e jashtme ishte negative.


Figura 11. Pjesëmarrësit në ankande të letrave me vlerë



Burimi: BQK (2019)

**Aktivitetet e tregtimit në tregun sekondar, marrë në konsideratë numrin e transaksioneve, kanë shënuar rritje, ndërsa vëllimi është karakterizuar me rënie.**

Figura 12. Mbajtësit e letrave me vlerë




Burimi: BQK (2019)

Numri vjetor i transaksioneve për vitin 2018 ka qenë 81 që është 30.6 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2017, ku janë realizuar 62 transaksione. Ndërsa, vëllimi vjetor i tregtimeve në tregun sekondar ka qenë 78.6 milion euro, rënie vjetore prej 45.2 përqind. BQK është një ndër akterët kryesorë në tregun sekondar të letrave me vlerë. Gjatë muajit dhjetor 2018, janë realizuar për herë të parë transaksionet për nevoja të likuiditetit afatshkurtër ndërmjet bankave komerciale, përmes marrëveshjeve për riblerje të letrave me vlerë të qeverisë.

### 3.2. Pozicioni financiar i ndërmarrjeve


Zhvillimet në treguesit ekonomik dhe financiarë të ndërmarrjeve sugjerojnë për rënie të lehtë të vëllimit të prodhimit industrial dhe rritje të qarkullimit në tregtinë me pakicë.

Figura 13. Indeksi i vëllimit të prodhimit industrial (2017=100)



Indeksi i peshuar i vëllimit të prodhimit industrial, që paraqet ecurinë e prodhimit të ndërmarrjeve në katër sektorë të industrisë, është karakterizuar me rënie të lehtë prej 0.7 përqind krahasuar me vitin 2017. Rënia e këtij indeksi ishte më e lartë tek industria nxjerrëse (-5.2 përqind), gjë që dëshmohet edhe nga rënia prej 6.1 përqind e vlerës së shtuar në këtë sektor.

Figura 14. Indeksi i qarkullimit në tregtinë me pakicë (2013=100)



Tek industria përpunuese dhe furnizimi me rrymë rënia e indeksit ishte më e ulët (-0.8 përqind të dy sektorët) ndërsa rritje prej 7.3


<sup>5</sup> Treguesi i klimës së biznesit dhe ai i besueshmërisë së biznesit përpilohen nga Oda Ekonomike e Kosovës, si pjesë e studimit të rregullt tremujorë 'Klima e biznesit në Kosovë' i cili anketon bizneset në katër sektorë të ekonomisë: prodhim, ndërtim, shërbime dhe tregti.

përqind është shënuar tek furnizimi me ujë, veprimtari të menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (figura 13).

Në anën tjetër, mesatarja e indeksit të qarkullimit në tregtinë me pakicë ka shënuar rritje të konsiderueshme (16.8 përqind) (figura 14), gjë që është vërejtur edhe nga rritja prej 9.1 përqind e vlerës së shtuar në këtë sektor.

Treguesi i klimës së biznesit dhe ai i besueshmërisë kanë ndryshuar trendin rritës të vitit 2017 duke shënuar rënie gjatë vitit 2018.<sup>5</sup> Treguesi i klimës së biznesit, i cili vlerëson situatën aktuale ekonomike (profitabilitetin) të biznesit dhe pritjet për periudhën e ardhshme gjashtëmujore, ishte më i ulët për mesatarisht 7.8 pikë përqindje, ndërsa treguesi i besueshmërisë së biznesit, i cili ka karakter më të përgjithshëm vlerësues për gjendjen e biznesit për dallim nga treguesi paraprak që fokusohet vetëm në performancën financiare të biznesit, ishte më i ulët për 5.7 pikë përqindje (figura 15).

Figura 15. Indeksi i besueshmërisë së biznesit




Pavarësisht rënies së treguesve të klimës së biznesit dhe besueshmërisë së bizneseve, iniciativa ndërmarrëse ka shënuar rritje në vitin 2018, si rezultat i zhvillimeve pozitive makroekonomike si dhe lehtësimeve në procedura për fillimin e biznesit.<sup>6</sup> Gjatë vitit 2018 u regjistruan 9,805 ndërmarrje të reja, që

<sup>6</sup> Kosova ka shënuar progres të mëtijshëm në reforma rregullative në fushën e regjistrimit të bizneseve në vitin 2018, me ç'rast Banka Botërore, në Raportin e Lehtësisë së të Bërit Biznes 2019 ka renditur Kosovën në vendin e 13-të për lehtësinë në themelimin e biznesit nga gjithsej 190 shtete.



paraqet rritje vjetore prej 6.3 përqind. Sektorët të cilët shënuan rritjen më të lartë vjetore në numrin e bizneseve të regjistruara ishin prodhimi dhe ndërtimtaria ndërsa në sektorin e bujqësisë numri i ndërmarrjeve të reja të regjistruara ishte dukshëm më i ulët (figura 16).

Figura 16. Ndryshimi vjetor në numrin e ndërmarrjeve të reja



Burimi: ASK (2019)


Në anën tjetër, numri i ndërmarrjeve të mbyllura gjatë kësaj periudhe ka shënuar rënie në 1,426 ndërmarrje të mbyllura nga 1,623 në vitin 2017. **Përveç rritjes së ndërmarrjeve të regjistruara, edhe numri i ndërmarrjeve qarkulluese si dhe vlera e qarkullimit të ndërmarrjeve të deklaruar në Administratën Tatimore të Kosovës ka shënuar rritje.**

Numri i ndërmarrjeve që deklarojnë qarkullim mbi zero ka arritur në 40,147 në vitin 2018 nga 39,506 një vit më parë, si dhe qarkullimi i deklaruar për vitin 2018 ishte 11.1 miliardë euro nga 10.1 miliardë euro në vitin 2017. Në mesatare, qarkullimi për ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar qarkullim mbi zero është rritur. Megjithëse rritja e qarkullimit mund të reflektojë edhe zhvillime tjera siç është rritja e formalitetit dhe një zhvillim i tillë mund të sugjerojë edhe për aktivitet të shtuar nga sektori i ndërmarrjeve.

**Progresi i vazhdueshëm në zbatimin efikas të reformave të kërkesave legislative dhe rregullative ka kontribuar në zvogëlimin e barrierave për qasjen në kredi, por sfida të shumta**

**vazhdojnë të mbesin.** Progresi në fushëveprimin e përmbaruesve privat si dhe ndryshimeve në Ligjin mbi Procedurën e Përmbarimit që ka të bëjë me sekuestrimin e llogarisë bankare dhe procedurën e përsheptuar të shitjes së kolateralit ka ndikuar pozitivisht në ofertën kreditore dhe ka bërë që të lehtësohen kërkesat për kolateral dhe të reduktohen normat e interesit. Qasja në kreditim, ndër tjera, është mbështetur edhe nga avancimet në Regjistrin e Kredive<sup>7</sup>, vendosja e pozicionit prioritar në procedura të falimentimit për kreditorët e siguruar, si dhe miratimi i kornizës ligjore për procedurat e falimentimit të korporatave. Sidoqoftë, pengesa të shumta mbesin, të cilat pengojnë performancën e biznesit dhe qasjen në financa. Niveli i lartë i informalitetit, zbatimi i dobët i kontratave, mungesa e të dhënave kadastrale, së bashku me mungesën e transparencës financiare dhe cilësinë e ulët të raportimit financiar, vazhdojnë të jenë pengesë në qasjen në financim për ndërmarrjet.

Figura 17. Borxhi i ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2019)

**Borxhi i ndërmarrjeve ndaj institucioneve financiare vendore dhe të jashtme ka vazhduar trendin rritës.** Borxhi i brendshëm, përkatësisht borxhi ndaj sektorit bankar në vend është rritur për 11.0 përqind. Kreditë e ndërmarrjeve nga ndërmjetësit tjerë financiarë shënuan rritje prej 21.4 përqind, por që mbesin me peshë të vogël në gjithëj borxhin e ndërmarrjeve në rreth 2.7 përqind. Borxhi i jashtëm i ndërmarrjeve vazhdoi rritjen dhe arriti në 21.5

<sup>7</sup> Në qershor 2017, u finalizua implementimi i projektit për avancimin e Regjistrin të Kredive të Kosovës, i cili është plotësuar me informata të reja

(normat e interesit, përqindja e mbuluar nga Fondi për Garanci Kreditorë, madhësia e biznesit, etj.), të cilat kontribuojnë, ndër tjerash, në zvogëlimin e asimetrisë së informacionit dhe përmirësimin në qasjen në financa.

përqind të gjithsej borxhit. Në dhjetor 2018, gjithsej borxhi i ndërmarrjeve shënoi rritje vjetore prej 10.0 përqind dhe arriti në 34.2 përqind të BPV-së (figura 17).

**Rritja e kreditimit të ndërmarrjeve nga sektori bankar ka kontribuar në procesin e përafrimit të shkallës së ndërmjetësimit financiar të ndërmarrjeve drejt vendeve të rajonit.** Raporti i kredisë së ndërmarrjeve nga bankat ndaj BPV-së arriti në 26.9 përqind në dhjetor 2018 (25.4 përqind një vit më parë). Rritja më e shpejtë e kredive në raport me BPV-në ka ndikuar që hendeku negativ i vitit 2017 të mbyllet dhe të kalojë në territor pozitiv në vitin 2018.<sup>8</sup>

**Si rezultat i rritjes më të lartë të kreditimit, edhe neto pozicioni debitor i ndërmarrjeve ndaj sektorit bankar shënoi rritje.** Depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje më të përshpejtuar vjetore dhe arritën në 656.6 milionë euro. Sidoqoftë, rritja e lartë e kreditimit për sektorin e ndërmarrjeve, që në dhjetor 2018 arriti vlerën 1,747.1 milionë euro<sup>9</sup>, ndikoi që ndërmarrjet të zgjerojnë pozicionin e tyre debitor ndaj sektorit bankar. Në aspektin valutor, sektori i ndërmarrjeve ka pozicion neto kreditor ndaj sektorit bankar, si rezultat i nivelit më të lartë të depozitave në valutë krahasuar me kreditë. Sidoqoftë, pozicioni në valutë mbetet i ulët si rezultat i pjesëmarrjes së ulët të kredive dhe depozitave në valutë, në 0.1 përqind për kreditë në valutë ndaj gjithsej kredive, dhe 3.0 përqind për depozitat në valutë ndaj gjithsej depozitave.

**Gatishmëria e sektorit bankar për të kredituar ndërmarrjet ka shënuar rritje më të ngadalësuar krahasuar me vitin paraprak. Kreditë e reja u rritën për 4.9 përqind (34.7 përqind në vitin 2017).** Sipas qëllimit, kreditë e reja investuese shënuan rritje për 21.2 përqind dhe shtuan pjesëmarrjen në strukturë nga 59.6 përqind në 65.1 përqind të gjithsej kredive të reja për ndërmarrjet në vitin 2018. Kreditë e reja jo-investuese shënuan nivel më të ulët prej 4.3 përqind dhe zvogëluan pjesëmarrjen në

strukturë nga 40.4 përqind në 34.9 përqind të gjithsej kredive të reja për ndërmarrjet në vitin 2018. Në aspektin e maturimit, viti 2018 u karakterizua me rritje të kredive me maturitet më të gjatë, ku 27.1 përqind e kredive të reja ishin me maturitet 5 deri në 10 vjet. Kategoria dominuese e kredive vazhdon të jetë ajo me maturitet 2 deri në 5 vite me përfaqësim prej 46.4 përqind në gjithsej kreditë e reja për ndërmarrje.

**Huamarrja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vitin 2018 është mbështetur edhe nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes.** FKGK, i cili synon rritjen e qasjes në financa për NVM-të përmes garantimit të portfolios kreditore të institucioneve financiare, filloi me garantimin e kredisë së parë për NMVM-të në shtator të vitit 2016. Në fund të vitit 2018, numri i kredive të bankave të garantuara nga FKGK ishte 2,262, shuma e miratuar e garancive arriti në 41.7 milionë euro. Struktura e kredive të garantuara është përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, me ç'rast dominojnë kreditë për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, të pasuara nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë kishte përfaqësim prej 7 përqind në gjithsej portfolion e kredive të garantuara. Prospektet pozitive të zhvillimit të FKGK-së, si në aspektin e rritjes së kapitalit dhe vlerës së garantuar të kredive, ashtu edhe në fokusimin në mbështetjen e sektorëve specifik me qasje më të vështirësuar në financa siç është sektori i bujqësisë, pritet të reflektohen në lehtësimin e kushteve të kreditimit dhe rritjen e mëtejme të kreditimit për NVM-të në përgjithësi, dhe sektorë të caktuar në veçanti.


**Kostoja e huamarrjes për sektorin e ndërmarrjeve ka vazhduar trendin rënës.** Në vitin 2018, norma mesatare e interesit në kreditë e reja të sektorit bankar për ndërmarrjet ishte 6.28 përqind, për 0.2 pikë përqindje më poshtë se një vit më parë, ndërsa

<sup>8</sup> Hendeku i kreditimit i kalkuluar me filterin Hodrick-Prescott.

<sup>9</sup> Përfshirë kreditë në valutë, të konvertuara në vlerë ekuivalente në euro.

përgjysmë më e ulët se në vitin 2013 (figura 18).

Figura 18. Normate interesit për ndërmarrjet




Burimi: BQK (2019)

Kjo rënie e normave të interesit ka ardhur si rezultat i presioneve të vazhdueshme konkurruese, përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditorë, progresi në reformat strukturore për zvogëlimin e rreziqeve në realizimin e kolateralit si dhe qasjes së mirë në financim.

### 3.3. Pozicioni financiar i ekonomive familjare

**Borxhi i ekonomive familjare vazhdoi trendin rritës në vitin 2018.** Borxhi i brendshëm ndaj sektorit bankar ka shënuar rritje prej 11.2 përqind, ndërsa borxhi ndaj institucioneve mikrofinanciare, që ka arritur në 12.1 përqind të vlerës së borxhit ndaj sektorit bankar, është rritur për 31.2 përqind.

Figura 19. Borxhi i ekonomive familjare



Burimi: BQK (2019)


Borxhi i jashtëm i ekonomive familjare shënoi rritje prej 13.1 përqind dhe arriti në 4.1 përqind të gjithëj borxhit. Në dhjetor 2018,

gjithsej borxhi i ekonomive familjare është rritur për 13.0 përqind dhe si përqindje e BPV-së arriti në 16.7 përqind (figura 19).

**Kreditë e reja të lëshuara nga sektori bankar për ekonomitë familjare, sikurse ato për ndërmarrjet, vazhduan të rriten por me një normë më të ulët krahasuar me vitin paraprak.**

Gjithsej borxhi i ri ndaj bankave është rritur për 7.1 përqind krahas rritjes prej 15.0 përqind një vit më parë. Sipas qëllimit, rritja ishte më e theksuar për kreditë e reja konsumuese, 10.4 përqind, përderisa kreditë hipotekare shënuan rritje prej 8.5 përqind. Rritja më e lartë e kredive konsumuese ndikoi që pjesëmarrja e lartë e këtyre kredive në gjithëj kreditë e reja për ekonomitë familjare të rritet akoma më tepër dhe të arrijë në 74.0 përqind, rritje prej 2.2 pikë përqindje. Kreditë e reja për ekonomitë familjare pritet të vazhdojnë rritjen në vitin vijues krahas pritjeve për rritje të kërkesës si dhe lehtësimit të kushteve dhe standardeve (rritjes së shumës së aprovuar dhe nivelit të ulët të normave të interesit).

Figura 20. Depozitat e ekonomive familjare



Burimi: BQK (2019)

**Neto pozicioni kreditor i ekonomive familjare ndaj sektorit bankar shënoi rritje si rezultat i volumit më të madh të depozitave krahasuar me kreditë por edhe normës më të lartë të rritjes së depozitave të ekonomive familjare krahasuar me vitin paraprak.** Depozitat e ekonomive familjare arritën vlerën 2.3




miliardë euro<sup>10</sup>, që paraqet rritje vjetore prej 7.5 përqind (figura 20).

Kreditë, në anën tjetër, vazhduan rritjen dyshifrore dhe arritën vlerën 1.0 miliardë euro, duke ndikuar në rritjen për 4.9 përqind të pozicionit tradicionalisht kreditor që kanë ekonomitë familjare ndaj sektorit bankar. Sa i përket neto pozicionit në valutë, sektori i ekonomive familjare ka shënuar rritje të pozicionit të tij kreditor në valutë për 19.5 përqind, si rezultat i rritjes së depozitave në valutë, të cilat arritën në 6.3 përqind të gjithsej depozitave të ekonomive familjare (5.7 përqind në vitin 2017), përderisa kreditimi në valutë mbetet në nivel të ngjashëm rreth 0.3 përqind të gjithsej kredisë për ekonomitë familjare.

**Kursimet e ekonomive familjare, në formë të depozitave të afatizuara dhe të transferueshme, shënuan rritje gjatë vitin 2018.** Kjo rritje e depozitave ka ardhur si rezultat i ngritjes graduale të normës së interesit në depozita e cila ka ndikuar në zvogëlimin e kostos oportune të mbajtjes së kursimeve dhe afatizimit të mjeteve, gjegjësisht në rritjen e kursimeve të ekonomive familjare (figura 21).

Figura 21. Normat e interesit për ekonomitë familjare



Gjithsej depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 7.5 përqind në vitin 2018 (2.1 përqind rritje në vitin 2017). Depozitat e afatizuara shënuan rritje prej 10.0 përqind, ndërsa norma e interesit arriti në 1.21 përqind

apo 0.28 pikë përqindje më e lartë krahasuar me vitin paraprak. Në anën tjetër, depozitat e reja të kursimit shënuan rënie vjetore prej 4.9 përqind, përkundër rritjes së lehtë të normës së interesit nga 0.26 në 0.28 përqind.

**Kostoja e borxhit të ri të ekonomive familjare vazhdoi rënien, ndikuar nga presionet konkurruese si dhe kushtet e favorshme të financimit.** Kreditë konsumuese shënuan normë mesatare interesi prej 7.2 përqind, apo 0.24 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin 2017, ndërsa normat e interesit tek kreditë hipotekare prej 5.9 përqind, ishin pothuajse të ngjashme me vitin 2017. Normat e interesit për ekonomitë familjare pritet të mbesin në nivel të ngjashëm, nën prospektet pozitive të rritjes ekonomike dhe cilësisë së portfolios kreditorë. Burimet e të ardhurave të ekonomive familjare treguan tendencë rritëse, ku remitencat u rritën për 5.4 përqind ndërsa kompensimi i punëtorëve<sup>11</sup> shënoi rritje vjetore prej 11.2 përqind. Niveli i pagave për periudhën 2012-2017, sipas ASK-së, ka shënuar rritje si në sektorin publik ashtu edhe atë privat, ku në mesatare paga neto është rritur për 22.7 përqind duke arritur në 471 euro në vitin 2017 nga 384 euro sa ishte në vitin 2012. Për vitin 2018, paga mujore neto e të punësuarve, sipas Anketës së Fuqisë Punëtore, në mesatare vazhdoi të qëndrojë në intervalin 400 deri në 500 euro. Zhvillime jo shumë të favorshme janë shënuar në tregun e punës.

Shkalla pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2018 ishte 40.9 apo 1.9 pikë përqindje më ulët krahasuar me vitin paraprak, pra është rritur shkalla e jo aktivitetit për 1.9 pikë përqindje dhe ka arritur në 59.1 përqind. Shkalla e punësimit e cila në vitin 2018 shënoj nivelin prej 28.8 përqind të popullsisë në moshë pune, ishte për 1.0 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin 2017. Në anën tjetër, shkalla e papunësisë në vitin 2018 ishte 29.6 përqind apo 0.9 pikë përqindje më e ulët krahasuar me vitin 2017.

<sup>10</sup> Përfshirë depozitat në valutë, të konvertuara në vlerë ekuivalente në euro.

<sup>11</sup> Të ardhurat nga kompensimi i punëtorëve - të ardhurat e punëtorëve sezonal jashtë vendit si dhe punëtorëve kosovarë jashtë kufirit për një periudhë më pak se një vit.

**Tabela 3. Treguesit e borxhit ndaj bankave dhe performancës së ekonomive familjare**

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Borxhi i ekonomive familjare ndaj bankave (në milionë)	434.2	514.6	546.3	567.7	639.0	697.7	799.5	900.6	1,001.1
prej të cilave në valutë	-	3.7	3.8	3.9	3.7	3.4	2.9	3.0	2.6
Depozitat e ekonomive familjare ne banka (në milionë)	1,299.3	1,490.5	1,640.1	1,775.0	1,848.3	1,965.8	2,120.5	2,164.2	2,326.3
prej të cilave në valutë	93.3	117.0	104.7	116.2	97.2	102.2	100.8	122.6	145.5
Neto pozicioni ndaj bankave (Pozicioni kreditor) në milionë	865.2	975.9	1,093.8	1,207.2	1,209.3	1,268.1	1,321.0	1,263.5	1,325.1
Raporti i borxhit ndaj të hyrave								26.3% *	38.3%
Mesatarja e vlerës së kredisë për të punësuar			1,804.3	1,677.7	1,975.2	2,349.8	2,409.5	2,522.6	2,901.0
Shkalla e varësisë ekonomike					266%	301%	274%	250%	268%

Burimi: BQK (2019)

\* Treguesi i borxhit ndaj të ardhurave të ekonomisë familjare ka filluar të raportohet në mënyrë të rregullt dhe me metodologji konsistente nga bankat duke filluar nga viti 2018 ku është përfshirë edhe viti 2017,

**Ngarkesa me borxh e ekonomive familjare, e matur përmes treguesit të borxhit ndaj të ardhurave neto, në vitin 2018 është rritur në 38.3 përqind (26.3 përqind në vitin 2017).** Ky tregues nuk paraqet ngarkesën e plotë të borxhit meqë konsideron vetëm borxhin nga një institucion bankar, duke mos konsideruar huamarrjen e


shumëfishtë në banka si dhe nga institucionet tjera financiare, si dhe borxhin e jashtëm. Sidoqoftë, edhe treguesi i varësisë ekonomike, që paraqet raportin midis popullsisë së përgjithshme joaktive (mbi 15 vjeç) dhe punësimit, në vitin 2018 është përkeqësuar në 268 përqind nga 250 përqind sa ishte në vitin 2017.<sup>12</sup>

<sup>12</sup> Sipas ASK, shkalla projektuar e varësisë ekonomike në BE do të rritet në 122.2 përqind në vitin 2023.

#### 4. Zhvillimet në sistemin financiar

**Sistemi financiar vazhdoi trendin rritës edhe gjatë vitit 2018, por me ritëm më të ngadalësuar.** Pothuajse të gjithë sektorët përbërës të sistemit financiar, përjashtuar sektorin e sigurimeve dhe ndihmësit financiar, rritën asetet e tyre në periudhën raportuese duke arritur vlerë prej 6.32 miliardë euro dhe rritje vjetore prej 6.9 përqind. Zhvillimet pozitive të sistemit financiar kontribuan në shtrirje më të madhe të qasjes në shërbime financiare nga ana e publikut, posaçërisht nga ana e sektorit bankar dhe atij mikrofinanciar, e që sugjeron rritje të presioneve të konkurrencës në treg për financim dhe ofrim të shërbimeve financiare. Shkalla e ndërmjetësimit financiar, e shprehur si raport i aseteve të sistemit financiar ndaj BPV-së është rritur për 2.7 pikë përqindje, duke arritur në 96.7 përqind në fund të vitit 2018. Vlerësimi i ndërmjetësimit financiar për segmentet përbërëse të sistemit financiar tregon për rritje të ndërmjetësimit veçanërisht për sektorin bankar dhe atë mikrofinanciar (figura 22).

Figura 22. Pesha e sektorëve të sistemit financiar ndaj BPV-së




Rritja e aseteve të sektorit bankar dhe mikrofinanciar kryesisht i atribuohet gatishmërisë së këtyre dy sektorëve në zgjerimin e aktivitetit të tyre kreditor, të mbështetur nga përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së kredive, rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i qasjes në financim. Rritja e

aseteve të sektorit pensional u mundësua nga rritja e kontributeve të arkëtuara përderisa kthimi nga investimet ishte negativ gjatë kësaj periudhe. Sektori i sigurimeve shënoi një rënie marginale, që është ndikuar nga tërheqja nga tregu e një prej siguruesve jetë gjatë vitit 2018.

**Struktura e sistemit financiar nuk ka pësuar ndonjë lëvizje të theksuar gjatë vitit 2018.** Sa i përket strukturës së sistemit financiar, numri i bankave komerciale dhe fondeve të pensioneve mbeti i pandryshuar nga viti i kaluar, përderisa numri i institucioneve mikrofinanciare shënoi rritje. Në vitin 2018, numri i siguruesve u zvogëlua në 14 për shkak të likuidimit vullnetar të një siguruesi, duke shitur portofolin e saj tek një sigurues tjetër (tabela 4). Ndihmësit financiarë vazhdojnë të kenë numrin më të madh të institucioneve financiare, pavarësisht pjesëmarrjes prej 0.2 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar (figura 23).

Figura 23. Pjesëmarrja në gjithsej asetet e sistemit financiar



**Kapitali i huaj vazhdon të mbizotëroj në pjesën më të madhe të segmenteve të sistemit financiar.** Sektori bankar dhe mikrofinanciar kanë pjesëmarrje të lartë të kapitalit të huaj, përderisa sektori pensional pothuajse gjithë financimin e ka të mbështetur tek kontributet vendore. Kurse kapitali i sektorit të sigurimeve është i ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë mes aksionarëve vendor dhe atyre të huaj (figura 24).


Tabela 4. Numri i institucioneve financiare

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Bankat komerciale	8	8	9	9	10	10	10	10	10
Kompanitë e sigurimeve	12	13	13	13	14	15	15	15	14
Fondet pensionale	2	2	2	2	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	28	34	38	39	42	44	48	52	51
Institucionet mikrofinanciare dhe financiare jo-bankare	17	20	17	17	18	18	16	18	22

Burimi: BQK (2019)

**Grupet bankare nga BE kanë pjesëmarrjen më të madhe në sektorin bankar në Kosovë, mirëpo bankat nga vendet tjera, kryesisht Turqia, gradualisht po rrisin prezencën e tyre. Bankat me origjinë nga vendet e BE përbëjnë 57.3 përqind të aseteve të sektorit bankar.**

Figura 24. Pronësia e segmentëve përbërës të sistemit financiar, dhjetor 2018



Burimi: BQK (2019)

Me një qasje më pro aktive me qëllim të depërtimit në treg, bankat me origjinë nga Turqia gradualisht rritën prezencën e tyre në 17.5 përqind të aseteve të sektorit dhe njëkohësisht ndikuan edhe në uljen e koncentrimit dhe rritjen e konkurrencës në këtë sektor. Shprehur si raport i aseteve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithsej aseteve të sektorit, shkalla e koncentrimit bankar zbriti në 57.3 krahasuar me vitin 2010 kur kishte një shkallë të koncentrimit prej 77.8 përqind. Sektori i sigurimeve pësoi ndryshime të theksuara në pronësi ndër vite ku ky sektor dominohet nga kompanitë vendore, pasuar nga kompanitë me origjinë nga Shqipëria. Kompanitë vendore të sigurimit përbëjnë 47.7 përqind nga 45.7 përqind në vitin paraprak dhe krahasuar me vitin 2010 kur pjesëmarrja ishte 25.2 përqind. Ndërsa, kompanitë nga Shqipëria përfaqësojnë 26.1 përqind të aseteve të sektorit të sigurimeve.


**Sistemi financiar në Kosovë ka strukturë të thjeshtë, përkitazi me stadin jo të avancuar të zhvillimit të tij, ndaj dhe ka ndërlidhje minimale ndërmjet segmenteve të sistemit. Lidhjet kryesore përfshijnë depozitat që sektorët jo-bankar (siguruesit, fondet pensionale dhe institucionet tjera jo-bankare) kanë në sektorin bankar.**

Sektori i sigurimeve dhe ai i ndihmësve financiar mbajnë 49.6 përqind, përkatësisht 29.3 përqind të aseteve të tyre si depozita në bankat komerciale, ndikuar në masë nga alternativat e kufizuar për investimin e mjeteve të tyre. Në këtë kontekst, stabiliteti dhe likuiditeti i sektorit bankar ka peshë të theksuar në operimin dhe stabilitetin e sektorëve tjerë. Përfundimisht këtë kanal të transmetimit (pjesëmarrjes së lartë të depozitave që sektorët tjerë mbajnë në sektorin bankar), mundësitë tjera për bartje të problemeve ndërmjet segmenteve të sistemit mbesin të kufizuara.

#### 4.1. Aktiviteti bankar

**Veprimtaria e sektorit bankar gjatë vitit 2018 u zgjerua më tutje e nxitur nga oferta kreditore.** Asetet e sektorit bankar ishin për 8.2 përqind më të larta për dallim nga viti paraprak, duke tejkaluar vlerën prej 4.0 miliardë euro, përkatësisht 4.19 miliardë euro. Rritja e aseteve të sektorit gjatë vitit 2018 i atribuohet kryesisht dinamikave pozitive me të cilat u karakterizua aktiviteti kreditor (figura 25), aktivitet që u mbështet si nga përmirësimi i kushteve të financimit nga ana e bankave, ashtu edhe nga rritja e kërkesës për kredi.

Figura 25. Pjesëmarrja në strukturën e asetëve



Burimi: BQK (2019)

Oferta kreditore u ndikua, përveç tjerash, edhe nga presionet e konkurrencës, pozita e favorshme e likuiditetit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portofolit kreditor. Në kuadër të asetëve, rritje vjetore prej 8.5 përqind shënuan paraja e gatshme dhe rezervat e bankave të mbajtura në BQK. Përkundër vazhdimit të normës negative të interesit të aplikuar nga BQK mbi tepricën e rezervës obligative që bankat komerciale mbajnë në BQK, kjo nënkategori shënoi rritje vjetore prej 3.8 përqind.


Asetet nuk kanë pësuar ndryshime të mëdha strukturore ndër vite, përveç nënkategorisë së letrave me vlerë që u zgjerua nga viti 2012 si rezultat i fillimit të tregut të brendshëm të letrave me vlerë dhe pjesëmarrjes aktive të bankave në këtë treg. Investimet në këto instrumente patën rritëm të shpejtë të rritjes, duke marrë për bazë normat atraktive të kthimit, peshën zero të rrezikut që bartin si dhe mundësi të reja të investimeve në kohën kur kreditimi duhet të ketë qasje të kujdesur përballë rrezikut që bart. Megjithatë për të dytin vit me radhë stoku i letrave me vlerë u karakterizua me rënie vjetore (11.5 përqind në vitin 2018). Rrjedhimisht ekspozimi i sektorit bankar ndaj Qeverisë që përfaqësohet në formë të letra me vlerë, u zvogëlua lehtësisht në 6.2 përqind të gjithë asetëve nga 6.3 përqind në vitin paraprak.

Strategjia e bankave për t'u fokusuar në kreditim kundrejt investimit në letra me vlerë në dy vitet e fundit i atribuohet kryesisht rënies së rrezikut kreditor.

Rritja më e lartë e aktivitetit nga bankat vendore si dhe bankat e reja në treg kanë ndikuar në rënien e shkallës së koncentrimin në sektorin bankar. Raport i asetëve të tri bankave më të mëdha ndaj gjithësej asetëve të sektorit zbriti në 57.3 përqind nga 61.0 përqind sa ishte një vit më parë.

Aktiviteti i sektorit bankar vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve (80.3 përqind të gjithësej detyrimeve dhe burimeve vetanake) (figura 26).

Figura 26. Pjesëmarrja në strukturën e detyrimeve dhe burimeve vetanake




Burimi: BQK (2019)

Në vitin 2018 depozitat u rritën për 8.7 përqind më shumë se vitin paraprak, dhe arritën nivelin prej 3.36 miliardë euro. Depozitat e ekonomive familjare rikuperuan ritmin e rritjes, që në vitin e kaluar kishte shënuar rritje rekorde të ulët prej vetëm 2.1 përqind, kurse në vitin 2018 u rritën për 7.7 përqind. Rikuperimi i normave të interesit në depozita gjatë vitit 2018 mund të ketë ndikuar në tërheqjen e arkëtimit (depozitave) prej ekonomive familjare (figura 27)

Depozitat e ndërmarrjeve ishin për 14.1 përqind më të larta krahas vitit të kaluar. Rritje më të theksuar shënuan depozitat e afatizuara, pasuar nga ato të transferueshme dhe të kursimit.


Figura 27. Stoku i gjithsej depozitiave dhe depozitave të reja, në milionë euro



Burimi: BQK (2019)

**Ekspozimi i sektorit bankar ndaj sektorit të jashtëm ka shënuar rënie, të ndikuar kryesisht nga rënia e depozitave në bankat e jashtme si dhe nga rënia e investime në letra me vlerë.** Pozicioni neto kreditor ndaj jorezidentëve u zvogëlua për 7.1 përqind, duke zbritur në 289.4 milionë euro (figura 28 dhe 29).

Figura 28. Pozicioni neto ndaj jorezidentëve




Burimi: BQK (2019)

Kërkesat ndaj jorezidentëve zënë 11.8 përqind të gjithsej asetëve të sektorit bankar, ku pjesa dërrmuese e tyre janë të mbajtura si depozita dhe të investuara në letra me vlerë, që së bashku përfaqësojnë rreth 88.4 përqind të gjithsej kërkesës së jashtme.

Në anën tjetër, detyrimet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve zënë 4.9 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit bankar dhe kryesisht përbëhen nga depozitat e jorezidentëve që mbahen në bankat vendore, dhe linjat kreditore të shfrytëzuara nga bankat, që së bashku përbëjnë 98.3 përqind të gjithsej detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm.

Figura 29. Kontributi i zërave në ndryshimin vjetor të aktivitetit me jorezidentët




Burimi: BQK (2019)

Sektorit bankar, në përgjithësi, ka ekspozim të ulët me jorezidentët si në kuadër të kërkesës së jashtme ashtu edhe të detyrimeve ndaj sektorit të jashtëm. Për më tepër, sektori bankar ka nivel mjaft të ulët të ekspozimit në valutë të huaj, që eviton humbjet e mundshme nga ndryshimet në kursin e këmbimit kundrejt valutës euro.

**4.1.1 Zhvillimet kreditore**

**Kreditë e sektorit bankar vazhduan trendin e rritjes dyshifrore.** Stoku i kredive aktive në bankat e vendit arriti në 2.76 miliardë euro, që paraqet rritje prej 10.9 përqind (figura 30).

Figura 30. Rritja vjetore e kredive për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2019)

Faktorët që ndikuan në rritjen e kreditimit në vitin 2018 ishin rritja e kërkesës për kredi si nga ndërmarrjet (më e theksuar nga NVM-të) ashtu edhe nga ekonomitë familjare (për kredi konsumuese dhe hipotekare). Po ashtu, përmirësimi i ofertës kreditore nga bankat, kryesisht përmes uljes së normës mesatare të interesit në kredi dhe zgjatjes së maturitetit të




kredive, ka rezultuar në rritje të stokut të gjithsej kredive.

Faktor tjerë me ndikim në dinamikat e kreditimit ishin përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së portofolit kreditor, likuiditeti i mjaftueshëm dhe konkurrenca bankare luajtën rol kyç në zgjerimin e aktivitetin kreditor të bankave në këto tri vitet e fundit.

Kreditë për ndërmarrjet u rritën për 10.8 përqind dhe arritën në 1.75 miliardë euro. Në vitin 2018, kreditë e reja për ndërmarrje u shtuan për 37.9 milionë euro dhe arritën në 816.4 milionë euro (figura 31). Për më tepër, kreditë investuese u rritën për 90.9 milionë euro, në 518.8 milionë euro, pasuar nga ato me karakter jo-investues, vlera e të cilave në fund të vitit 2018 arriti në 277.6 milionë euro, për 12.6 milionë euro më pak se në periudhën paraprake.

**Kreditimi bankar është rritur për shumicën e sektorëve të ekonomisë, me theks të veçantë për sektorin e ndërtimit dhe prodhimit.**


Figura 31. Stoku i gjithsej kredive dhe kredive të reja për ndërmarrje dhe ekonomitë familjare, në milionë euro



Kreditë për sektorin e prodhimit dhe atë të ndërtimit shënuan rritjen më të lartë vjetore prej 16.3 dhe 20.7 përqind respektivisht. Megjithatë, pjesëmarrja e këtyre sektorëve në gjithsej portofolin kreditor mbetet e ulët.

Sektori i tregtisë, i cili dominon strukturën e gjithsej kredive, shënoi rritje të kreditimit prej 7.6 përqind. Ndërsa, me rënie u karakterizuan sektori i minierave, rënie vjetore prej 54.4 përqind, dhe sektori i bujqësisë, me rënie të lehtë prej 0.1 përqind (figura 32).

Figura 32. Stoku i kredive sipas sektorëve të ekonomisë



Ndër faktorët që mbështetën kreditimin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vitin 2018 ishte edhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë, shfrytëzimi i të cilit ka shënuar trend të vazhdueshëm të rritjes. Numri kumulativ i kredive të bankave për NVM-të, të garantuara nga FKGK, arriti në 2,262 në fund të vitit 2018 (785 në fund të vitit 2017). Shuma totale e kredive të garantuara në vitin 2018 shënoi 87.2 milionë euro, një rritje kundrejt vlerës së garantuar prej 30 milionë euro në vitin paraprak. Struktura e kredive të garantuara është përfaqësim i strukturës së përgjithshme të kredive të sektorit bankar, me ç'rast dominojnë kreditë për sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë, të pasuara nga sektori i shërbimeve dhe ai i prodhimit. Sektori i bujqësisë, pylltarisë dhe peshkatarisë kishte përfaqësim prej 7 përqind në gjithsej portofolin e kredive të garantuara. Perspektet pozitive të rritjes së vlerës së FKGK-së dhe fokusimit në mbështetjen e sektorëve specifik me qasje më të vështirësuar në financa siç është sektori i bujqësisë, pritjet të reflektohen në rritjen e mëtejme të kreditimit për NVM-të në përgjithësi, dhe sektorë të caktuar në veçanti.

**Kreditë për ekonomitë familjare, të cilat në vitet e fundit kanë rritur peshën në strukturën e gjithsej stokut të kredive (rreth 36 përqind), për të pestin vit me radhë shënuan rritje të konsiderueshme.** Në fund të vitit 2018, vlera e kredive të destinuara për ekonomitë familjare arriti në 998.5 milionë euro, apo për 11.2 përqind më e lartë krahasuar me vitin paraprak.





## Kutia 2. Anketa e Kreditimit Bankar<sup>14</sup>


Rezultatet e fundit të Anketës së Kreditimit Bankar<sup>15</sup> pasqyrojnë zhvillimet në aktivitetin e kreditimit bankar gjatë periudhës shtator 2018 – shkurt 2019 (referuar si P1 2018)<sup>16</sup>, si dhe pritjet për aktivitetin kreditues në periudhën mars - gusht 2019 (referuar si P2 2019).

Dinamika e aktivitetit kreditues për **ndërmarrjet** gjatë kësaj periudhe, sipas anketës së kreditimit bankar, rezulton të jetë ndikuar pozitivisht si nga ana e ofertës kreditore ashtu edhe nga ana e kërkesës për kredi. Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar standardet e

aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi. Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, standardet kreditore për NVM-të u lehtësuan në nivel më të lartë, përdërisa për ndërmarrjet e mëdha lehtësimi i standardeve kreditore mbeti kryesisht i pandryshuar, me përjashtim të një prej bankave me peshë të vogël në gjithsej kreditë e sektorit e cila deklaroi shtrëngim deri në një masë.

Për periudhën mars - gusht 2019, bankat deklaruan që presin edhe më tutje lehtësim të standardeve kreditore për NVM-të. Ngjashëm me gjashtë muajt e kaluar, bankat deklaruan se presin lehtësim kryesisht për NVM-të (figura 35).

Figura 35. Standardet kreditore të aplikuar në vlerësimin e aplikacioneve të ndërmarrjeve



Burimi: BQK (2019)

Faktorët kryesor, deklaruar nga bankat, që ndikuan në lehtësimin e standardeve kreditore ishte rritja e konkurrencës në tregun kreditor në vend, rreziku i ulët i perceptuar nga kolaterali i kërkuar, përmirësimi i cilësisë së kredive dhe qasja e favorshme në financim i bankave, sidomos financimi i brendshëm nga depozitat.

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat po ashtu raportuan të kenë lehtësuar kushtet dhe rregullat e kreditimit për ndërmarrjet. Si për NVM-të ashtu edhe për kreditë e ndërmarrjeve të mëdha, bankat lehtësuan kushtet e

kreditimit kryesisht përmes uljes së normës mesatare të interesit, zgjatjes së maturitetit të kredive të aprovuara dhe lehtësirave për kolateralin e kërkuar (figura 36).

Për periudhën mars - gusht 2019, bankat presin lehtësim të kushteve në përgjithësi mirëpo me një shkallë shumë më të ulët se në gjashtëmuajorin e kaluar. Më konkretisht, norma mesatare e interesit në kredi për të dy kategoritë pritet të vazhdoj trendin rënës. Përdërisa, vetëm një nga bankat ka deklaruar që presin rritje të kërkesave për kolateral për ndërmarrjet e mëdha deri në një masë.


<sup>14</sup> Anketa e Kreditimit Bankar realizohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës me bankat që operojnë në Kosovë. Anketa realizohet dy herë në vit, duke përfshirë periudhën mars – gusht dhe periudhën shtator – shkurt.

<sup>15</sup> Përgjigjet e bankave individuale janë agreguar duke përdorur peshën përkatëse të çdo banke në gjithsej portfolion kreditore të sektorit bankar.

Vlerat pozitive e indeksit të standardeve kreditore tregojnë lehtësim dhe vlerat negative tregojnë shtrëngim. Gjithashtu, vlerat pozitive e indeksit të kërkesës për kredi tregojnë rritje të kërkesës dhe vlerat negative tregojnë rënie.

<sup>16</sup> Periudhës shtator – shkurt të cilto vit i referohemi si 'periudha e parë' – P1, ndërsa periudhës mars – gusht të cilto vit i referohemi si 'periudha e dytë' – P2.

Figura 36. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ndërmarrjeve



\*Vizat e ndërprera paraqesin vlerën e pritur respektive për periudhën mars - gusht 2019 (P2 2019)  
Burimi: BQK (2019)


Gjatë periudhës raportuese, bankat deklaruan rritje të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet. Megjithatë, indeksi i cili tregon kërkesën për kredi ishte dukshëm më i lartë për NVM-të se sa për ndërmarrjet e mëdha, i cili tregoi për një rritje marginale (figura 37). Bankat raportuan për përmirësim të cilësisë së aplikacioneve të pranuar nga NVM-të.

Në kuadër të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, pati rritje të kërkesë për investimeve fikse, përderisa bankat treguan për kërkesë më të vogël për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe për rifinancim të borxhit.

Për periudhën mars - gusht 2019, bankat presin që kërkesa për kredi të ketë rritje me të

vogël në krahasim me gjashtëmuajorin e kaluar. Dinamikat e aktivitetit kreditues për **ekonomitë familjare** gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u ndikuan pozitivisht si nga oferta e favorshme kreditore ashtu edhe nga kërkesa e ekonomive familjare për kredi. Për dallim nga rezultatet e anketës paraprake, kur standardet kreditore të aplikuara gjatë shqyrtimit të aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare u lehtësuan në veçanti për kreditë për blerjen e shtëpive, në këtë anketë bankat deklaruan se lehtësirat u koncentruan në kreditë konsumuese (figura 38).

Figura 37. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet




Burimi: BQK (2019)

Në gjashtë muajt e ardhshëm (mars - gusht 2019), bankat presin lehtësim të mëtutjeshëm për kreditë konsumuese, e po ashtu edhe

lehtësim më të lartë për kreditë për blerjen e shtëpive.

Figura 38. Standardet kreditore të aplikuara në vlerësimin e aplikacioneve nga ekonomitë familjare




Burimi: BQK (2019)

Përmirësimi i kushteve të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese për blerjen e shtëpive u realizua përmes uljes së normave të interesit, rritjes së madhësisë së kredive dhe zvogëlimit të

kërkesave për kolateral (figura 39). Kushtet për kreditë konsumuese kryesisht u përmirësuan përmes uljes së normës së interesit, zgjatjes së afatit të maturimit dhe rritjes së shumës së aprovuar deri në një masë.

Figura 39. Rregullat dhe kushtet e aplikuara për kreditë ndaj ekonomive familjare



\*Vizat e ndërprera paraqesin vlerën e pritur respektive për periudhën mars - gusht 2019 (P2 2019)

Burimi: BQK (2019)

Në gjashtë muajt e ardhshëm, bankat kanë deklaruar se presin që kushtet e kreditimit përgjithësisht të lehtësohen për ekonomitë familjare për të dy kategoritë. Kushtet për kreditë për blerjen e shtëpive pritet të lehtësohen përmes uljes së normës së interesit dhe kërkesave më të vogla për kolateral. Përderisa, kushtet për kreditë konsumuese pritet të ndikohen pozitivisht kryesisht përmes uljes së normës së interesit, rritjes së madhësisë së shumës së aprovuar dhe kërkesave më të vogla për kolateral.


Bankat raportuan rritje të kërkesës për kredi të ekonomive familjare. Të dy kategoritë e kredive për ekonomitë familjare kishin rritje të kërkesës për kredi, mirëpo kërkesa për kredi

konsumuese ishte më të lartë se kërkesa për kreditë për blerjen e shtëpive (figura 40).

Rritja e kërkesës nga ekonomitë familjare për kreditë konsumuese kryesisht i atribuohet rritjes së besueshmërisë së konsumatorëve për aftësitë e tyre për kthim të kreditë dhe kërkesës së rritur për financimin e shpenzimeve tjera përveç blerjes së shtëpive. Përderisa, bankat deklaruan se zhvillimet pozitive në tregun e pasurive të paluajtshme kontribuan pozitivisht në kërkesën për kreditë për blerjen e shtëpive.

Gjithashtu, cilësia e aplikacioneve të pranuar, si për kredi për blerje të shtëpive ashtu edhe për kreditë konsumuese, rezultoi të jetë përmirësuar.

Figura 40. Kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare



Burimi: BQK (2019)

Bankat presin edhe më tutje rritje të kërkesës për kredi në gjashtë muajt e ardhshëm, mirëpo për dallim nga gjashtëmujori i kaluar pritet që kërkesa për kreditë për blerje të shtëpive të ketë rritjen më të lartë.

Sa i përket afatit kohor, rezultatet e anketës tregojnë se kërkesë më të madhe gjatë kësaj periudhe kishte për kreditë afatshkurtra, përderisa kërkesa për kredi afatgjata u zvogëlua deri në një masë. Oferta kreditore e ndarë sipas maturitetit të kredive rezulton pa lëvizje të mëdha. Kreditë afatshkurtra mbeten të pandryshuara, me përjashtim të një bankës me peshë të vogël në gjithsej kreditimin e sektorit e cila deklaroj shtrëngim deri në një masë për kategorinë në fjalë. Përderisa, për kreditë afatgjata u deklarua një lehtësim marginal. Në gjashtë muajt e ardhshëm, bankat presin lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore për të dy kategoritë në njërin anë, dhe kërkesës kryesisht të ngjashme për të dy kategoritë në anën tjetër.


Bankat deklaruan për rritje deri në një masë të gjithsej financimit në periudhën raportuese, më saktësisht si burim kryesor të financimit i deklaruan depozitat, e veçanërisht depozitat afatshkurta nga ekonomitë familjare.

Gjithashtu, rritja e aktivitetit kreditor rezulton të jetë ndikuar pozitivisht edhe nga rritja e financimit nga institucionet financiare ndërkombëtare. Për dallim, nga rezultatet e anketës paraprake financimi nga bankat amë gjatë kësaj periudhe raportuese shënuan rënie. Edhe pse financimi i bankave përmes fondeve me maturitet afatgjatë shënoi rritje gjatë periudhës raportuese, ai afatshkurtër vazhdoi të dominoj. Ngjashëm, bankat presin rritje të qasjes në financim përmes depozitave të ekonomive familjare, mirëpo për dallim nga gjashtë muajt e kaluar bankat presin rritje të financimit edhe nga bankat amë. Gjithashtu, fondet nga institucionet financiare ndërkombëtare pritet të mbështesin financimin e aktivitetit të bankave në gjashtëmujorin e ardhshëm. Sa i përket maturitetit të fondeve, financimi afatshkurtër pritet të dominoj strukturën e fondeve.

## 5. Rreziqet e sektorit bankar

Sektori bankar gjatë vitit 2018 ka operuar në një ambient përgjithësisht të favorshëm, me rreziqe të ulëta dhe kapacitet të kënaqshëm për përballimin e goditjeve të mundshme. Me qëllim të matjes dhe vlerësimit të kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit, është ndërtuar indeksi i stabilitetit të sektorit bankar. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe anasjelltas.<sup>17</sup> Sipas indeksit të agreguar të rrezikut, sektori bankar në mesatare ka shënuar rritje të lehtë të ekspozimit ndaj rrezikut krahasuar me vitin paraprak, ndikuar në masën më të madhe prej dinamikës së rrezikut të solvencës dhe në masë më të kufizuar prej rrezikut të tregut dhe profitabilitetit.

Figura 41. Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar, sipas kriteve të rreziqeve



Në anën tjetër, kemi përmirësim të nivelit të likuiditetit të sektorit bankar, duke zvogëluar edhe më tej rrezikun që mund të vjen nga mungesa e likuiditetit në sektorin bankar.


Rritja e profitit ishte më e ngadalësuar kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve për provizione. Rreziku i profitabilitetit konsiderohet në rritje pasi që sektori bankar është i sfiduar nga zhvillimet e tregut që tentojnë të ngushtojnë tutje margjinën e interesit. Rritja e konkurrencës bankare do të

vazhdojë presionin për uljen e normave të interesit në kredi dhe rritjen e normave të interesit në depozita me qëllim të tërheqjes së depozitave.

Këto zhvillime në norma të interesit janë reflektuar edhe në rritje të rrezikut të tregut. Kjo për shkak të diferencave të mospërputhjeve të afateve të maturimit ndërmjet asetëve dhe detyrimeve. Rritja e normave të interesit mund të shtojë tutje presionin në koston e financimit në kushtet kur kreditimi afatgjatë është në rritje dhe i dominuar nga kontraktimi me norma fikse të interesit ndërsa financimi ka kryesisht maturitet afatshkurtër.

Rrjedhimisht ekspozimi i sektorit ndaj rrezikut të solvencës është rritur. Rritja më e ngadalësuar e profitit ndikoi në kthimin më të ulët në kapital të sektorit. Po ashtu rritja e asetëve me peshë rreziku u ndikua nga rritja e kreditimit afatgjatë duke krijuar presion në rritjen e kërkesave për kapital.

Figura 42. Indeksi i agreguar i stabilitetit të sektorit bankar



Megjithatë, në përgjithësi indeksi i agreguar i stabilitetit financiar qëndron mbi nivelin mesatar (figura 42) dhe ka trend rritës në pjesën më të madhe të vitit 2018, që tregon për një sektor bankar të qëndrueshëm dhe të shëndetshëm.

<sup>17</sup> Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9

Tabela 5. Rreziqet e sektorit bankar

Rreziqet	Indikatorët	2015	2016	2017	2018	Kahja e rrezikut	Interpretimet
Rreziku Kreditor	Raporti i kredive joperformuese (KJP) ndaj gjithsej kredive (%)	6.2%	4.9%	3.1%	2.7%	↓	Rreziku kreditor u zvogëlua edhe më tutje, si rezultat i rritjes më të lartë të kreditimit krahas rënies së kredive joperformuese. Përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditorë u ndikua edhe nga procesi i shlyerjeve të kredive të humbura nga bilancet e bankave. Poashtu, rënia e stokut të KJP-ve ka ndikuar në rritjen e raportit të mbulueshmërisë me provizione.
	Mbulueshmëria e KJP-ve me provizione (%)	115.1%	127.6%	149.7%	152.1%		
	Ekspozimet e mëdha kreditorë/Kapitalit i Klasit të parë (%)	67.3%	69.5%	88.9%	68.7%		
Rreziku i Profitabilitetit	Të hyrat neto nga interesi (në milion euro)	163.3	160.3	159.7	171.0	↑	Ndikim pozitiv në rritjen e profitit këtë vit dhanë të hyrat neto nga interesi si rezultat i rritjes së vëllimit të kredive. Përderisa, niveli më i lartë i shlyerjeve të kredive jo performuese ndikoi në rritjen e shpenzimeve për provizione gjatë vitit 2018 duke rritur presionin në profitabilitetin e sektorit që si rezultat ngadalësoi ritmin e rritjes. Kahja e rrezikut konsiderohet në rritje bazuar në presionin e vazhdueshëm të rritjes së kostos së financimit.
	Të hyrat neto nga jo-interesi (në milion euro)	47.5	17.7	41.7	32.6		
	Shpenzimet/Të hyrat	60.3%	67.3%	64.6%	65.1%		
	Kthimi Mesatar në Kapital (ROE)	29.1%	19.7%	21.3%	20.4%		
Rreziku i Tregut	Hendeku ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit (në milion euro)	1,740	1,538	1,735	1,684	↑	Hendeku ndërmjet asetëve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit është ngushtuar. Zhvendosja deri në një masë drejt financimit me afat më të gjatë krahas viteve parapake si pasojë e rritjes së normave të interesit në depozita, ndikoi në përmirësimin e këtij indikator. Sidoqoftë, vazhdimi i rritjes së kreditimit afatgjatë me normë fikse ndikoi në rritjen e rrezikut të normës së interesit në të ardhmën.
	Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë (%)	1.9%	4.6%	1.2%	1.3%		
Rreziku i Solvencës	Kapitali rregullator/Asetet me peshë rreziku (%)	19.0%	17.8%	18.1%	17.0%	↑	Raporti i kapitalit rregullator shënoi rënie si rezultat i rritjes më të lartë të asetëve të peshuara me rrezik, të ndikuara nga rritja e kreditimit. Në vazhdim të rritjes së vazhdueshme të kreditimit, e si rrjedhojë e rritjes së kërkesave për kapital, rritjes së presioneve në realizimin e profitit për shkak të rënies së normave të interesit në kredi dhe rritjes së normave të interesit në depozita, si dhe ndarjet e dividendës, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit pritet të jetë nën presion në të ardhmën.
	Kapitali i Klasit të parë/Asetet me peshë rreziku (%)	16.6%	15.8%	16.2%	15.5%		
	Ekuiteti/Asete	11.7%	12.1%	12.6%	12.3%		
Rreziku i Likuiditetit	Raporti kredi/depozita (%)	74.7%	77.0%	80.3%	81.9%	↓	Indikatorët e likuiditetit tregojnë për pozitë të mirë financiare të sektorit bankar si dhe për potencial të zgjerimit të aktivitetit kreditues. Raporti i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra u rrit si rezultat i rritjes së asetëve likuide (ndikuar nga rritja e depozitave dhe balancave me banka, pasasë së gatshme dhe investimit në fletëobligacionet e Qeverisë së Kosovës).
	Raporti i asetëve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtëra (%)	44.9%	41.5%	37.9%	38.5%		
	Hendeku i Likuiditetit (në milion euro)	398.1	405.1	463.8	494.4		
			Rrezik në rritje	Rrezik në rënie	Rrezik i pandryshuesh		


Burimi: BQK (2019)



## 5.1. Rreziku kreditor

Cilësia e portfolios kreditore në nivel të sektorit bankar ka vazhduar përmirësimin, e mbështetur nga rënia e kredive jo performuese të segmentit të ndërmarrjeve. Ndryshimet rregullative për shlyerjen e kredive të kategorizuara ‘të humbura’ nga bilancet e bankave brenda afateve të përcaktuara<sup>18</sup>, ishte ndër faktorët me ndikim në zvogëlimin e kredive jo performuese. Megjithatë gjendja aktuale jep sinjale pozitive për ekspozimin e sektorit ndaj rrezikut kreditor, trendi i rritjes së kreditimit dhe kryesisht orientimi drejt kreditimit të shtuar të ekonomive familjare mund të rritë rrezikun e përballjes së sektorit bankar me aftësinë paguese të këtij segmenti, që në të ardhmen mund të dobësohet nëse kushtet e tregut të punës përkeqësohen dhe faktorët e tjerë ekonomikë ndërrojnë kahjen e tanishme të zhvillimit. Prandaj në përpjekje të përmirësimit të kualitetit kreditor dhe ruajtjes së stabilitetit financiar duhet marrë qasje më prudente nga ana e bankave ndaj nivelit të kreditimit, standardeve kreditore për ekonomitë familjare të cilat janë deklaruar nga bankat se do të lehtësohen në periudhën në vijim e që rrjedhimisht afektojnë nivelin e ngarkueshmërisë me borxh të ekonomive familjare.

Figura 43. Rritja vjetore e kredive dhe kredive joperformuese




Burimi: BQK (2019)

Raporti i kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive të sektorit bankar u zvogëlua në 2.7 përqind nga 3.1 përqind në vitin 2017. Rritja e stokut të kredive prej 10.9 përqind dha efekt më të lartë në rënie të raportit të KJP-ve se rënia e stokut të kredive jo performuese për 4.6 përqind (figura 43).

Vetëm gjatë vitit 2018 vlera e kredive të shlyera ishte 8.3 milionë euro, që në terma absolut ka ndikuar në zvogëlimin e gjithsej kredive jo performuese për 10.6 përqind. Poashtu kthimi i kredive të kategorizuara si jo performuese dhanë kontribut zbritës prej 17.9 përqind ndërsa origjinimet e kredive jo performuese gjatë periudhës patën efekt rritës prej 21.8 përqind në gjithsej stokun e kredive jo performuese (figura 44).

Figura 44. Efekti i procesit të shlyerjeve (write-offs)



Burimi: BQK (2019)

Faktorë tjerë si rritja e aktivitetit ekonomik dhe përmirësimi i vazhdueshëm i faktorëve strukturorë kanë ndikuar gjithashtu në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditore. Një pjesë e efektit të rënies së KJP-ve mund t'i atribuohet edhe faktorëve të tjerë si performanca e mirë financiare e sektorit të ndërmarrjeve<sup>19</sup> gjatë këtij viti, e bazuar në rritjen e vlerës së qarkullimit të deklaruar në ATK, që mund të ketë kontribuar në aftësinë paguese të këtyre huamarrësve. Po ashtu aktiviteti i përmbaresëve privat ka mundësuar lehtësimin dhe përsheptimin e procesit të kthimit të kredive, ndërsa avansimi në reformat strukturorë për lehtësim në


<sup>18</sup> BQK 2017, Rregullorja mbi Menaxhimin e Rrezikut Kreditor, neni 18.

<sup>19</sup> Për më tepër lexo kapitullin II, Ndërmarrjet si dhe pjesën e Anketës së kreditimit bankar.

realizimin e kolateralit, ka ndikuar në rritjen e konfidencës së bankave dhe rrjedhimisht rritjen e vëllimit të kredive të lëshuara nga bankat. Këta faktorë janë reflektuar në origjinime më të ulëta të kredive joperformuese dhe rikuperim të tyre gjatë periudhës.

**Cilësia e portfolios kreditore në Kosovë mbetet në nivelin më të mirë në rajon.** Kosova ndër vite qëndron me raportin më të ulët të kredive jo performuese krahasuar me vendet e rajonit (figura 45). Përmirësimi i cilësisë së portfolios kreditore në vitin 2018 ka ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të pozicionit, me ç'rast norma e KJP-ve në dhjetor 2018 ishte pothuajse përgjysmë më e ulët se në Maqedoni, vendi i dytë me cilësinë më të mirë të portfolios kreditore në rajon.

Figura 45. Raporti KJP/gjithsej kreditë në vende të rajonit




**Ekspozimet kreditore me klasifikim më të lartë kreditor, kreditë standarde, kanë vazhduar trendin e rritjes së pjesëmarrjes në portfolion kreditore, dhe në fund të vitit 2018 përfaqësonin 94.8 përqind të gjithsej kredive.**

Kreditë standarde, të cilat përfshijnë ekspozimet kreditore pa vështirësi, me vonesa më pak se 30 ditë, ose plotësisht të mbuluara me kolateral, në vazhdimësi kanë rritur pjesëmarrjen, ku në dhjetor 2018 rritën peshën për 1.1 pikë përqindje në favor të zvogëlimit të peshës së kredive me klasifikim të ulët si “të dyshimta” dhe “të humbura” për 0.01 dhe 0.4 pikë përqindje (figura 46).

**Segmenti më i kredituar dhe njëkohësisht më i ngarkuar nga kreditë jo performuese**


**është segmenti i ndërmarrjeve, megjithëse kualiteti i tyre kreditor është përmirësuar gjatë vitit 2018.**

Figura 46. Struktura e kredive sipas klasifikimit të vonesave



Ky segment përfaqëson rreth 63.6 përqind të gjithsej portfolios kreditore për vitin 2018. Raporti i kredive jo performuese për ndërmarrje u zvogëlua në 3.4 përqind nga 4.1 përqind sa ishte në vitin paraprak, si rezultat i rënies së stokut të kredive jo performuese prej 5.6 përqind (figura 47).

Figura 47. Kreditë joperformuese




**Sipas aktivitetit ekonomik, pothuajse të gjithë sektorët janë karakterizuar me përmirësim të portfolios kreditore. Sektori i bujqësisë vazhdon të ketë normën më të lartë të kredive jo performuese.** Raporti i KJP-ve për sektorin e tregtisë, i cili përfaqëson sektorin më të kredituar, në vitin 2018 zbriti në 3.7 përqind nga 4.5 përqind në vitin paraprak. Ndërsa sektori me normën më të lartë të KJP-ve është sektori i bujqësisë me 6.0 përqind, për 2.2 pikë përqindje më ulët se sa në vitin paraprak. Ky



sektor që përfaqëson sektorin më strategjik të ekonomisë është një ndër sektorët më pak të kredituar nga ana e bankave, ku vetëm 2.4 përqind e gjithsej stokut të kredive janë të destinuar për bujqësi. Më pas është sektori i prodhimitarisë me normë të KJP-ve prej 4.6 përqind dhe ai i pasurisë së patundshme me 3.7 përqind (figura 48).

Figura 48. Raporti i KJP-ve ndaj stokut të kredisë, sipas sektorëve




Cilësia e portfolios kreditore për ndërmarrjet është përmirësuar, duke sugjeruar për origjinime më të ulëta të kredive jo performuese dhe rikuperim të tyre gjatë periudhës, si rezultat i performancës më të mirë ekonomike të ndërmarrjeve.<sup>20</sup> Rritja e shfrytëzimit të FKGK, i cili garanton deri në 50% të kryegjësë së kredisë për NVM-të duke lehtësuar qasjen në financa dhe mbuluar një pjesë të rrezikut të tyre kreditor, pritet të reflektohet në rritjen e kreditimit për sektorët që historikisht janë kredituar më pak për shkak të rrezikut më të lartë kreditor që bartin këta sektorë.

**Megjithëse kreditimi ndaj ekonomive familjare, e posaqërisht të atyre konsumuese ka tendencë rritëse, kualiteti kreditor i këtij segmenti mbetet në nivel të ulët.** Ekonomitë familjare shënuan rritje të lehtë të stokut të kredive jo performuese, prej 0.6 përqind, mirëpo rritja e bazës së kreditimit ndikoi në rënie marginale të raportit të KJP-ve për 0.1 pikë përqind duke qëndruar në 1.2 përqind (figura 49). Në përmirësimin e cilësisë së portfolios kreditore kontribut kanë dhënë faktorët

rregullativ si procesi i shlyerjes së kredive të humbura nga bilanci e bankës sipas afateve të përcaktuara. Pozita financiare e ekonomive familjare konsiderohet në nivele adekuate duke u bazuar në raportin e kredive jo-performuese të këtij segmenti, prandaj në këtë periudhë ky segment nuk bart rrezik të lartë kreditor për sektorin bankar. Megjithatë rreziku mund të rritet apo edhe të materializohet në një të ardhme në qoftëse kreditimi vazhdon me ritëm të përsheptuar dhe kushtet e tregut të punës përkeqësohen, remitencat zvogëlojnë ritmin e rritjes dhe aktiviteti ekonomik bie, faktorë të cilët do të reflektoheshin në rritje të ngarkueshmërisë me borxh të familjeve dhe dobësim të aftësisë së tyre paguese.

Figura 49. Ndryshimi vjetor i stokut të KJP-ve dhe mbulueshmëria me provizione



**Raporti i provizionimit të sektorit është rritur tutje si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditore përderisa vlera e stokut të provizioneve është zvogëluar gjatë këtij viti.** Rënia e stokut të kredive jo-performuese në vitet e fundit, është duke e zvogëluar nivelin e provizioneve që duhet ndarë për mbulim të humbjeve të mundshme nga kreditë. Në vitin 2018, stoku i kredive jo performuese shënoi rënie prej 4.6 përqind, ndërsa vlera e provizioneve për humbje të mundshme nga kreditë u zvogëluar për 3.0 përqind. Rrjedhimisht, raporti i mbulimit me provizione u ngrit në 152.1 përqind nga 149.7 përqind sa ishte në vitin 2017 (figura 49).

<sup>20</sup> Rënia e KJP-ve pjesërisht mund ti atribuohet edhe ndërrimit metodik të kalkulimit, ku nga viti 2017 nuk përfshihen në llogaritje mjetet jashtëbilancore.

Sektori bankar mban nivel të lartë të provizioneve, të cilat tejkalojnë edhe kërkesat rregullatore, kuprovizionet e tepërta përbëjnë 36.5 përqind të gjithëj stokut të provizioneve të mbajtura. Ndërsa si rezultat i zvogëlimit të vlerës së provizioneve raporti prej 1.5 përqind i mbulimit të kredive jo performuese neto nga provizionet për humbje nga kreditë<sup>21</sup> ndaj kapitalit rregullator gjatë këtij viti ishte më i lartë se në vitin paraprak prej 1.2 përqind.


**Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor ka shënuar rënie në këtë periudhë, ndikuar nga përmirësimi i cilësisë në të gjithë sektorët si dhe nga rritja e mbulueshmërisë me provizione.** Kushtet e favorshme makroekonomike të reflektuara në performancë më të mirë të sektorit të ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare, si dhe masat rregullatore të ndërmarra për shlyerje të kredive të humbura kanë përforcuar pozitën kreditore të sektorit dhe kanë ndikuar në rënien e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor. Rënia e ekspozimit ndaj rrezikut kreditor pritet të manifestohet pozitivisht në dinamikat e kreditimit në periudhën në vijim, krahas prospekteve pozitive për rritjen ekonomike në vend. **Ruajtja e nivelit të ulët të rrezikut kreditor do të mundësohej tutje nga iniciativat e bankave individuale për ndryshimet e standardeve kreditore në përputhshmëri me dinamikat dhe gjendjen ekonomike në vend si dhe ndjekjen për së afërmi të zhvillimeve në performancën financiare të ndërmarrjeve dhe kryesisht të ekonomive familjare.**

### 5.1.1 Ekspozimet e mëdha kreditore

**Shkalla e ekspozimit kreditor ka rënë në 68.7 përqind nga 88.9 përqind sa ishte në vitin paraprak, dhe që është dukshëm nën nivelin maksimal rregullator.<sup>22</sup>** Rënia vjetore e vlerës së ekspozimeve të mëdha për 17.9 përqind dhe e rritjes së kapitalit të klasit

të parë për 6.3 përqind ndikuan në rënien e shkallës së ekspozimit. (figura 50).

Figura 50. Koncentrimi i rrezikut kreditor



Burimi: BQK (2019)

**Koncentrimi i rrezikut kreditor, i shprehur si raport ndërmjet vlerës së ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të këtyre ekspozimeve, është zvogëluar.** Vlera mesatare e ekspozimeve të mëdha<sup>23</sup> arriti në 5.3 milionë euro nga 6.2 milionë euro si rezultat i efektit të rënies së vlerës së ekspozimeve të mëdha. Raporti i tri ekspozimeve më të mëdha ndaj gjithëj ekspozimeve shënoi rritje në 57.2 përqind nga 53.7 përqind. Shkalla e ekspozimeve të mëdha kreditore të gjithëj sektorit bankar ngritet në masë të madhe nga bankat që operojnë si degë bankare në Kosovë, të cilat gjithashtu kanë ndjeshmëri më të lartë në analizën e qëndrueshmërisë ndaj goditjeve të mundshme në ekspozimet e mëdha kreditore. Rezultatet e skenarit të dështimit të tre dhe pesë kredi marrësve më të mëdhenjë në secilën bankë, tregojnë se sektori do të qëndronte në kufi të kërkesës rregullatore për kapital. Ndërsa një degë e bankës së huaj dhe një bankë me rëndësi sistemike e cila gjatë vitit 2018 ka kaluar nga degë në bankë të mëvetësishme do të rezultonin të nënkapitalizuar në rastin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj. Kjo dëshmon që sektori, përkundër që qëndron nën nivelin maksimal rregullator të ekspozimeve kreditore, është i ndjeshëm ndaj goditjeve të mundshme në këto

<sup>21</sup> Kreditë joperformuese neto përfaqësojnë vlerën e kredive joperformuese që mbetet pasi ti zbriten provizionet për këto kredi.

<sup>22</sup> Raport i gjithëj Ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj Kapitalit të Klasit të parë. Ekspozim i madh kreditor, përcaktuar sipas rregullorës së BQK-së mbi Ekspozimet e Mëdha, konsiderohet çdo ekspozim ndaj një personi të vetëm ose

grup të ndërlidhur personat vlera e të cilit tejkalon 10% të kapitalit të klasit të parë të bankës. Ndërsa të gjitha ekspozimet e mëdha kreditore së bashku nuk mund të tejkalojnë më shumë se 300% të kapitalit të klasit të parë.

<sup>23</sup> Raporti i gjithëj ekspozimeve të mëdha ndaj numrit të ekspozimeve.

pozicione. Kjo gjendje theksohet sidomos tek degët e bankave të huaja<sup>24</sup>

**Kutia 3. Përafrimi me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 9**

BQK-ja gjatë vitit 2018 ka finalizuar rregulloren, e cila përafuron kornizën e vendit me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 9<sup>25</sup> dhe e njëjta është në proces të miratimit dhe parashihet të hyjë në fuqi nga 1 janari i vitit 2020.

Ndryshimi kryesor në këtë aspekt ka të bëjë me fushën e provizionimit të ekspozimeve kreditore të bazuar në modelin e humbjeve të pritura. Zbatimi cilësor i SNRF 9, për shkak të kompleksitetit, kërkon ndryshime dhe ka ndikim në procese, sisteme dhe në qeverisjen e vetë bankave duke përfshirë edhe nevojën e zhvillimit të resurseve njerëzore në fushën e ndërtimit dhe validimit të modeleve. Në këtë kontekst, BQK ka qenë në komunikim të afërt me bankat duke përcjellë procesin dhe sfidat drejt përafrimit me SNRF 9, në mënyrë që procesi të jetë më i lehtë dhe efikas. Sektori, në përgjithësi, ka zhvilluar modelet adekuate dhe ka ngritur kapacitete për zbatim efektiv të SNRF 9, duke u përgatitur në mënyrë graduale për hyrjen në fuqi të kornizës rregullative. Zbatimi i plotë i SNRF 9 do të mundësojë qasje më të avancuar dhe me perspektivë më parashikuese për vlerësimin e rrezikut kreditor dhe njohjen e humbjeve kreditore. Për shkak të nivelit të lartë të provizioneve që bankat kanë mbajtur në përgjithësi, si masë mbrojtëse ndaj normave të ulëta të realizimit të kolateralit, implementimi i SNRF9 nuk pritet të ketë ndonjë efekt të theksuar në nivelin e provizioneve në nivel të sektorit.


**5.2. Qëndrueshmëria e profitit dhe rreziku i normave të interesit**

**Profiti i sektorit bankar të Kosovës shënoi rritje vjetore prej 3.0 përqind, ndikuar nga rritja e të hyrave nga interesi.** Vlera e profitit neto arriti në 88.0 milionë euro (figura 51).

Të hyrat neto nga interesi shënuan rritje nga viti paraprak, duke arritur të jenë më të larta

për 11.3 milionë euro. Të hyrat nga interesi në kredi shënuan rritje vjetore për 5.0 përqind, dhe ishin ndër faktorët kryesorë të rritjes së profitit krahas rritjes së të hyrave nga tarifat dhe komisionet.

**Figura 51. Struktura e profitit të sektorit bankar, në milionë euro**




Burimi: BQK (2019)

Këto të fundit u rritën për 11.1 milionë euro, duke arritur vlerën prej 61.6 milionë euro në dhjetor 2018 (figura 52).

Në anën tjetër shpenzimet u rritën si rezultat i shpenzimeve për provizione që për pasojë ngadalësuan rritjen e profitit. Rritja e shpenzimeve për provizione është në linjë me procesin e shlyerjeve të kredive joperformuese nga bilancet brenda afateve të përcaktuara.

**Figura 52. Kontribuesit kryesor në rritjen/zvogëlimin e profitit**



Burimi: BQK (2019)


**Edhe pse kosto e financimit përmes depozitave u rrit, rritja e profitit u kompensua me të hyrat nga aktiviteti kreditor të cilat shënuan rritje më të lartë duke ndikuar që të hyrat neto nga**

<sup>24</sup> Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, këto banka nuk janë subjekt i rregullatave për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit

të parë të bankës por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave amë, prandaj edhe vlera e ekspozimeve të mëdha kreditore është më e lartë tek këto banka.  
<sup>25</sup> <https://ëëëëëë.bis.org/fsi/fsisummaries/ifrs9.htm>


**interesi këtë vit të shënojë rritje pas dy vitesh rënie.** Krahasuar me rënien prej 0.4 përqind në vitin paraprak, këtë vit rritja e të hyrave neto nga interesi ishte 7.1 përqind (figura 53).

**Figura 53. Të hyrat dhe shpenzimet e interesit**



Norma mesatare e interesit në kredi u zvogëluar në 6.6 përqind, rënie prej 0.2 pikë përqindje, ndërsa ajo në depozita u ngrit lehtësisht në 1.3 përqind, ngritje për 0.3 pikë përqindje.<sup>26</sup> Me gjithë presionet e konkurrencës e reflektuar në zvogëlim të normave të interesit në kredi, zgjerimi i aktivitetit kreditor gjatë vitit 2018 ndikoi që të hyrat nga interesi të rriten për 11.0 milionë euro (apo 6.2 përqind).

**Figura 54. Të hyrat dhe shpenzimet e jo-interesit**




Pavarësisht, rritjes së presioneve të bankave për zgjerimin e bazës së depozitave, shpenzimet për interesa për dallim nga viti paraprak vazhduan trendin rënës, duke

<sup>26</sup> Duke qenë se rreth 90 përqind e të hyrave dhe shpenzimeve nga interesi realizohen nga aktiviteti ndërmjetësues, atëherë të hyrat neto nga interesi

shënuar rënie marginale prej 0.3 milionë euro (apo 1.8 përqind).

**Margjina neto e interesit u rrit në 5.1 përqind, për 0.1 pikë përqindje, për arsye se rritja e vëllimit të kreditimit në njërën anë rezultoi në rritje vjetore të të hyrave nga interesi kundrejt rënies së shpenzimeve nga interesi.**

**Figura 55. Struktura e të hyrave të sektorit bankar**



Për kundër zhvillimeve pozitive në rritjen e depozitave si pasojë e rritjes së normës mesatare të interesit në depozita, rritja më e lartë e kreditimit kundrejt depozitave ndikoi në rritjen e neto të hyrave nga interesi. Rrjedhimisht, rritja e këtyre të fundit mbizotëroj rritjen e mesatares së aseteve që sjellin interes, duke rezultuar në marginë neto të interesit lehtësisht më të lartë.


**Profiti i sektorit pritet të ballafaqohet me presionin e ngushtimit të hapësirës për zvogëlim të kostos së financimit përmes depozitave dhe presionet e vazhdueshme të konkurrencës për zvogëlim të kostos së ndërmjetësimit.** Norma veçse e ulët e interesit në depozita dhe me tendencë për rritje të mëtutjeshme, si dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme (rreth 60 përqind e gjithsej depozitave) të cilat nuk kanë shpenzime interesi, bën që mundësitë për efekte pozitive në realizimin e profitit nga menaxhimi i shpenzimeve për interesa, të jenë të kufizuara. Prandaj, duke pasur parasysh këtë dhe deklaratimet e bankave në anketën e kreditimit bankar që sinjalizojnë për

ndikohen direkt nga ndryshimet në normat e interesit në kredi dhe depozita (figura 51 dhe 52).

mundësinë e rënies së mëtejme të normave të interesit në kredi, pozita aktuale e lartë e profitabilitetit do të ballafaqohet me presione rënëse të cilat mund të nxisin bankat të hulumtojnë mënyra të reja për gjenerim të profitit.

**Përpyekjet e bankave për rritje të efikasitetit në menaxhimin e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, si dhe në përshtatjen e modelit të biznesit ndaj nevojave të tregut pritet të intensifikohen si rezultat i presioneve konkurruese.**

Figura 56. Struktura e shpenzimeve të sektorit bankar




Ngushtimi i margjinës së interesit si dhe avancimet teknologjike në sektorin e financave do t'i shtojë presionet e bankave në Kosovë për avancimin e proceseve dhe modeleve të tyre të biznesit me qëllim të rritjes së efikasitetit në menaxhimin e kostove dhe sigurimit të burimeve të reja për gjenerim të të hyrave. Bankat veçse kanë shtuar përpyekjet për zvogëlimin e shpenzimeve operative duke i racionalizuar aktivitetet dhe zvogëluar degët, krahas ndërmarrjes së veprimeve strategjike për inkurajimin e rritjes së përdorimit të shërbimeve të automatizuara dhe atyre elektronike (figura 56). Kjo e fundit mund të ketë qenë një ndër faktorët që kanë ndikuar në rritjen e çmimeve për tarifa dhe komisione, sidomos për shërbimet e kryera brenda bankës.

**Indikatorët e profitabilitetit u zvogëluar lehtësisht si rezultat i rritjes margjinale**

**të profitit, megjithatë vazhdojnë të qëndrojnë në nivelin më të lartë në rajon.** Kthimi mesatar në asete dhe kapital i sektorit bankar të Kosovës zbriti në 2.5 përqind, përkatësisht 20.4 përqind nga 2.6 përqind dhe 21.3 përqind një vit më parë (figura 57). Këto nivele janë mjaft mbi mesataren e rajonit që shënoi normë të kthimit në asete prej 1.7 përqind dhe normë të kthimit në kapital prej 12.8 përqind.<sup>27</sup>


Figura 57. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



**5.2.1 Rreziku ndaj luhatjeve të normave të interesit**

**Rritja e vazhdueshme e kreditimit nga bankat në një rën të anë si dhe pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme dhe të atyre me afat më të shkurtër maturimi, rrit ekspozimin e sektorit bankar ndaj rrezikut të ndryshimeve në norma të interesit.**

Figura 58. Hendeku kumulativ i aseteve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normave të interesit



<sup>27</sup> Në vendet e rajonit përfshihen Shqipëria, Serbia, Bosna dhe Hercegovina dhe Maqedonia. Mali i Zi nuk është përfshirë në mungesë të të dhënave.




Rreziku manifestohet në kuptimin e gjenerimit të të hyrave nga ri-investimi i mjeteve dhe krijimi i shpenzimeve për refinancimin e aktiveteve kur mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve janë të mëdha (figura 58).

Bilanci i gjendjes së sektorit bankar në Kosovë karakterizohet kryesisht me norma fikse interesi, andaj sektori është i ndikuar nga lëvizjet e normave të interesit kryesisht në maturim të këtyre pozicioneve.

Rritja e koston së financimit, ndikuar nga presionet e konkurrencës në tërheqjen e depozitave apo nga rritja e mundshme e normave të interesit në nivel global në afat të mesëm, mund të ndikoj në rritjen e presionit të shpenzimeve të sektorit, meqë kategoria kryesore e aseteve, kreditë, janë kontraktuar me normë fikse të interesit dhe kanë maturitet më të gjatë.

Kjo situatë do të nxitë nevojën për ndryshime eventuale në strukturën e aseteve dhe detyrimeve të sektorit për menaxhim efektiv të rrezikut.

Figura 59. Asetet dhe detyrimet e ndjeshme ndaj normave të interesit



Burimi: BQK (2019)

**Krahasuar me vitin paraprak hendeku u zgjerua në të gjitha afatet e maturimit, përveç në afatet '31-90 ditë' dhe '91-365 ditë' që u ngushtua.** Hendeku pozitiv për afate të maturimit mbi 1 vit u zgjerua më tej, ndërsa u thellua në vlerë negative për afatin e maturimit '1-30 ditë', si rezultat i rritjes së detyrimeve me afat më të shkurtër maturimi krahas rritjes së aseteve me afat më të gjatë maturimi (figura 59). Kjo do të thotë se sektori në afat të shkurtër të maturimit do të përballej

me rrezik për rritje të mundshme të normës së interesit që do të afektonte koston e refinancimit. Tkurrja e hendekut kumulativ pozitiv nënkupton që, një sinjal për rënie të normave të interesit në treg do të rriste rrezikun në gjenerimin e të hyrave nga ri-investimi i mjeteve që maturojnë, por në të njëjtën kohë do të ishte e favorshme në kuptimin e përbalimit të kostove të refinancimit. Duhet theksuar se rënia e mundshme e normave të interesit mund të ketë efekt negativ të drejtpërdrejtë në të ardhurat nga interesi nga investimet në letra me vlerë dhe instrumente tjera, mirëpo efekti nga rënia në normën e ndërmjetësimit financiar mund të vlerësohet edhe si sinjal pozitiv ngase ndikon kërkesën për kredi si dhe mund të nënkuptohet poashtu si zvogëlim i ngarkesës për huamarrësit.

**Analiza e sensitivitetit të sektorit ndaj rritjes së mundshme të normës së interesit sugjeron për ekspozim të ulët të sektorit bankar ndaj këtij rreziku.** Rezultatet sugjerojnë që një rritje e mundshme e normave të interesit në pozicionet bilancore me ndjeshmëri ndaj normave të interesit nuk do të rezultonte në humbje për sektorin. Kjo pasi që asetet me ndjeshmëri ndaj normave të interesit janë më të larta se detyrimet për periudhën 1 vjeçare, dhe nën supozimin se të njëjtat instrumente që maturojnë do të mund të ri-investohen me normë më të lartë, sektori do të rezultonte me efekte pozitive në të hyra.

### 5.3. Rreziku nga pozicioni në valuta të huaja


**Pozicioni i agreguar neto i hapur në valuta të huaja u rrit gjatë vitit, duke e rritur më tej ekspozimin ndaj rrezikut të ndryshimit të valutës.**

Pozicioni i agreguar neto i hapur për të gjitha valutat e huaja shënoi rritje në 6.0 milionë euro ekuivalente nga 5.6 milionë euro, që konsiston në 1.3 përqind të kapitalit të klasit të parë (1.2 përqind në vitin 2017) (figura 60).

Ekspozimi i sektorit bankar është rritur lehtësisht në kuptimin e mospërputhjeve valutore, ku rritja e detyrimeve në valuta të huaja ekuivalente në euro mbizotëroi rritjen e

aseteve në valutë të huaj ekuivalente në euro. Këto lëvizje ndikuan që hendeku ndërmjet asetëve dhe detyrimeve në valutë të huaj të jetë negativ në nivelin 0.01 përqind të gjithsej asetëve të sektorit nga 0.01 përqind sa ishte një vit më parë.


Figura 60. Pozicionet e hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë



**Sipas valutave të veçanta, pozicioni neto i disagreguar ndaj kapitalit të klasit të parë u zvogëlua për funtën britanike, frankun zviceran dhe valutat tjera të agreguara, ndërsa u rrit për dollarin amerikan.** Detyrimet në funtë britanike dhe frankun zviceran u rriten duke tejkaluar kështu asetet në këto valuta. Kjo do të thotë se sektori bankar është më i ekspozuar ndaj rrezikut të zhvlerësimit të mundshëm të euros ndaj këtyre valutave në kohën e maturimit pasi që vlera e detyrimeve ekuivalente në euro do të rezultonte më e lartë dhe rrjedhimisht do të ndikonte në rritje të kostos së financimit në valutë. Ndërsa pozicionet e asetëve në dollarin amerikan këtë vit tejkaluan detyrimet në këtë valutë, ku e kundërta qëndronte në vitin e kaluar.

**Raporti i pozicioneve neto të hapura për çdo valutë individuale ndaj kapitalit të klasit të parë vazhdon të mbetet mjaft nën nivelin maksimal prej 15 përqind të lejuar sipas rregullores përkatëse.**

Figura 61. Kreditë dhe depozitat në valutë të huaj




Prandaj, luhatjet valutore kanë ndikim marginal në gjendjen financiare të sektorit, marrë parasysh nivelin mjaft të ulët të pozicioneve në valuta të huaja. Kjo dëshmohet edhe përmes analizës 'stres test' që sugjeron nivel të ulët të ndjeshmërisë së pozitës kapitale të sektorit ndaj luhatjeve në kurset e këmbimit.

**Rreziku i tërthortë kreditor nga ekspozimi në valutë mbetet i ulët ngase kreditë në valutë mbeten në nivel të papërfillshëm.** Kreditë në valutë të huaj përbëjnë vetëm 0.1 përqind të gjithsej kredive, rënie prej 1.2 milionë euro të portfolios kreditorë në valutë në krahasim me vitin paraprak. Depozitat në valutë gjithashtu kanë pjesëmarrje të ulët, 5.1 përqind, pavarësisht rritjes prej 22.9 milionë euro që shënuan këtë vit (figura 61).

#### 5.4. Kapitali

**Pozita e kapitalit të sektorit vazhdon të reflektoj qëndrueshmëri të lartë.** Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u zvogëlua në 17.0 përqind nga 18.1 përqind (figura 62).

Figura 62. Kapitalizimi i sektorit bankar




Burimi: BQK (2019)

Kjo rënie reflekton rritjen e asetëve të peshuara me rrezik si pasojë e rritjes së aktivitetit kreditor, krahas rritjes së kapitalit rregullator. Pavarësisht rënies, sektori bankar ka bazë të fortë të kapitalit rregullator, 91 përqind e të cilit është kapital i klasit të parë, që kryesisht rezulton nga profiti i lartë i realizuar dhe ai i mbajtur, e që njëherit jep indikacion që bankat janë të orientuara në krijimin e kapitalit kryesisht brenda aktivitetit të tyre (mbajtjes së profitit si ekuitet).

Kapitali rregullator shënoi rritje prej 4.3 përqind, duke kontribuar në rritjen e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit për 0.8 pikë përqindje (figura 63). Në kuadër të kapitali rregullativ rritje shënuan kapitali aksionar dhe fitimi i mbajtur nga vitet paraprake. Ndërsa shpërndarja e dividendës nga bankat që e ndikon kapitalin përmes reduktimit të fitimit të pashpërndarë, ishte faktori i vetëm me efekt reduktues në kapital rregullativ.

Figura 63. Kontributi i Kapitalit Rregullator dhe APR-ve në Raportin e Kapitalizimit




Burimi: BQK (2019)

Rritja e kreditimit gjatë këtij viti, ka ndikuar në rritjen e ekspozimit të sektorit ndaj asetëve me peshë rreziku. Rritja prej 11.0 përqind e asetëve me peshë rreziku kontribuoi në rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit për 1.8 pikë përqindje. Rrjedhimisht efekti më i lartë i rritjes së asetëve me peshë rreziku se i rritjes së kapitalit rregullator e zbriti treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit për 1.1 pp (figura 63).

Sipas bankave individuale, disa nga bankat që kanë zgjeruar aktivitetin e tyre kreditor janë përballur më rënie të treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit si rezultat i rritjes më të lartë të asetëve me peshë rreziku. Njëkohësisht, këto banka u përballën edhe me rritje të profilit të rrezikut, shprehur përmes raportit të asetëve me rrezik ndaj gjithsej asetëve.

**Leva financiare po ashtu u zvogëluar si pasojë e rritjes më të lartë të asetëve kundrejt ekuitetit.** Indikatorin e levës financiare (raporti i ekuitetit ndaj asetëve) zbriti në 12.3 përqind nga 12.6 përqind sa ishte në vitin paraprak, duke sugjeruar zvogëlim të financimit të aktivitetit përmes kapitalit aksionar në raport me financimin përmes borxhit (figura 64).

Figura 64. Struktura e kapitalit rregullator




Burimi: BQK (2019)

**Në kuadër të asetëve të peshuara me rrezik, rritje shënuan si asetet e peshuara për rrezik kreditor, ashtu edhe ato të destinuara për rrezik operacional.** Duke qenë se modeli i biznesit të sektorit bankar është kryesisht aktiviteti kreditor, 92.1 përqind e kërkesave kapitale për rreziqe janë



destinuar për rrezikun kreditor ndërsa 7.9 përqind për atë operacional (figura 65).


Figura 65. Raporti i APR-ve ndaj gjithsej asetëve të sektorit



Burimi: BQK (2019)

Në vitin 2018 asetet me peshë të rrezikut kreditor u rritën për 296.0 milionë euro (apo 11.7 përqind rritje vjetore), duke arritur në 2.8 miliardë euro. Të gjitha kategoritë shënuan rritje, mirëpo kontributin më të madh në rritjen e asetëve të peshuara më rrezik e dhanë asetet me peshë rreziku 100% që shënuan rritje vjetore prej 11.2 përqind, e të cilat edhe dominojnë gjithsej APR-të (figura 66). Këto lëvizje janë në linjë me zhvillimet në bilanc të gjendjes të rritjes së kreditimit afatgjatë (kreditë me afat maturimi 'mbi 5 deri në 10 vite' zgjeruan pjesëmarrjen në gjithsej kreditë për 1.8 pikë përqindje).


Figura 66. Struktura e APR-ve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2019)

Rreth 89.4 përqind e gjithsej kredive ndaj klientëve për vitin 2018, janë të peshuara më rrezik 100%, përdërisa 78.3 përqind e kredive ndaj institucioneve tjera financiare janë të peshuara me rrezik prej 20% (figura 67).

Figura 67. Klasat e asetëve sipas peshës së rrezikut



Burimi: BQK (2019)

**Niveli i mbajtjes së kapitalit për rrezik operacional ka shënuar rritje të qëndrueshme ndër vite krahas rritjes së vazhdueshme të ekspozimit ndaj këtij rreziku.** Revolucioni digjital ka ndikuar në çdo aspekt, përfshirë këtu edhe ndikimin në sistemin financiar duke nxitur adoptimin gjithnjë e më shumë të sistemeve të avansuara të teknologjisë dhe të krijimit të infrastrukturës për ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara. Këtyre zhvillimeve u janë ekspozuar edhe bankat në Kosovë të cilat posaçërisht në vitet e fundit kanë investuar mjaft në ofrimin e shërbimeve elektronike bankare. Mbështetja gjithnjë e më madhe në shërbime të digjitalizuara po e rrit shkallën e rrezikut ndaj gabimeve në sisteme të teknologjisë informative apo dhe sulmeve të mundshme kibernetike. Sektori bankar gjatë vitit 2018 është prekur edhe nga një lloj tjetër i rrezikut operacional e që janë rastet e shumta të vjedhjeve të degëve të bankave nëpër Kosovë. Kjo dukuri ka rritur rrezikun operacional dhe ka ngritur vëmendjen e organeve kompetente, përfshirë edhe BQK së për marrjen e masave në adresimin e kësaj çështje. Ngjarje të tilla përveç që shkaktojnë humbje materiale krijojnë pasiguri dhe humbje besimi të klientëve ndaj bankave dhe sistemit financiar në përgjithësi. Prandaj mbikëqyrja dhe vlerësimi i rrezikut operacional është çështje shumë e rëndësishme nga pikëpamja e stabilitetit financiar pasi që rreziku operacional njëkohësisht mund të paraqes rrezik sistematik për shkak të humbjeve dhe panikut që mund të përhapet. Në vitin 2018, kërkesat për ndarje të kapitalit për

mbulimin e humbjeve të mundshme operacionale qëndruan në vlerën prej 241.0 milionë euro, për 4.0 përqind më e lartë se në vitin paraprak. Sidoqoftë, menaxhimi i rrezikut operacional vlerësohet adekuat, duke mos pasur raste të materializimit të tij, si dhe duke ndarë kapitalin për mbulimin e këtij rreziku në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore.

**Rezultatet e stres test sugjerojnë se sektori bankar mbetet i qëndrueshëm në të gjithë skenarët e supozuar të goditjeve në pozitën kapitale.**

#### Kutia 4. Korniza rregullative mbi kërkesat për kapital

Kriza globale financiare e vitit 2008 ka nxitur rishikimin dhe avancimin e kornizës rregullative ndërkombëtare, si dhe atyre në nivel nacional, për mbrojtjen e sistemit financiar nga rreziku sistemik. BQK është në proces gradual të përafrimit të kornizës së saj rregullative me standardet ndërkombëtare të Bazelit dhe direktivat e rregulloret e Bashkimit Evropian.

Nga shtatori i vitit 2014, ka filluar projekti specifik për adaptimin dhe implementimin e kornizës rregullative të njohur si Korniza e Bazelit për Kapitalin (eng. Basel Capital Framework). Aktualisht BQK është në përfundim të procesit të adaptimit të plotë të kërkesave të Shtyllës së Parë të Bazelit, dhe njëkohësisht në proces të vazhdueshëm të avancimit të adaptimit të kërkesave të Shtyllës së Dytë dhe të Tretë. Harmonizimi i plotë i rregullativës ekzistuese për mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave me Kornizën e Bazelit për Kapital dhe rregulloren e BE-së 575/2013 si dhe Direktivën e BE-së 2013/36, sipas strategjisë së BQK-së, është paraparë të finalizohet përgjatë periudhës 2015 – 2019.

Gjatë vitit 2018, si pjesë e këtij projekti, janë finalizuar rregulloret si në vijim:

- *Rregullorja për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave;*
- *Rregullorja për Treguesit e Leverazhit; dhe*
- *Rregullorja mbi Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit.*

Këto rregullore janë miratuar nga Bordi i BQK-së me datë 29 nëntor 2018, kurse do të hyjnë në fuqi nga data 1 janar 2020. Në zbatim të Rregullores për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave dhe Rregullores për Treguesit e Leverazhit janë hartuar draftet e udhëzimeve dhe formave të raportimit, të cilat pritet të finalizohen dhe miratohen gjatë vitit 2019, për të filluar së zbatuari nga data 1 janar 2020.

Me ndryshimet në *Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave*, ridefinohet kapitali rregullativ si dhe përcaktohen kërkesat për kapital ndaj rrezikut kreditor përmes aplikimit të Qasjes së Standardizuar për peshim me rrezik të ekspozimeve ndaj rrezikut kreditor, përcaktohen kërkesat për adaptimin e teknikave të zbutjes së rrezikut kreditor, si dhe kërkesat për kapital për rrezikun e tregut dhe atë operacional.

Këto ndryshime kryesisht përfshijnë rishikimin e kërkesave për kapital dhe elementeve përbërëse të kapitalit me qëllim të ngritjes së cilësisë së kapitalit, që do të mundësojë që ekspozimet e bankave të mbuloen me bazë të kapitalit të kualitetit më të lartë përmes instrumenteve financiare që kanë mundësi më të mëdha absorbuese të humbjeve. Definicioni i kapitalit është bërë sipas kornizës Bazel III.<sup>28</sup> Niveli i përgjithshëm i kapitalit rregullativ që do të kërkohet mbetet i njëjtë në 12% të gjithësej mjeteve të peshuara me rrezik, mirëpo kompozicioni i tij ka ndryshuar. Kapitali i klasit të parë (Tier 1) është klasifikuar në kapitalin bazë të klasit të parë (CET 1), i cili në çdo kohë duhet të jetë në së paku 4.9% të mjeteve të peshuara me rrezik. Në kapitalin e klasit të parë është shtuar edhe kapitali shtesë i kapitalit bazë (ang. Capital conservation buffer), që së bashku me kapitalin bazë në çdo kohë duhet të jenë në së paku 9% të mjeteve të peshuara me rrezik. Kjo ndikon që kërkesa për kapital të klasit të parë të rritet në 9% të mjeteve të peshuara me rrezik, nga 8% sa është aktualisht.

*Rregullorja mbi Treguesin e Leverazhit* përcakton treguesin e leverazhit, i cili është tregues i thjeshtë i kapitalit që nuk bazohet në rrezik. Përmes këtij treguesi, që do të shërbej si masë shtesë ndaj kërkesave të kapitalit të bazuar në rrezik, synohet të kufizohet ekspozimi ndaj rrezikut eventuale të rritjes së ekspozimeve bilancore dhe jashtë bilancore të bankave që mund të ndodhë përmes emetimit të tepërt të instrumenteve të borxhit, me potencial eventuale të destabilizimit të

<sup>28</sup> Në kapitalin bazë të klasës së parë, apo në fitimin e mbajtur, është mundësuar të përfshihen edhe fitimet e fundvitit nën kushtin që ato janë verifikuar nga auditori i jashtëm apo nga BQK gjatë ekzaminimeve.

sektorit financiar dhe ekonomisë. Sipas Rregullores së Treguesit të Leverazhit, bankat obligohen që këtë tregues, që përfshinë raportin e masës së kapitalit<sup>29</sup> ndaj masës së ekspozimit, ta mbajnë në nivelin minimal prej 3%. Aktualisht BQK obligon bankat që treguesin e leverazhit ta mbajnë në nivelin minimal 7%, por mënyra e llogaritjes ndryshon. Raporti aktual i leverazhit është i barabartë me totalin e ekuitetit ndaj totalit të mjeteve. Analiza e ndikimit të ndryshimit të treguesit të leverazhit tregon se edhe me ndryshimet në mënyrën e llogaritjes, niveli aktual i levës së sektorit mbetet i ngjashëm me rënie të lehtë të treguesit sipas metodologjisë së re të llogaritjes.

***Rregullorja mbi Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit***, e cila është kërkesë e Shtyllës së Dytë të Kornizës së Bazelit për Kapital, ka përcaktuar procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit të bankës me qëllim të menaxhimit të rrezikut, përcaktimit të strategjive të rrezikut dhe planifikimit të kapitalit. Adaptimi i kësaj rregullore do të ndikojë në ngritjen e kapaciteteve si për vlerësim të rrezikut nga vetë bankat, ashtu edhe për monitorim të rrezikut dhe kërkesave për kapital nga mbikëqyrësi, duke ndikuar në avancimin e procesit për ruajtje të stabilitetit financiar.

Vlerësimet për ndikimin që këto rregullore mund të kenë për secilën bankë individuale si dhe në sektorin bankar në përgjithësi sugjerojnë që bankat posedojnë kapacitete adekuate për adaptimin e ndryshimeve pa ndonjë ndikim negativ në treguesit përkatës dhe performancën e tyre financiare. Gjithashtu, gjatë vitit 2018, është punuar në ngritjen e kapaciteteve për sigurimin e aplikimit efektiv të rregulloreve, të cilat pritet të hyjnë në fuqi në fillim të vitit 2020. Hyrja në fuqi e këtyre rregulloreve pritet të ndikojnë në rritjen e qëndrueshmërisë së stabilitetit financiar të sektorit përmes mundësisë së mbikëqyrjes më prudente të bankave, rritjes së cilësisë së kapitalit dhe rritjes së aftësisë së sektorit për mbrojtje ndaj rreziqeve. Gjithashtu, hyrja në fuqi e rregulloreve do të shoqërohet me rishikim të kërkesave minimale të publikimit të informacionit nga bankat, të cilat do të ndikojnë në rritjen e transparencës dhe disiplinës së tregut.

## 5.5. Financimi dhe Rreziku i Likuiditetit

Burimi kryesor i financimit të aktivitetit të bankave vazhdon të përfaqësohet nga depozitat të cilat shënuan rritje, kryesisht nga ekonomitë familjare. Nën ndikimin e normave të ulëta të interesit pjesëmarrja e depozitave të transferueshme është zgjeruar që në kombinim me rritjen e kreditimit afatgjatë kontribuan në theksimin e mospërputhjeve të maturimeve në më të këtyre zërave. Kjo mund të krijojë pasiguri për stabilitetin e financimit të sektorit në kuptimin që tërheqjet e menjëhershme të depozitave të transferueshme janë më pak të parashikueshme si dhe mundësia e konvertimit të mjeteve të tjera likuide në para të gatshme është e kufizuar dhe e pasigurt në situata jo të favorshme ekonomike. Megjithatë indikatorët kryesor të likuiditetit japin sinjale pozitive për gjendjen aktuale të likuiditetit bankar, ku niveli i lartë i rezervave të likuiditetit të bankave që mbahen në BQK por edhe i gjetshëm aseteve likuide, e bën sektorin më rezistent ndaj efekteve të mundshme negative që mund të rezultojnë nga mospërputhjet e afateve të maturimit në mes të investimeve dhe financimit.

### 5.5.1 Financimi bankar

**Struktura e financimit të sektorit bankar dominohet nga financimi prej sektorit jo-bankar, kryesisht depozitave të cilat vazhduan rritjen.**


Në vitin 2018, depozitat përbënin 80.5 përqind të financimit, përderisa vetëm depozitat e sektorit jo-bankar (ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare) konsistojnë në 88.7 përqind të gjithë depozitave, gjë që tregon se financimi ndër-bankar është në nivel shumë të ulët dhe se bankat janë shumë pak të ekspozuara ndaj

<sup>29</sup> Masa e kapitalit përfshinë kapitalin e Klasit të parë sipas Rregullores së re të Adekuatshmërisë së Kapitalit, ndërsa masa e ekspozimit përfshinë ekspozimet

bilancore, derivative, të transaksioneve të letrave me vlerë, dhe zërat jashtë-bilancore.

financimit në sektorin e jashtëm (figura 68).


Figura 68. Struktura e financimit



Burimi: BQK (2019)

Depozitat shënuan rritje vjetore prej 8.7 përqind duke arritur në vlerën prej 3.4 miliardë euro. Ndërsa vetëm depozitat e sektorit jo-bankar arritën në 2.95 miliardë euro, dhe u rritën me normë vjetore prej 7.5 përqind. Bankat vazhdojnë të financojnë aktivitetin e rritur kreditor kryesisht nga depozitat. Këtë vit depozitat tejkaluan kreditë për 122.0 përqind, tregues që u zvogëlua për 2.5 pikë përqindje nga viti paraprak, nën ndikimet e zgjerimit të aktivitetit kreditues (figura 69).

Figura 69. Rritja e kredive dhe depozitave të sektorit bankar




Burimi: BQK (2019)

**Depozitat e ekonomive familjare, të cilat paraqesin burimin kryesor të financimit, vazhduan rritjen pavarësisht mbizotërimit të normave të ulëta të interesit në treg.**

Trendi i rritjes vazhdoi edhe këtë vit, me ritëm të përshpejtuar prej 7.7 përqind nga 2.1 përqind në vitin 2017 (figura 69). Stoku i depozitave të ekonomive familjare arriti në 2.3 miliardë euro.

Pjesa më e madhe e tyre ishin depozita të transferueshme, të cilat me rritjen e tyre vjetore prej 10.5 përqind kontribuan në rritjen e gjithsej depozitave të ekonomive familjare (figura 70).


Figura 70. Struktura e depozitave



Burimi: BQK (2019)

**Depozitat e ndërmarrjeve vazhduan trendin e rritjes me 7.0 përqind rritje vjetore, edhe pse ishte rritje më e ulët krahasuar me vitin paraprak. Depozitat e ndërmarrjeve u mbështetën nga performanca pozitive financiare e ndërmarrjeve si dhe rritja e lehtë e normës mesatare të interesit në këto depozita gjatë vitit 2018.**

Figura 71. Struktura e depozitave sipas afatit të maturimit




Burimi: BQK (2019)

Stoku i depozitave të ndërmarrjeve arriti në 622.1 milionë euro, me pjesëmarrje 18.5 përqind në gjithsej depozitat. Rritja e depozitave të ndërmarrjeve u ndikua kryesisht nga rritja e depozitave të transferueshme prej 7.0 përqind, për shkak të efektit të bazës. Depozitat e afatizuara u karakterizuan me rritje prej 4.0 përqind, që mund të jetë ndikuar

nga rritja e lehtë për 0.20 pikë përqindje e normës mesatare të interesit për këto depozita gjatë vitit 2018, e cila arriti në 1.63 përqind.

**Struktura e gjithsej depozitave sipas afatit të maturimit dominohet nga depozitat e transferueshme, të cilat shënuan rritje edhe këtë vit, me normë vjetore prej 7.9 përqind.** Depozitat e transferueshme arritën në 60.0 përqind të gjithsej depozitave në vitin 2018 (figura 71). Ndërsa, 39.7 përqind e gjithsej depozitave përbëhet nga depozitat e transferueshme të ekonomive familjare. Depozitat e afatizuara shënuan rritje të theksuar vjetore prej 17.4 përqind, ndërsa depozitat e kursimit shënuan rënie vjetore prej 0.6 përqind. Mbizotërimi i normave të ulëta të interesit mbi depozita të kursimit po reflekton dekurajim të kursimit tek ekonomitë familjare, përderisa e kundërta ndodh me depozitat e afatizuara ku pasqyrohet ndikimi i rritjes së normës së interesit në këto depozita edhe pse në nivel ende të ulët.

Figura 72. Struktura e afateve të maturimit të depozitave dhe kredive



Burimi: BQK (2019)

**Afatet e maturimit të depozitave dhe kredive theksojnë mospërputhjet strukturore ndërmjet tyre, të cilat janë më të shprehura tek afatet ‘deri në 1 vit’ dhe ‘mbi 1 vit deri në 2 vite’.** Depozitat me afat maturimit ‘deri në 1 vit’ edhe pse me pjesëmarrjen në ulje nga 45.0 përqind në 40.3 përqind dominuan strukturën e depozitave të afatizuara. Përderisa, kreditë me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ janë ato që kanë pjesëmarrjen më të lartë (prej 38.1

përqind) në gjithsej kreditë dhe të cilat në vitin 2018 zgjeruan tutje pjesëmarrjen e tyre (figura 72).

Pjesëmarrja e lartë e depozitave të transferueshme dhe e dominimit të depozitave me maturim afatshkurtër në njërin anë, dhe në anën tjetër rritja e kreditimit afatgjatë ka rritur presionet për financim të qëndrueshëm të bankave, që mund të manifestohet në presione të konkurrencës në sistemin bankar sa i përket lëvizjeve të normave të interesit.

Presionet e konkurrencës për zvogëlim të normave të interesit në kredi për stimulim të aktivitetit kreditor, njëkohësisht mund të krijojë presione për rritje të normave të interesit në depozita nga disa banka me qëllim të nxitjes së kursimeve për të siguruar financim më stabil.

### 5.5.2 Rreziku i Likuiditetit

**Spektori bankar vazhdon të mbajë pozitë të kënaqshme të likuiditetit. Asetet likuide qëndrojnë në nivele të larta dhe në rritje, gjë që u reflektua edhe përmes rritjes së raportit të tyre ndaj detyrimeve afatshkurtra gjatë vitit. Raporti më i lartë se minimumi rregullator<sup>30</sup> tregon për potencial të zgjerimit të aktivitetit kredites.** Në vitin 2018 raporti i aseteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra u rrit në 38.5 përqind nga 37.9 përqind në vitin 2017.


Ky rezultat u ndikua nga rritja më e lartë e aseteve likuide se sa rritja e detyrimeve afatshkurtra prej 9.4 përqind, dhe 7.7 përqind respektivisht.

Po ashtu edhe raporti i aseteve likuide ndaj gjithsej aseteve u rrit lehtësisht në 28.9 përqind (28.7 përqind në vitin 2017), si rezultat i rritjes më të lartë të aseteve likuide kundrejt gjithsej aseteve (figura 73).

<sup>30</sup> Raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra është i definuar në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut të Likuiditetit prej 25% (neni 17. Norma e likuiditetit)



Figura 73. Indikatorët e likuiditetit



Rritja e aseteve likuide gjatë periudhës rezultoi nga rritja prej 25.7 milionë euro e depozitave dhe plasmaneve në bankat vendore me afat maturimi deri në 30 ditë dhe e depozitave e plasmaneve në institucionet jo-financiare prej 4.5 përqind, rritja prej 18.0 përqind e parave të gatshme dhe rritja prej 4.1 përqind e bilancit të rezervave me BQK-në. Po ashtu, fletë obligacionet e Republikës së Kosovës shënuan rritje vjetore prej 33.5 përqind. Ndërsa, rënie shënuan instrumentet financiare të institucioneve financiare ndërkombëtare, fletë obligacionet e qeverive të huaja dhe bonot e thesarit të Republikës së Kosovës. Rezervat e likuiditetit me BQK-në përbëjnë rreth 29 përqind të aseteve likuide, duke qenë kategoria e dytë kryesore pas instrumenteve financiare.


**Rezervat e likuiditetit të bankave komerciale vazhdojnë të jenë në nivele të larta, duke tejkaluar rezervën e obliguar të mbajtur në BQK për 49.7 përqind.** Nga gushti i vitit 2016, BQK ka aplikuar normë negative të interesit mbi tepricën e rezervës së obliguar që bankat komerciale në vend i mbajnë në bankën qendrore, në linjë me zhvillimet ndërkombëtare si dhe vendimin e BQE-së për aplikim të normave negative në depozita.

Aplikimi i normës negative ndikoi tepricën e rezervës menjëherë në muajin vijues, ku në shtator të vitit 2016 teprica u zvogëlua për 29.9 përqind (figura 74).<sup>31</sup> Megjithatë, nuk janë

<sup>31</sup> Teprica e likuiditetit karakterizohet me efekte të sezonalitetit. Tendencja për rritje të nivelit të rezervave të tepërta të likuiditetit vërehet gjatë muajve të tremujorit të tretë dhe në muajin dhjetor të viteve përkatëse. Teprica e

vërejtur efekte afatgjata të masave të ndërmarra përmes normës negative në nivelin e tepricës së rezervës, potencialisht për shkak të mundësive të kufizuara për ruajtje apo edhe investim të mjeteve si rezultat i normave të ulëta të interesit.

Figura 74. Rezervat e likuiditetit



Burimi: BQK (2019)


**Ambienti i normave të ulëta të interesit është duke stimuluar ekonominë familjare të zhvendosin depozitat e tyre në favor të maturitetit afatshkurtër, që krahas trendit të përshpejtimit të kreditimit afatgjatë rezultoi në theksimin e mospërputhjeve të maturitetit ndërmjet aseteve dhe detyrimeve në vitin 2018.** Depozitat e ndërmarrjeve e posaçërisht të ekonomive familjare janë burim i financimit të aktivitetit të rritur kreditor të bankave. Mospërputhjet e afateve të maturimit ndërmjet investimeve dhe financimit po rriten në kushtet kur depozitat e transferueshme janë rritur dhe afatet e maturimit të kredive janë zgjatur, lëvizje kjo që rritë ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit.

Hendeku kumulativ i likuiditetit u zgjerua në 494.4 milionë euro nga 463.8 milionë euro një vit më parë. Në këtë rezultat ka ndikuar kryesisht zgjerimi më i theksuar i hendekut pozitiv ndërmjet aseteve dhe detyrimeve të afateve të maturimit mbi 5 vite. Gjithashtu zgjerim të hendekut pozitiv kishte edhe në kategoritë me afat maturimi 3-6 muaj dhe 1-5 vite . Rreth 38.6 përqind e gjithsej aseteve

rezervës në tremujorin e tretë të këtij viti ishte për 49.0 përqind më e lartë se në tremujorin e dytë, ndërsa në dhjetor teprica ishte për 18.7 përqind më e lartë se në muajin nëntor.

kategorizohen në afatin '1-5 vite' në raport me detyrimet e këtij afati që përbëjnë vetëm 11.6 përqind të gjithsej detyrimeve.

Figura 75. Hendeku i likuiditetit\*



Hendeku negativ rezulton vetëm në afatin e maturimit '1-7 ditë', vlera e të cilit qëndron në -1.7 miliardë euro. Në këtë kategori të afatit të maturimit bëjnë pjesë 71.0 përqind e gjithsej detyrimeve, ndërsa asetet konsistojnë 20.2 përqind. Rrjedhimisht mospërputhjet e afateve të maturimit të zërave bilancor janë më të theksuarat në kategoritë e maturimit '1-7 ditë' dhe '1-5 vite' (figura 75). Kjo situatë paraqet sfidë për menaxhimin e likuiditetit të bankave dhe në të ardhmen mund të kufizoj mundësitë në favor të kreditimit afatgjatë.

Tabela 6. Supozimet e rrezikut kreditor

Indikatorët	Skenari bazë	Skenari i moderuar	Skenari i rëndë
	<b>Supozimet</b>		
BPV (norma e rritjes reale, %)	4.2	0.5	-2.5
Kredia (norma e rritjes së kreditimit, %)	10.0	5.0	0.0
Ndryshimi në normë të interesit në pozicionet neto të bilancit me ndjeshmëri ndaj NI (pp.)	n/a	+ 1 pp.	+ 2 pp.
Devaluimi i EUR ndaj valutave tjera (pp.)	n/a	10	20
Tronditjet në profit: Profitit * (1 - marzhi reduktues%)	n/a	50	60

Burimi: BQK (2019)

Rezultatet nga testi i goditjeve në pozitën e likuiditetit sugjerojnë se sektori bankar posedon kapacitet financiar për të përballuar situatat e supozuara të tërheqjes së një shume

## 5.6. Kapacitetit absorbues i goditjeve - analiza stress-test<sup>32</sup>

Sipas rezultateve nga testi i goditjeve në portfolion kreditor, pozita kapitale e sektorit bankar paraqitet përgjithësisht e qëndrueshme, me shumë pak ndjeshmëri edhe ndaj skenarit të rëndë ku është supozuar situatë ekstreme e përkeqësimit të ekonomisë (tabela 6). Gjithsesi, sektori bankar rezulton profitabil dhe me provizione mjaftueshëm të ndara për mbulimin e humbjeve që rezultojnë nga rritja e kredive jo performuese nën situatat e supozuara të goditjeve në ekonomi.

Në skenarin e moderuar dhe të rëndë ku supozohet se normat e interesit do të rriten, e që kryesisht do të afektonin kreditë dhe depozitat (për shkak të pjesëmarrjes së lartë të tyre në bilancin e gjendjes), vetëm disa banka të vogla do të pësonin humbje, përderisa sektori do të paraqitej stabil. Megjithatë, këtu ekziston rreziku se në kohë krize mundësia për ri-investimin e mjeteve të maturuara kufizohet dhe në të njëjtën kohe rritet rreziku i mbingarkesës së huamarrësve me interes më të lartë, mirëpo ky rrezik nuk është marrë parasysh në analizën stres test

të konsiderueshme të depozitave. Në të gjithë skenarët e supozuar, pozita e likuiditetit e shumicës së bankave rezulton e qëndrueshme (tabela 9).

<sup>32</sup> Stress Test nuk përfaqëson një model parashikimi, por përmban skenarë të supozuar të goditjeve makroekonomike dhe financiare me qëllim të matjes së rezistencës së sektorit bankar ndaj këtyre goditjeve negative, pa

paragjykime që situata të tilla mund të ndodhin apo priten të ndodhin në të ardhmen.



### 5.6.1 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve makroekonomike dhe financiare në portfolion kreditor dhe pozitën kapitale

Analiza stres-test për rrezikun kreditor ka vlerësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar për periudhën e ardhshme një vjeçare ndaj tronditjeve të mundshme në portfolion kreditor si dhe në pozitën kapitale, të cilat mund të paraqiten nga zhvillimet e pafavorshme makroekonomike. Analiza është realizuar përmes aplikimit të tri skenarëve:


skenarit bazë, të moderuar dhe atij të rëndë (tabela 6). Skenari bazë mbështetet në zhvillimet makroekonomike të pritshme. Në këtë skenar, aktiviteti ekonomik në vend parashikohet të ketë një rritje pozitive prej 4.2 përqind. Rritja ekonomike supozohet se do të shoqërohet me rritje dyshifrore të kreditimit<sup>33</sup> dhe njëkohësisht do të ndikojë në përmirësim e portfolios kreditor<sup>34</sup> (tabela 6 dhe 7). Po ashtu këto zhvillime pritet që të përmirësojnë tutje performancën e sektorit bankar në aspektin e kapitalizimit.

**Tabela 7. Koeficienti i elasticitetit të normës së KJP-ve**

Përshkrimi	Elasticiteti	Reagimet e normës së KJP-ve		
		Skenari bazë	Skenari i moderuar	Skenari i rëndë
Rritja reale e BPV-së (%)	-0.56 pp	-2.35 pp		
Zgjerimi i hendekut të prodhimit	0.80 pp		2.80 pp	5.20 pp
Rritja e normës së interesit në kredi (pp)	0.20 pp		0.20 pp	0.40 pp

Burimi: BQK (2019)

**Figura 76. Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit, sipas skenarëve**



Burimi: BQK (2019)

Megjithatë, profiti është supozuar të mbetet pothuajse i njëjtë me këtë vit mbi arsyetimin se të hyrat nga interesi në kredi mund të rriten nga efekti i rritjes së vlerës së kredisë por ky efekt mund të kufizohet nga presionet e vazhdueshme për rënie të normave të interesit në kredi, ndërsa të hyrat nga jo-interesi supozohet që nuk do të vazhdojnë të rriten për shkak të hapësirës së kufizuar për rritje të

mëtejme të tarifave dhe komisioneve. Në anën tjetër shpenzimet e jo-interesit priten të bien për shkak të zvogëlimit të nevojës për provizione shtesë si rezultat i përmirësimit të portfolios kreditor, por shpenzimet e interesit mund të rriten për shkak të presioneve të konkurrencës për rritje të normave të interesit në depozita. Rrjedhimisht efektet e rritjes dhe rënies së përbërësve të profitit do ta përjashtojnë njëra tjetrën duke na lënë të supozojmë se profiti mbetet afër nivelit të vitit aktual. Në këtë skenar nuk është përfshirë rreziku që vie nga tregu. Kjo duke u bazuar në deklaratimet nga bankat se normat e interesit në kredi pritet që të bien lehtësisht<sup>35</sup>, ndërsa norma e interesit në asete tjera, që kryesisht ndikohen nga vendimet e BQE-së, si interesi mbi depozitat që mbahen në bankat evropiane, kanë dhënë sinjale se nuk do të zvogëlohen tutje. Prandaj në këto kushte në këtë skenar është supozuar që normat e interesit në asete

<sup>33</sup> Sipas parashikimeve të bankave për 2019, rritja vjetore e kreditimit të sektorit bankar do të jetë 10.4 përqind, siguruar nga Departamenti i Mbikqyrjes Bankare

<sup>34</sup> Efekti i rritjes ekonomike në cilësinë e portfolios kreditor do të llogaritet përmes një koeficienti të elasticitetit të kredive jo-performuese ndaj

BPV-së prej 0.56 pikë përqindje. Koeficienti është matur në bazë të modelit empirik Vector Error Correction, me seri kohore nga viti 2006 deri në dhjetor 2017. Rezultati i modelit ka sygjerruar se një rritje e BPV-së reale me 1% do të ulë raportin e kredive jo performuese me 0.56 pikë përqindje.

<sup>35</sup> Anketa e kreditimit bankar.


dhe detyrime do të mbahen të njëjta me vitin aktual.

Rezultatet në bazë të këtyre supozimeve sugjerojnë për përmirësim të mëtejshëm të cilësisë së portfolios kreditore. Raporti i kredive jo performuese do të zbriste në 0.3 përqind nga niveli aktual prej 2.7 përqind. Pozita kapitale po ashtu do të përforcohej si rezultat i rritjes së kreditimit dhe performimit të kredive, ku TMK (Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit) e sektorit do të ngritet në 21.0 përqind nga niveli aktual prej 16.9 përqind (figura 76 dhe tabela 8).

Në skenarin e moderuar supozohet se në vitin 2019 do të ketë rritje ekonomike prej 0.5 përqind, që është shumë më e ngadalësuar se viti 2018 (tabela 6). Ngadalësimi i rritjes ekonomike mendohet se do të ketë efekte dekurajuese, duke shkaktuar mosshfrytëzim të kapaciteteve, rrjedhimisht zgjerim të hendekut të prodhimit.<sup>36</sup> Rritja e ngadalësuar ekonomike do të shoqërohet edhe me tkurrje të rritjes së kreditimit, zhvlerësim të valutës euro kundrejt valutave të tjera e aplikuar në pozicionet neto në valutë dhe rritje të normës së interesit e aplikuar në hendekun e bilancit të gjendjes më ndjeshmëri ndaj normave të interesit ( $\Delta$  Të hyrat neto nga interesit =  $\text{Hendekui} \times \Delta \text{NI}$ ).

Këto zhvillime do ta përkeqësojnë deri në një masë cilësinë e portfolios kreditore dhe performancën e sektorit. Nën ndikimin e këtyre supozimeve, raporti i kredive jo performuese të sektorit do të rritet për 3.0 pikë përqindje, apo në nivelin 5.7 përqind nga niveli aktual 2.7 përqind. Humbjet e sektorit do të arrijnë vlerën prej 31.3 milionë euro (figura 77). Këto humbje do t'i ngarkohen direkt kapitalit, që si rezultat do ta zbrisnin treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 16.3 përqind për vitin 2019 (tabela 8).

Figura 77. Rezultatet e stress testit për rrezikun kreditor-humbjet dhe rikapitalizimi



Burimi: BQK (2019)

Në nivel të bankave individuale, dy banka do të përballeshin me probleme kapitalizimi, TMK e të cilave do të zbriste në 10.3 përqind dhe 10.1 përqind, respektivisht, që është nën minimumin rregullator. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të arrijnë vlerën prej 7.5 milionë euro (tabela 8). Njëra nga dy bankat nuk ka rëndësi të përgjithshme sistemike dhe vepron si degë e bankës amë, që sipas rregullativës në fuqi, kërkesat minimale për kapital janë të kufizuara në bazë të kapitalit të bankave përkatëse amë, prandaj edhe interpretimi i rezultateve për këto banka merret më i rezervuar. Përderisa, tjera është bankë me rëndësi sistemike, për më tepër ka ndërruar status nga degë e bankës së huaj në bankë të mëvetësishme gjatë vitit 2018 dhe si pasojë BQK i ka lejuar periudhë kohore njëvjeçare për të përshtatur kapitalin e saj në linjë me kërkesat rregullatorë përkatëse.

Në skenarin e rëndë është vlerësuar ndjeshmëria e sektorit bankar ndaj zhvillimeve negative ekstreme makroekonomike dhe financiare, që zakonisht karakterizohet me përkeqësim të investimeve, dekurajim të kërkesës së brendshme, rënie të të ardhurave, dobësim të aftësisë paguese të huamarrësve. Ky skenar është realizuar duke aplikuar supozimin së rënia ekonomike do të jetë 2.5 përqind, dhe kjo rënie do të reflektohej në përkeqësimin e cilësisë së portfolios kreditore, e llogaritur në bazë të koeficientit të reagimit të normës së KJP-ve ndaj hendekut të

<sup>36</sup> Ndikimi i këtyre zhvillimeve në cilësinë e portfolios kreditore është llogaritur përmes koeficientit të elasticitetit të kredive jo-performuese ndaj

hendekut të prodhimit prej 0.8pp. Material kërkimor i FMN-së, i papublikuar, 'CESE Bank Loss Projection and Stress Testing Exercise', Korrik 2009.

prodhimit.<sup>37</sup> Si pasojë e tronditjeve në sektorin real, është supozuar që kreditimi nuk do të shënojë rritje në vitin vijues. Zhvlerësimi i valutës euro ndaj valutave tjera është supozuar më i lartë se në skenarin e moderuar. Po ashtu në këtë skenar është supozuar rritje më e lartë e normave të interesit në pozicionet bilancore, se në skenarin e moderuar (tabela 7). Praktikisht dëshmojnë se në kohë krize reagimi fillestar i kreditorëve do të ishte rritja e normave të interesit për shkak të rritjes së rrezikut. Ndërsa si kundërpërgjigje kërkesa për huamarrje do të zvogëlohej për shkak të pasigurisë që krijohet për të investuar e që rrjedhimisht në fazë të mëvonshme do të krijonte presione për zvogëlim të normave të interesit me qëllim të stimulimit të aktivitetit ekonomik. Megjithatë, supozimi i rritjes së normave të interesit në këtë skenar është mbështetur në situatën aktuale të mundësive tashmë të kufizuara të sektorit bankar për zvogëlim të mëtejme të normave të interesit në burimet e financimit si dhe duke u bazuar në faktin se autoriteti monetar i unionit evropian ka dhënë sinjale se mundësia për zvogëlim të mëtejme të normave të interesit është shumë e vogël. Analiza mbështetet në gjendje statike 1 vjeçare të bilancit të gjendjes, prandaj konsiderohet se të njëjtat instrumente që maturojnë brenda një viti do të ri-investohen dhe ririfinancohen me norma të interesit të supozuara në këtë skenar. Në analizë nuk konsiderohet mundësia e realizimit të kolateralit, riprogramimit të kredive apo rritja e kapitalit nga burime të tjera, duke qenë se efikasiteti dhe mundësia e realizimit të këtyre veprimeve është shumë e pasigurt në kohë krize.

Profiti supozohet se do të pësojë tronditje si rezultat i mos rritjes së kreditimit dhe rritjes së shkallës së dështimit të kredive ekzistuese. Këto supozime janë reflektuar në llogaritjen e profitit për vitin 2019 ashtu që për bazë është marrë profiti neto pas tatimit të realizuar gjatë

<sup>37</sup> Meqenëse sensitiviteti i kredive jo-performuese ndaj BPV-së është llogaritur bazuar në të dhënat kur vendi ka pasur vetëm periudha të rritjes ekonomike, kjo nuk do të thotë se me të njëjtën magnitudë do të reagojnë norma e KJP-ve në rrethana të rënies ekonomike. Prandaj në skenarin e rëndë ku është supozuar rënie ekonomike, sensitiviteti i KJP-ve është bazuar në koeficientin e reagimit ndaj hendekut të prodhimit dhe jo ndaj BPV-së.

vitet 2018, ndaj të cilit pastaj është aplikuar tronditje (marzh reduktues) prej 60 përqind dhe janë zbritur të hyrat që do të realizoheshin po qe se nuk do të rriteshin KJP-të.<sup>38</sup>

Në skenarin e rëndë portfolio kreditore do të përkeqësohet, ku pjesëmarrja e kredive jo performuese ndaj gjithsej kredive do të rritet për 5.6 pikë përqindje, në 8.3 përqind. Humbjet e sektorit do të arrinin vlerën prej 80.9 milionë euro (figura 77). Megjithatë, niveli i lartë i provizioneve të mbajtura nga bankat individuale bën që sektori të paraqitet më rezistent ndaj goditjeve të supozuara në këtë skenar, sa i përket pozicionit të kapitalit. Niveli i kapitalizimit pas goditjes rezulton 14.8 përqind për vitin 2019, që është mjaftueshëm mbi kërkesat rregullative (tabela 8). Për më tepër edhe supozimi i rritjes së normave të interesit ka dhënë efekte pozitive në të hyrat neto nga interesi, duke u mbështetur në faktin se sektori ka hendek pozitiv të bilancit me ndjeshmëri ndaj normave të interesit dhe nën supozimin se të njëjtat pozicione do të ri-investohen, atëherë si rrjedhojë të hyrat e sektorit do të jenë më të larta pavarësisht efekteve të tjera negative që mund të ketë ky supozim (p.sh. rritja e kostos për huamarrësit). Efekti i zhvlerësimit të euros në të hyrat e sektorit paraqitet në nivel të ulët por pozitiv për shkak të pozicionit të hapur neto pozitiv që kishte sektori gjatë vitit aktual. Kjo do të thotë se zhvlerësimi i mundshëm i euros ndaj valutave tjera do të sillte të hyra më të larta ngase vlera neto ekuivalente në euro do të rezultonte më e lartë.

Në nivel të bankave individuale, si në rastin e skenarit të moderuar dy bankat e njëjta të sipërpërmendura, do të përballëshin me probleme kapitalizimi, TMK e të cilave do të ju zbriste në 8.3 përqind dhe 8.2 përqind, respektivisht. Mjetet shtesë të nevojshme për ngritjen e kapitalit në nivelin minimal të kërkuar do të ishin gjithsej 14.7 milionë euro (figura 77, tabela 8).

<sup>38</sup> Vlerësimi i të hyrave të 'humbura' si pasojë e rritjes së KJP-ve është bërë fillimisht duke llogaritur ex-post normën e përgjithshme të interesit në kredi për secilën bankë, e cila më pastaj është shumëzuar me vlerën e shtuar të KJP-ve.

Skenari i rrezikut nga dështimi i ekspozimeve të mëdha kreditore: në këtë skenar është vlerësuar qëndrueshmëria e bankave ndaj dështimit të mundshëm të tre dhe pesë kredi marrësve më të mëdhenj. Supozimi i dështimit të tre kredi marrësve më të mëdhenj do të ndikonte që niveli i kapitalizimit në nivel sektori të bie në 14.0 përqind dhe humbja të arrijë në 102.7 milionë euro (figura 77 dhe tabela 8). Dy bankat e sipër përmendura prap do të përballëshin me humbje të larta, ku njëra duke qenë degë e bankës së huaj<sup>39</sup>, TMK do t'i binte në nivele negative. Kjo do të thotë se këto dy banka duhet të sigurojnë 54.1 milionë euro për të arritur kapitalin në nivelin e kërkuar.

Dështimi i pesë kredi marrësve më të mëdhenj do ta përkeqësonte edhe më tej gjendjen në këto dy banka si dhe një bankë me rëndësi të përgjithshme sistematike do të paraqitej e nën-kapitalizuar. Humbjet do të arrinin në gjithsej 142.8 milionë euro dhe TMK e sektorit do të zbriste afër kufirit rregullator, në 12.5 përqind. Të tri bankave të nën-kapitalizuara do të ju nevojiteshin 88.7 milionë euro shtesë për ngritje të kapitalit (figura 76 dhe tabela 8). Rezultatet e këtij skenari sugjerojnë se sektori nuk ka përqendrim të lartë të ekspozimeve kreditore, mirëpo mund të thuhet që degët e bankave të huaja ndikojnë dukshëm në rritjen e shkallës së ekspozimeve të mëdha kreditore të gjithsej sektorit.

**Tabela 8. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik kreditor**

Përshkrimi	Numri i bankave me TMK<12%	Norma e kapitalizimit			Norma e KJP-ve			Mjetet shtesë të nevojshme për rikapitalizim (në mijëra euro)
		niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	niveli më i lartë	niveli më i ulët	niveli i sektorit	
Nivelet aktuale (para goditjeve)		117.6	11.8	16.9	4.3	0.2	2.7	
Rezultatet e skenarëve								
Skenari bazë: Rënia e KJP për 2.35pp, rritja e kreditimit për 10%		112.8	14.9	21.1	2.0	-2.2	0.3	
Skenari i moderuar: Rritja e NPL për 3.00pp, ngadalësimi i rritjes vjetore të kreditimit për 5.9pp., rritja e normës së interesit për 1pp. e aplikuar në hendekun e bilancit me ndjeshmëri ndaj NI, përshtatja e pozicioneve në valutë në bazë të devalvimit të EUR për 10pp.	2	120.6	10.1	16.3	7.3	3.2	5.7	7,539
Skenari i rëndë: Rritja e NPL për 5.60pp, stagnim i kreditimit, rritja e normës së interesit për 2pp. e aplikuar në hendekun e bilancit me ndjeshmëri ndaj NI, përshtatja e pozicioneve në valutë në bazë të devalvimit të EUR për 20pp.	2	130.0	8.2	14.8	9.9	5.8	8.3	14,675
Dështimi i tre kredimarrësve më të mëdhenj	2	132.6	(20.8)	14.0	39.7	0.3	9.2	54,092
Dështimi i pesë kredimarrësve më të mëdhenj	3	132.6	(33.0)	12.5	53.7	0.3	10.9	88,738

Burimi: BQK (2019)

### 5.6.2 Vlerësimi i qëndrueshmërisë ndaj goditjeve në pozitën e likuiditetit

Testi i qëndrueshmërisë së pozitës së likuiditetit të sektorit bankar ka për qëllim që të vlerësojë aftësinë financuese të bankave për të përballuar mungesën e likuiditetit të shkaktuar nga situatat ekstreme.

Testi është mbështetur në dy skenarë hipotetik që vlerësojnë mjaftueshmërinë e mjeteve likuide të bankave për të përballuar tërheqjet e një vlere të depozitave brenda 5 ditësh si dhe përballimin e rrezikut nga dështimi i depozitave të koncentruara. Skenarët janë

mjaftë konservativ për faktin se nuk është marrë parasysh mundësia që bankat të plotësojnë një pjesë të nevojave të likuiditetit përmes burimeve të jashtme të financimit.

### Skenari 1: Tërheqja e depozitave në baza ditore

Në këtë skenar është konsideruar tërheqja e depozitave të ndara sipas strukturës dhe subjekteve, në nivele të ndryshme të tërheqjeve në baza ditore (tabela 9), për pesë ditë radhazi. Pas çdo dite ndahen 5% të depozitave nga depozitat e mbetura për qëllime të operimit të bankës në ditët vijuese. Kjo nënkupton që, nën paraqitjen e skenarëve

amë, prandaj edhe vlera dhe shkalla e ekspozimeve të mëdha kreditore është e lartë tek këto institucione.

<sup>39</sup> Duke operuar në cilësinë e degës së bankave të huaja, banka nuk është subjekt i rregullatës për kufizim të raportit të ekspozimeve ndaj kapitalit të klasit të parë të degës bankare, por ndaj kapitalit të klasit të parë të bankave

të supozuar, rezerva e detyrueshme prej 10 përqind do të përgjysmohej. Skenari po ashtu është ndërtuar mbi supozimin se gjatë kësaj periudhe mundësia e shëndërrimit të mjeteve


likuide në para të gatshme do të ishte 80 përqind e mjeteve likuide, ndërsa e mjeteve jo-likuide do të ishte vetëm 1 përqind e këtyre mjeteve brenda ditës.

**Tabela 9. Supozimet për skenarët e rrezikut të likuiditetit**

Tërheqja e depozitave	Supozimet për tërheqjet kohore	Niveli i tërheqjes së depozitave
Ekonomitë familjare - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Ndërmarrjet - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	9.0%
Subjektet e tjera - Depozitat e transferueshme	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Depozitat e kursimit	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	10.0%
Depozitat e afatizuara	Çdo ditë, për 5 ditë radhazi	8.0%
Pesë depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%
Njëzet depozitorët më të mëdhenj	Brenda ditës	100.0%

Burimi: BQK (2019)

**Figura 78. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit - skenari 1**



Burimi: BQK (2019)

Këto nivele të supozuara të tërheqjeve ditore janë bazuar në eksperiencat e sektorit bankar të vendeve të rajonit, të cilat kanë përjetuar situatat të tërheqjeve të konsiderueshme të depozitave, si pasojë e pasigurive në masë të shkaktuara nga destabiliteti politik dhe rrethana të krizave të tjera financiare të ndodhura në periudha të ndryshme. Prandaj, përderisa Kosova nuk ka historik të ngjarjeve të tilla, bazuar në praktikat e vendeve të rajonit është supozuar që në situata krize ky nivel i tërheqjeve do të mund të materializohej.


Rezultatet e skenarëve sugjerojnë që bankat do të mund të përballonin tërheqjen e depozitave sipas niveleve të përcaktuara, në baza ditore deri në ditën e katërt. Në ditën e pestë

probleme me likuiditet do të paraqiteshin në katër banka, duke përfshirë këtu tre banka me rëndësi të përgjithshme sistemike. Vlera e mjeteve likuide në mungesë për këto katër banka do të arrinte në 40.0 milionë euro (figura 78). Shkalla e tërheqjes së përgjithshme të depozitave në sektorin bankar në ditën e pestë do të arrinte në 32.7 përqind (tabela 9).

**Skenari 2: Tërheqja e depozitave nga depozitarët më të mëdhenj**

Pozita e likuiditetit të bankave rezulton të jetë në gjendje që të përballojë humbjet nën supozimet e skenarit mbi tërheqjet e mundshme të depozitave nga pesë depozitarët më të mëdhenj në secilën bankë.

**Figura 79. Rezultatet e ST për rrezikun e likuiditetit - skenari 2**



Burimi: BQK (2019)

Ndërsa nën supozimin se njëzet depozitarët më të mëdhenj të secilës bankë do të tërheqin depozitat e tyre brenda ditës, atëherë gjendja e likuiditetit do të dobësohet në dy banka. Mungesa e mjeteve për këto dy banka do të arrijë në 6.3 milionë euro (figura 79, tabela 10). Rezultatet e këtij skenari përgjithësisht sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimit të financimit, që janë depozitat si përbërës kryesor i detyrimeve.

#### 5.6.2.1 Niveli përballues i tërheqjes së depozitave para se pozita e likuiditetit të arrijë nivelet kritike

Problemet me likuiditet për tërë sektorin bankar do të paraqiteshin në rast të tërheqjes së 24.9 përqind të depozitave brenda ditës, që nënkupton se sektori bankar mund të jetë në gjendje të përballojë tërheqjen e afër një të katërtës (1/4) së gjithsej depozitave pa pasur nevojë për mjete likuide shtesë (figura 79 dhe tabela 10). Ndërsa në nivel të bankave, banka me pragun më të ulët të tërheqjeve qëndron në 14.9 përqind, ndërsa banka me më të lartin në 45.4 përqind (si rezultat i nivelit të lartë të mjeteve likuide që posedon kjo bankë).

**Tabela 10. Rezultatet e skenarëve të stres testit për rrezik të likuiditetit**

Rezultatet e skenarëve të rrezikut kreditor	Numri i bankave me mungesë të mjeteve likuide	Niveli i depozitave të tërhequra (%)	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (në mijëra euro)	Raporti Kredi/Depozitë
<b>Skenari 1:</b> Tërheqja e depozitave në baza ditore në fund të ditës së pestë	4	-32.7%	(39,976.8)	121.4%
<b>Skenari 2.1:</b> Tërheqja e depozitave nga 5 depozitorët më të mëdhenj	0	-8.3%	-	89.1%
<b>Skenari 2.2:</b> Tërheqja e depozitave nga 20 depozitorët më të mëdhenj	2	-14.2%	(6,293.7)	95.2%
<b>Pragu</b> - Tërheqja e depozitave deri në nivelin kritik të likuiditetit		-24.9%	(3,069.8)	108.8%

Burimi: BQK (2019)




## 6. Institucionet financiare jo-bankare

### 6.1 Sektori Pensional

#### Aktiviteti i sektorit pensional

**Ecuria pozitive e kontributeve të reja ndikoi që ky sektor gjatë vitit 2018 të zgjerohet, por me ritëm të ngadalësuar.**

Figura 80. Asetet e sektorit pensional



Burimi: BQK (2019)

Vlera e aseteve të sektorit pensional u karakterizua me një rritje vjetore prej 2.2 përqind, duke arritur në 1.69 miliardë euro (figura 80). Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) përfaqëson pjesën më të madhe të aseteve të sektorit (99.6 përqind), ndërsa pjesa e mbetur menaxhohet nga Fondi Slloveno-Kosovar i Pensioneve (FSKP). Arkëtimet e reja shënuan rritje vjetore prej 8.1 përqind, vlera e të cilave arriti në 172.7 milionë euro nga rreth 34.9 mijë kontribuues të rinj këtë vit.


**Struktura e aseteve të FKPK-së vazhdon të dominohet nga investimet në tregun e jashtëm, të cilat kryesisht mbahen në formë të fondeve të përbashkëta, që diversifikojnë rrezikun përmes investimit në aksione dhe bono të thesarit të qeverive të huaja.**

Deri në dhjetor 2018, portfolio investuese në tregjet e huaja u zvogëlua për 17.0 përqind, e kryesisht si pasojë e performancës dhe kthimit negativ në investime gjatë pjesës më të madhe të vitit 2018.

Investimet jashtë vendit ulën ndjeshëm pjesëmarrjen në 73.0 përqind (89.8 përqind në

dhjetor 2017), ndërsa investimet brenda vendit rritën pjesëmarrjen në 27.0 përqind (10.2 përqind në dhjetor 2017) (figura 81). Në kuadër të investimeve brenda vendit, pjesëmarrja nga letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës vazhdon të jetë kategoria me peshën më të madhe, pasuar nga ajo e certifikatave të depozitit dhe parasë së mbajtur në vend.


Figura 81. Struktura e investimeve të sektorit pensional



Burimi: BQK (2019)

Pesha e letrave me vlerë u zvogëlua në 46.0 përqind (56.8 përqind në dhjetor 2017), ndërsa e certifikatave të depozitit u zvogëlua në 26.3 përqind (30.2 përqind në dhjetor 2017). Dinamikat në investimet në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës varen përveç se nga kërkesa, edhe nga shuma e ofruar e Qeverisë si dhe nga konkurrenca në ankande.

Figura 82. Kontributet e arkëtuara sipas fondeve pensionale



Burimi: BQK (2019)

Vlen të theksohet që në kuadër të investimeve brenda vendit tek kategoria e parasë së gatshme figuron një shumë prej 120.0 milionë euro, por e cila është e destinuar për investime jashtë vendit (para në tranzit).



Në dhjetor 2018, vlera e gjithsej aseteve të FSKP-së arriti në 7.0 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore prej 6.0 përqind (rritje për 9.8 përqind në dhjetor 2017). Arkëtimet e reja arritën vlerën në 515.3 mijë euro deri në dhjetor 2018, që përkon me një rritje vjetore prej 2.6 përqind e që përbën një rritje më të lartë se ajo e shënuar në vitin paraprak prej 2.6 përqind (figura 82).

**Pjesa më e madhe e aseteve të FSKP-së vazhdon të investohet jashtë vendit me 84.0 përqind të gjithsej aseteve.** Strategjia investive jashtë vendit përbëhet kryesisht nga investimet në formë të aksioneve (80.1 përqind), letrave me vlerë (19.3 përqind), dhe parasë së gatshme (0.6 përqind). Në anën tjetër, investimet në Kosovë rritën pjesëmarrjen e tyre në 16.0 përqind, nga 12.9 përqind në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Mundësitë e investimit në tregun e brendshëm janë deri diku të kufizuara andaj edhe investimet janë të shpërndara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (71.1 përqind), depozita (21.5 përqind) dhe para të gatshme (7.4 përqind).


### 6.1.1 Performanca financiare e sektorit pensional

**Sektori pensional shënoi performancë negative financiare në vitin 2018 si rezultat i kthimit negativ në investime, përderisa kontributet e reja vazhduan të rritën.** FKPK kishte kthim negativ prej 84.7 milionë euro gjatë vitit 2018 krahasuar me kthimin në investime prej 102.6 milionë euro në vitin 2017 (figura 83).

Për pasojë, FKPK mbylli ditën e fundit të vitit 2018 me çmim më të ulët të aksionit krahasuar me vitin paraprak. Konkretisht, çmimi i aksionit zbriti në 1.39 euro në krahasim me 1.46 euro në dhjetor 2017. Viti 2018 në tregjet financiare në SHBA u karakterizua si një vit i luhatjeve ekstreme. Indekset kyçe u karakterizuan me performancë pozitive gjatë gjithë vitit e veçanërisht në muajt shtator dhe tetor kur edhe arritën kthim pozitiv rekord nga investimet. Megjithatë, në dy muajt e fundit të vitit, indekset kyçe shënuan rënie të theksuar,

duke ndikuar që viti të mbyllet me rënie të përgjithshme.


Figura 83. Performanca financiare e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës



Burimi: BQK (2019)

Kjo rënie në fund të vitit u ndikua nga shitja e madhe e instrumenteve financiare nga investorët dhe tregtuesit e letrave me vlerë, nxitur nga pasiguritë si pasojë e mosmarrëveshjeve tregtare në mes SHBA-së dhe Kinës, indikacioneve për ngadalësim ekonomik global, rritjes së mëtutjeshme të normës bazë nga Rezerva Federale, pasiguritë lidhur me rritjen potenciale të inflacionit dhe gjendjes politike brenda SHBA-ve si dhe jashtë saj (ndikimi i BREXIT-it në Britaninë e Madhe dhe Evropë, si dhe ngadalësimi ekonomik i Kinës). Ekspozimi i lartë i sektorit pensional ndaj dinamikave të jashtme si pasojë e pjesëmarrjes së lartë të investimeve jashtë, u përkthye në kthimin negativ bruto nga investimet në fund të vitit 2018.

Figura 84. Performanca financiare e Fondit Sllloveno-Kosovar të Pensioneve



Burimi: BQK (2019)

**Ngjashëm, edhe FSKP shënoi kthim negativ nga investimet gjatë vitit 2018.** Në dhjetor 2018, kthimi bruto negativ nga

investimet arriti në -221.0 mijë euro, krahasuar me kthimin pozitiv prej 528.5 mijë euro deri në dhjetor 2017 (figura 84). Ndërsa, çmimi i aksionit të FSKP-së në ditën e fundit të vitit 2018 shënoi rënie në 1.21 euro krahasuar me 1.26 euro në vitin 2017.


## 6.2 Sektori i Sigurimeve

### 6.2.1 Aktiviteti i sektorit të sigurimeve

Viti 2018 në sektorin e sigurimeve u karakterizua me profitabilitet më të dobët dhe vlerë më të ulët të aseteve kundrejt vitit paraprak. Megjithatë, zhvillimet pozitive në kuadër të primeve bruto të shkruara i dhanë këtij sektori kapacitet absorbues ndaj performancës më të dobët gjatë këtij viti. Për më tepër, ndikuan edhe në rritjen modeste të ndërmjetësimit duke sugjeruar potencial për zhvillim të mëtutjeshëm.

Me një pjesëmarrje prej 2.8 përqind në gjithsej asetet e sistemit financiar, pjesëmarrje pothuajse e pandryshuar në pesë vitet e fundit, sektori i sigurimeve është sektori i katërt për nga madhësia. Niveli i ndërmjetësimit të sektorit (primet e shkruara bruto në raport me BPV-në)rezulton të ketë qenë në nivel prej 1.41 përqind, e që vlerësohet si relativisht i ulët megjithëse me një rritje marginale kundrejt vitit 2017. Po ashtu, niveli i densitetit, që paraqet primet e shkruara për kokë banori, gradualisht ka shënuar rritje ndër vite duke arritur në 51.2 euro në vitin 2018 (figura 85).

Figura 85. Indikatorët e zhvillimit të sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK (2019)

Ndërlidhja në mes sektorit të sigurimeve dhe segmenteve tjerë të sistemit financiar është

ende në nivel të ulët, gjë që minimizon mundësitë e shpërndarjes së rreziqeve në segmentet tjerë të sistemit financiar të Kosovës. Sektori i sigurimeve ka ekspozim më të lartë ndaj sektorit bankar, duke qenë se pothuajse gjysma e aseteve të këtij sektori mbahet në banka komerciale në formë të depozitave. Në këtë kontekst, stabiliteti dhe likuiditeti i sektorit bankar ka peshë të theksuar në operimin dhe stabilitetin e sektorit të sigurimeve dhe sektorëve tjerë në sistemin financiar në vend.

Figura 86. Asetet e sektorit të sigurimeve




Burimi: BQK (2019)

Struktura e sektorit të sigurimeve vazhdon të dominohet nga shërbimet e sigurimit 'jo-jetë' i cili përfaqëson 90.8 përqind të aseteve të tregut të sigurimeve, ndërsa pjesa e mbetur përbëhet nga asetet e siguruesve 'jetë'. Numri i siguruesve në vitin 2018 u zvogëlua si pasojë e tërheqjes nga tregu e një prej siguruesve 'jetë'. Rrjedhimisht, numri i siguruesve nga 15 u zvogëlua në 14 sigurues, prej të cilave 12 janë sigurues jo-jete dhe 2 sigurues 'jetë'.

Për dallim nga viti i kaluar, tregu i sigurimeve rezulton të ketë pasur ndarje të barabartë të numrit të siguruesve sipas pronësisë, megjithëse pjesëmarrje më të lartë në gjithsej asetet e sektorit vazhdojnë të kenë kompanitë me pronësi të huaj. Në vitin 2018, tërheqja nga tregu i njërit nga siguruesit 'jetë' rezultoi në rënie të pjesëmarrjes së aseteve të menaxhuara nga kompanitë me pronësi të huaj në 52.3 përqind (54.3 përqind në vitin 2017). Pjesëmarrje më të lartë në gjithsej asetet e sektorit të sigurimeve në vitin 2018 kishte Shqipëria, përderisa

Austria dhe Sllovenia zvogëluan pjesëmarrjen në gjithsej asetet e sektorit (figura 87).

Figura 87. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve, sipas pronësisë (Dhjetor 2018)



Burimi: BQK (2019)


**Tregu i sigurimeve në Kosovë karakterizohet me një koncentrim të ulët, që është parakusht për funksionalizimin e një konkurrence më të madhe në treg.** Indeksi i Herfindahl-it<sup>40</sup> i kalkuluar për primet e shkruara bruto për vitin 2018 tregon 870 pikë (për vitin 2017 ishte 875 pikë). Ndërsa, po i njëjti indeks i kalkuluar duke marr për bazë asetet e tregut të sigurimeve tregon vlera më të ulëta, përkatësisht 808 pikë për vitin 2018 nga 765 në vitin 2017. Në të njëjtën kohë, indeksi CR5<sup>41</sup> për vitin 2018, i llogaritur në raport me PSHB për sektorin e sigurimeve rezulton 52.8 përqind (2017 - 53.2 përqind), ndërsa i llogaritur në raport me asetet rezulton me 49.8 përqind (2017 - 47.7 përqind). Sipas sektorëve, koncentrimi është më i lartë tek sektori i sigurimeve jetë, kjo si rezultat i numrit më të vogël të siguruesve në këtë sektor.

Asetet e sektorit të sigurimeve në dhjetor 2018 zbritën në 175.7 milionë euro, duke shënuar rënie vjetore marginale prej 0.6 përqind (figura 88). Asetet e siguruesve 'jo-jetë' u rritën për 2.7 përqind, përderisa asetet në kuadër të sigurimit 'jetë' shënuan rënie vjetore prej 24.8 përqind.

Në rënien e asetëve të sektorit të sigurimeve ndikoi tërheqja nga tregu e një prej siguruesve

jetë gjatë vitit 2018. Në kuadër të asetëve, investimet në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës dhe të arkëtueshmet nga të siguruarit u karakterizuan me rritje, përderisa depozitat e mbajtura në bankat komerciale shënuan rënie.

Figura 88. Struktura e asetëve të sektorit të sigurimeve



■ Paraja e gatshme dhe depozitat  
 ■ Debitoret e primeve  
 ■ Asetet e paprekshme  
 ■ Shpenzimet e shtyera  
 ■ Asetet financiare  
 ■ Asetet fikse  
 ■ Asetet teknike nga ri-sigurimi  
 ■ Asetet tjera

Burimi: BQK (2019)

Paraja e gatshme dhe depozitat e mbajtura në bankat komerciale dhe BQK mbetet kategoria dominuese në bilancin e gjendjes së sektorit të sigurimeve me pjesëmarrje prej 52.3 përqind. Kjo strukturë e asetëve sugjeron se aktivi i siguruesve përmban përqindje të lartë të asetëve me likuiditet të lartë. Përderisa, struktura e investimeve të siguruesve, e cila vazhdon të jetë konservative, përbëhet nga investimet në letrat me vlerë të qeverisë së Kosovës e të cilat e rritën peshën në 13.2 përqind në dhjetor 2018 nga 11.9 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 88).

Në kuadër të detyrimeve dhe burimeve vetanake, rezervat teknike kryesojnë strukturën e përgjithshme. Provizionet teknike, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve të siguruesve gjatë vitit 2018, shënuan rritje vjetore prej 4.0 përqind. Kryesisht, rritja e rezervave teknike u ndikua pozitivisht nga rritja vjetore prej 5.6 përqind e provizioneve për prime të sektorit të sigurimeve jo-jetë. Po ashtu, rritje prej 17.8 përqind shënuan rezervat matematikore në krahasim me vitin 2017 (figura 89).


<sup>40</sup> Indeksi Herfindahl është llogaritur me formulën në vijim:  $HI = \sum_{i=1}^n n_i^2 / (s)^2$ , ku S pjesëmarrjen e kompanisë në gjithsej mjetet (primet e shkruara bruto)

e tregut të sigurimeve, n është gjithsej numri i institucioneve në sektorin përkatës.

Në qoftë se indeksi shtrihet ndërmjet intervaleve 1,000 – 1,800 njësi, niveli i koncentrimit në sektorin e sigurimeve konsiderohet i pranueshëm.

<sup>41</sup> Indeksi CR5 kombinon pjesëmarrjen në treg të 5 kompanive me vlerat më të larta të asetëve në raport me gjithsej asetet e sektorit dhe PSHB ndaj gjithsej PSHB të sektorit.


Figura 89. Detyrimet dhe kapitali i sektorit të sigurimeve (dhjetor 2018)



Burimi: BQK (2019)

Vlera e gjithsej kapitalit të siguruesve u zvogëlua për 6.1 përqind dhe zbriti në 44.0 milionë euro.

Figura 90. Primet bruto të arkëtuara



Burimi: BQK (2019)

Rënia e kapitalit i atribuohet rënies së kapitalit të siguruesve jetë si pasojë e tërheqjes nga tregu i njërit nga siguruesve të këtij profili dhe performancës më të dobët gjatë vitit 2018 të cilat u reflektuan në burimet vetanake përmes fitimit neto më të ulët të realizuar gjatë këtij viti. Përderisa, humbjet e akumuluar (vlera negative e fitimeve të mbajtura) u zvogëluan për 11.9 përqind.

Gjatë vitit 2018, vlera e primeve të shkruara nga siguruesit arriti në 92.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 6.2 përqind (figura 90). Struktura e primeve të shkruara kryesohet nga primet e sigurimit jo-jetë të cilat përfaqësojnë 96.8 përqind të gjithsej primeve të shkruara.

Në dhjetor 2018, këto prime arritën vlerën 89.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 5.8 përqind. Pjesa e mbetur e gjithsej primeve të shkruara përbëhet nga primet e sigurimit 'jetë', të cilat arritën në 3.0 milionë euro që paraqet vlerë më të lartë për 16.6 përqind.

**Produkti i cili dominon tregun e sigurimeve vazhdon të mbetet ai i Përgjegjësive ndaj Palës së Tretë.** Gjatë vitit 2018 produktet e sigurimeve të detyrueshme shënuan rritje prej 1.3 përqind, përderisa pjesëmarrja e tyre në gjithsej primet e shkruara bruto shënoi rënie në 61.7 përqind nga 64.4 përqind sa ishte në vitin 2017 (tabela 10). Rënia e pjesëmarrjes së sigurimeve të detyrueshme u ndikua nga produktet "MTPL" dhe "Sigurimet kufitare". Ndërsa, sigurimet vullnetare shënuan rritje prej 14.1 përqind, njëkohësisht edhe pjesëmarrja e tyre në gjithsej primet e shkruara bruto shënoi rritje në 38.3 përqind nga 35.5 përqind sa ishte në vitin 2017. Rritja e pjesëmarrjes së sigurimeve vullnetare në gjithsej primet e shkruara bruto u ndikua nga rritja e primeve për produktet si "Kredi dhe Garancione", "Kasko", "Sigurime në pronë", "Aksident dhe Shëndet" dhe produktet tjera që shënuan rritje të lehta (tabela 11).

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve, ku përfshihen dëmet e siguruesve dhe Byrosë Kosovare të Sigurimit (BKS), shënuan ngadalësim të rritjes vjetore në 5.0 përqind (17.9 përqind në vitin 2017), duke arritur në 48.3 milionë euro në vitin 2018.


Tabela 11. Primet e shkruara bruto sipas klasave të biznesit (në miliona euro)

Përshkrimi	2017	2018	Ndryshimi	Pjesëmarrja 2017	Pjesëmarrja 2018
Aksident dhe shëndet	17.0	18.0	6.1%	19.6%	19.6%
Sigurimet Kufitare	7.2	7.4	2.7%	8.3%	8.1%
Kasko	3.9	4.5	16.4%	4.4%	4.9%
Kredi dhe Garancione	2.5	3.6	43.7%	2.9%	3.9%
Sigurime në pronë	4.6	5.4	16.3%	5.3%	5.8%
Sigurime nga humbjet financiare	0.8	1.0	17.8%	1.0%	1.1%
Sigurimi i përgjegjësisë	1.1	1.6	42.6%	1.3%	1.7%
Marinë dhe transport	0.0	0.1	191.2%	0.0%	0.1%
MTPL	44.9	45.3	0.9%	51.7%	49.2%
TPL+	2.2	2.3	4.8%	2.5%	2.5%
Gjithsej Jo-jetë	84.2	89.1	5.8%	97.1%	96.8%
Gjithsej Jetë	2.5	3.0	16.6%	2.9%	3.2%
Gjithsej TREGU	86.7	92.1	6.2%	100.0%	100.0%

Burimi: BQK (2019)

Rritja e nivelit të dëmeve të paguara gjatë vitit 2018 u ndikua kryesisht nga pagesa e dëmeve në emër të produkteve të sigurimeve tjera vullnetare. Vetëm gjatë vitit 2018 shuma e dëmeve të paguara nga sigurimet vullnetare arriti në 16.0 milionë euro ose 8.3 përqind më shumë në krahasim me vitin paraprak 2017.

Figura 91. Primet e pranuar dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2019)

Për dallim nga sigurimet vullnetare, dëmet e paguara nga sigurimet e detyrueshme edhe pse me një pjesëmarrje më të madhe në gjithsej portofolin, gjatë vitit 2018 shënuan rritje prej 2.6 përqind. Kjo rritje në dëmet e paguara nga

sigurimet e detyrueshme u ndikua nga produkti “autopërgjegjësia e brendshme”.

Ndërsa, shuma e dëmeve të paguara nga sigurimet jetë zbriti në 552 mijë euro nga 777 mijë euro sa ishte në vitin 2017, duke shënuar rënie vjetore prej 28.9 përqind.

Rritja më e lartë e primeve të shkruara gjatë kësaj periudhe krahas rritjes më të vogël të dëmeve të paguara, rezultoi në rënie të raportit të gjithsej dëmeve të paguara ndaj primeve të shkruara (figura 91).

### 6.2.2 Performanca financiare e sektorit të sigurimeve

Përkundër rritjes së dëmeve të ndodhura, rritja e të hyrave neto nga primet dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve ndikuan që sektori i sigurimeve ta përmbyll vitin me rezultat pozitiv financiar, edhe pse më të ulët krahasuar me vitin paraprak. Fitimi i regjistruar në vitin 2018 ishte 1.6 milionë euro, krahasuar me fitimin prej 6.4 milionë euro në vitin 2017. Ky rezultat financiar pasqyron rritjen më të lartë të dëmeve të ndodhura (39.5 përqind) kundrejt rritjes së të hyrave neto nga primi (5.8 përqind), dhe njëkohësisht, rënies vjetore të shpenzimeve të sektorit prej 3.4 përqind. Në kuadër të këtij fitimi të realizuar, siguroesit jo-jetë operuan me fitim prej 1.0 milionë euro, ndërsa siguroesit jetë 0.6 milionë euro.

Indikator tjetër që tregon ngadalësimin e fitimit gjatë vitit 2018 është raporti i kombinuar në nivel prej 97.7 përqind nga 89.6 përqind në vitin 2017, e që nënkupton se tregu i sigurimeve për 1 euro të fituar ka shpenzuar 0.98 euro në krahasim me 0.90 euro në vitin paraprak. Ky raport përmban raportin e dëmeve ndaj të hyrave neto nga primet prej



50.6 përqind dhe raportin e shpenzimeve operative ndaj të hyrave neto nga primet prej 47.1 përqind, pa përfshirë të hyrat nga interesat e investimeve. .

Bazuar në Rregulloren për investimin e aseteve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike, si dhe investimin e kapitalit themeltar të siguruesve, siguruesit janë të detyruar të mbajnë asete të mjaftueshme në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike jo më pak se vlera bruto e provizioneve teknike, respektivisht matematike. Përmes kësaj rregulloreje përcaktohen afatet kohore të niveleve të arritjes së zbatueshmërisë së plotë të rregullores brenda periudhës tre vjeçare, për mbajtjen e aseteve në mbulim të provizioneve teknike, “ a) nga 1 janar 2017 deri më 31 dhjetor 2017 – 70 përqind b) nga 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018 – 85 përqind, dhe c) nga 1 janar 2019 deri më 31 mars 2019 – 100 përqind”. Treguesi i mbulueshmërisë së provizioneve teknike me asete likuide në vitin 2018 për sigurimet Jo-Jetë ishte në normën 100.6 përqind (120.6 përqind në vitin 2017) duke përmbushur kërkesën rregullatore prej 85 përqind të përcaktuar për vitin 2018. Ndersa treguesi i mbulueshmërisë së provizioneve teknike me asete likuide në vitin 2018 për sigurimet Jetë ishte në normën 137.4 përqind.


Rënia vjetore e aseteve likuide të sektorit (parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj) prej 3.1 përqind, krahas rritjes prej 4.0 përqind të rezervave teknike të sektorit të sigurimeve ndikuan në rënien e nivelit të likuiditetit. Raporti ndërmjet aseteve likuide ndaj rezervave u zvogëlua në 97.2 përqind në vitin 2018 nga 104.3 përqind sa ishte në vitin 2017, gjithashtu raporti ndërmjet aseteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve u zvogëlua në 87.3 përqind (91.3 përqind në vitin 2017).

### 6.3. Sektori mikrofinanciar dhe ndihmësit financiar

#### 6.3.1 Aktiviteti i sektorit mikrofinanciar

**Rritja e aseteve të sektorit mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së kredive bruto, aktivitet që financohet nga huamarrjet në sektorin e jashtëm.** Asetet e sektorit arritën vlerën 250.0 milionë euro në dhjetor 2018, që korrespondon me rritje vjetore prej 30.0 përqind (figura 92).

Figura 92. Asetet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2019)

Në tregun vendor operojnë 22 institucione mikrofinanciare,<sup>42</sup> nga të cilat 14 kanë pronësi të huaj dhe përfaqësojnë 93.6 përqind të gjithsej aseteve të sektorit.

Indeksi Herfindahl-Hirschman për asetet rezultoi me 1,376 pikë në dhjetor 2018 që paraqet rënie të koncentrimin nga periudha e njëjtë e vitit paraparak (1,489 pikë). Ndërsa, pjesëmarrja e aseteve të tri institucioneve më të mëdha në gjithsej asetet e sektorit u zvogëlua në 53.1 përqind nga 55.9 përqind sa ishte në dhjetor të vitit 2017.


**Struktura e aseteve të sektorit mikrofinanciar dominohet nga kreditë që përbëjnë 73.5 përqind të gjithsej aseteve të sektorit.** Kategoria e dytë më e rëndësishme për nga pesha janë lizingjet me pjesëmarrje prej 15.2 përqind (figura 93).

Krahas vitit paraparak, pesha e lizingjeve në gjithsej asetet e sektorit është rritur kundrejt rënies së lehtë të kategorisë së kredive. Sa i

<sup>42</sup> Këtu përfshihen edhe pesë institucione financiare jo-bankare që kryejnë aktivitete të kredidhënies, lizingut dhe faktoringut.

përket detyrimeve, aktiviteti i sektorit mikrofinanciar financohet kryesisht nga huamarrjet të cilat përbëjnë 75.2 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit, ndërsa vetëm financimi nga sektori i jashtëm përbëjnë 67.3 përqind të gjithsej detyrimeve dhe kapitalit.


Figura 93. Struktura e asetëve të sektorit mikrofinanciar në vitin 2018



Burimi: BQK (2019)

Gjatë vitit 2018, huamarrjet nga sektori i jashtëm vazhduan të njëjtin trend të vitit të kaluar. Vlera e huamarrjeve nga sektori i jashtëm arriti në 168.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 28.6 përqind (30.6 përqind në vitin 2017).

Figura 94. Kreditë e sektorëve ekonomik sipas maturitetit



Burimi: BQK (2019)


Vlera e gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar në dhjetor 2018 arriti në 183.8 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 27.7 përqind krahas rritjes prej 32.1 përqind në vitin e kaluar. Ky është vitit i katërt me radhë i rritjes dyshifrore të aktivitetit kreditues prej institucioneve mikrofinanciare. Kjo rritje e theksuar e kreditimit u mbështet nga rritja e burimit të financimit të

institucioneve mikrofinanciare, kryesisht nga sektori i jashtëm dhe nga rritja e kapitalit vetanak i ndikuar nga fitimi i vitit dhe fitimi i mbajtur.

**Gjatë këtij viti, institucionet mikrofinanciare u orientuan më shumë drejt kreditimit të ekonomive familjare, megjithëse edhe kreditimi ndaj ndërmarrjeve shënoi rritje.** Konkretisht, kreditë ndaj ekonomive familjare në dhjetor 2018 përfaqësuan 66.0 përqind të gjithsej kredive të sektorit mikrofinanciar dhe shënuan rritje vjetore prej 31.7 përqind. Sipas afatit të maturimit, kreditë e ekonomive familjare me afat maturimi 'mbi 2 deri në 5 vite' në vazhdimësi kanë rritur pjesëmarrjen dhe në vitin 2018 kishin një pjesëmarrje prej 53.4 përqind në gjithsej kreditë ndaj ekonomive familjare.

Kreditë ndaj ndërmarrjeve përfaqësojnë 34.0 përqind të gjithsej stokut të kredive. Në vitin 2018, kreditë për ndërmarrjet u karakterizuan me rritje vjetore prej 20.6 përqind, megjithëse kjo rritje rezultoi të jetë përgjysmuar krahasuar me vitin paraprak (44.1 përqind rritje vjetore në vitin 2017). Ngjashëm me kreditë e ekonomive familjare, kreditë e lëshuara për ndërmarrjet vazhdojnë të kenë kryesisht maturim 'mbi 2 deri në 5 vite' (figura 94).

Figura 95. Struktura e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik, dhjetor 2018



Burimi: BQK (2019)


**Struktura e kreditimit të ndërmarrjeve sipas veprimtarive ekonomike mbetet e ngjashme me periudhat paraprake.** Për dallim nga sektori bankar, ku kreditë për bujqësinë paraqesin kategorinë me pjesëmarrjen më të ulët, tek institucionet



mikrofinanciare bujqësia gëzon mbështetjen më të madhe duke përfaqësuar 26.4 përqind të gjithë kredive ndaj ndërmarrjeve. Kategoritë tjera me qasje të lartë në financim mikrofinanciar janë kreditë e destinuar për shërbime tjera dhe kreditë për sektorin e ndërtimitarisë (figura 95).

**Sa i përket ecurisë, kreditë për sektorin e industrisë regjistruan rritjen më të lartë vjetore.** Rritje të theksuar të kreditimit kishte edhe sektori i tregtisë, shërbimeve tjera dhe i bujqësisë, megjithëse me dinamikë më të dobët të rritjes (figura 96).

Figura 96. Rritja e kredive të sektorit mikrofinanciar ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




**Aktiviteti i lizingut në institucionet mikrofinanciare shënoi rritje të konsiderueshme.** Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar u rrit në 38.1 milionë euro, një rritje vjetore prej 43.2 përqind (figura 97). Kontributin më të madh në rritjen e gjithë lizingjeve e kishin lizingjet ndaj ndërmarrjeve, të cilat për herë të parë janë dhe kategoria dominuese, vlera e të cilave u rrit për 51.7 përqind krahasuar me vlerën deri në dhjetor 2017.

**Lizingjet për ekonomitë familjare kanë një pjesëmarrje prej 49.4 përqind në strukturën e përgjithshme të gjithë lizingjeve.**

Në kuadër të lizingjeve për ekonomitë familjare, lizingjet hipotekare, që përfaqëson kategorinë dominuese, shënuan rritje për 25.9 përqind nga rritja prej 8.0 përqind në vitin paraprak. Lizingjet tjera po ashtu regjistruan rritje vjetore prej 52.0 përqind në krahasim me rritjen prej 44.4 përqind një vit më parë.


Lizingjet për ekonomitë familjare vazhdojnë të dominohen nga lizingjet afatgjata ‘mbi 10 vite’ të cilat kanë pjesëmarrje prej 49.2 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘mbi 5 deri në 10 vite’ me pjesëmarrje prej 32.0 përqind.

Figura 97. Lizingjet e sektorit mikrofinanciar



Në kuadër të lizingjeve për ndërmarrjet, lizingjet tjera, të cilat edhe dominojnë lizingjet për ndërmarrjet, u karakterizuan me rritje prej 37.7 përqind, e që dhanë kontributin në rritjen e gjithë lizingjeve të ndërmarrjeve. Po ashtu, dhe lizingjet për pajisje shënuan rritje të theksuar prej 0.3 milionë euro në vitin 2017 në 2.3 milionë euro në fund të vitit 2018. Përderisa, lizingjet hipotekare vazhduan të shënojnë rënie, prej 25.1 përqind kryesisht për shkak të vlerës së vogël. Sipas maturitetit të lizingjeve për ndërmarrjet, pjesën më të madhe e përbëjnë lizingjet afatmesme ‘mbi 2 deri në 5 vite’ me pjesëmarrje prej 89.7 përqind, pasuar nga lizingjet me afat maturimi ‘deri në 1 vit’ me pjesëmarrje prej 5.5 përqind.


Figura 98. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



**Norma mesatare e interesit në kreditë e sektorit mikrofinanciar shënoi rënie gjatë vitit, duke arritur në 21.7 përqind në dhjetor 2018** (figura 98). Me rënie të normës mesatare të interesit në kredi u karakterizuan edhe sektori i ekonomive familjare edhe ai i ndërmarrjeve.

Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare u zvogëluua në 22.5 përqind në dhjetor 2018. Ndërsa, mesatarja e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve qëndroi në nivel prej 20.1 përqind (figura 98). Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve mban normën mesatare të interesit më të ulët prej 14.6 përqind, një rënie për 4.5 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të industrisë shënoi rënie për 2.2 pikë përqindje, duke qëndruar në 22.8 përqind në dhjetor 2018. Ndërsa, norma mesatare e interesit në kreditë ndaj sektorit të bujqësisë regjistroi rënie për 3.3 pikë përqindje (figura 99).


**Figura 99. Norma mesatare e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik**



### 6.3.2 Performanca e sektorit mikrofinanciar

**Sektori mikrofinanciar u karakterizua me performancën më të mirë financiare në gjashtë vitet e fundit, gjë që është reflektuar në rritjen e fitimit.** Në dhjetor 2018, profiti i realizuar arriti vlerën prej 9.7 milionë euro, krahasuar me profitin prej 7.4 milionë euro të vitit paraprak. Rritja e profitit ishte rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave në krahasim me rritjen që shënuan shpenzimet.


**Figura 100. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar**



Të hyrat e sektorit mikrofinanciar shënuan rritje prej 33.1 përqind krahasuar me 28.8 përqind në dhjetor 2017, kryesisht e ndikuar nga rritja e të hyrave nga interesi. Shpenzimet po ashtu shënuan rritje prej 33.7 përqind, për dallim nga rritja prej 17.9 përqind deri në dhjetor 2017 (figura 100). Të gjitha kategoritë e shpenzimeve u karakterizuan me rritje, mirëpo kontributin më të madh në rritjen e gjithësh shpenzimeve e kishin shpenzimet për personelin dhe ato administrative, që shënuan rritje prej 23.5 përqind.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit mikrofinanciar ka shënuar rritje marginale prej 0.4 pikë përqindje si rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat gjatë kësaj periudhe. Në dhjetor 2018, ky indikator qëndroi në 77.3 përqind nga 76.9 përqind në vitin paraprak.


**Figura 101. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar**



Profiti i realizuar deri në dhjetor 2018 ndikoi deri në një masë në përmirësimin e treguesve të profitabilitetit. Kthimi në Mesataren e

Aseteve (KMA) qëndroi në nivel të njëjtë me vitin e kaluar (4.3 përqind në vitin 2017), ndërsa Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK) në 17.3 përqind (16.6 përqind në vitin 2017) (figura 101).

Figura 102. Treguesitë e kualitetit të portofolios kreditore



**Sektori mikrofinanciar vazhdon të karakterizohet me nivel relativisht të ulët të kredive joperformuese dhe nivel të kënaqshëm të provizioneve për mbulimin e kredive joperformuese.** Në dhjetor 2018, pjesëmarrja e kredive joperformuese në gjithsej kreditë u zvogëlua në 2.2 përqind, në krahasim me normën prej 2.5 përqind sa ishte në dhjetor 2017. Mbulueshmëria me provizione u përmirësua për 35.7 pikë përqindje, duke arritur nivelin prej 226.0 përqind krahasuar me nivelin prej 190.3 përqind në dhjetor 2017 (figura 102).

**Sektori i ndihmësve financiar përbënë numrin më të madh të institucioneve financiare në vend, mirëpo menaxhon pjesën më të vogël të aseteve të sistemit financiar (0.2 përqind në dhjetor 2018).** Ky sektor përbëhet nga byrotë e këmbimit dhe agjensionet për transferim të parave (ATP). Vlera e aseteve të ndihmësve financiar në dhjetor 2018 arriti në 15.8 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 0.3 përqind. Të hyrat e ndihmësve financiar shënuan rritje vjetore prej 2.2 përqind duke arritur vlerën në 7.7 milionë euro. Struktura e të hyrave të ndihmësve financiar dominohet nga të hyrat nga transferet (pjesëmarrje 72.7 përqind në dhjetor 2018), të cilat u karakterizuan me rritje vjetore prej 3.6 përqind. Në anën tjetër, shpenzimet shënuan rritje vjetore prej 2.2 përqind duke arritur në 4.6 milionë euro. Si rrjedhojë, neto fitimi i realizuar nga këto institucione financiare gjatë vitit 2018 arriti në 3.1 milionë euro, ngjashëm me vitin e kaluar.

## 7. Infrastruktura Financiare në Kosovë

### 7.1. Sistemi i Pagesave

**Sistemet e pagesave luajnë rol të rëndësishëm në sistemin financiar dhe ekonominë e një vendi, duke marrë parasysh që funksionimi efikas dhe i sigurt i tyre paraqet një faktor shumë të rëndësishëm në ruajtjen dhe promovimin e stabilitetit financiar të vendit. Në Kosovë funksionon një sistem i vetëm për pagesa ndërbankare, Sistemi i Pagesave Ndërbankare (SPN), operuar dhe mbikëqyrur nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.**

Numri i transaksioneve të përpunuara nga ATS gjatë vitit 2018 arriti në 11.5 milionë (11.7 milionë në vitin 2017), duke shënuar rënie vjetore prej 2.1 përqind. Kurse, në të njëjtën periudhë, vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara arriti në 13.0 miliardë euro (11.6 miliardë euro në 2017), që paraqet një rritje vjetore prej 11.3 përqind. Pagesat prioritare -

masive dhe pagesat të rregullta masive në vitin 2018 kishin një pjesëmarrje të barabartë në gjithsej numrin e transaksioneve të realizuara ndërbankare (tabela 12). Pagesat prioritare masive përfaqësojnë rreth 4.6 milionë transaksione të realizuara (apo 40.2 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) janë kryesisht pagesa nga institucionet qeveritare (siç janë pagat dhe pensionet). Ngjashëm, pagesat masive të rregullta, përfaqësojnë rreth 4.6 milionë transaksione të realizuara (apo 40.2 përqind të gjithsej numrit të transaksioneve) dhe janë kryesisht pagesa në të cilat përfitues janë institucionet e qeverisë dhe përfshijnë pagesën e tatimeve, taksave, doganës etj. Ndërsa 0.6 milionë janë pagesat xhiro dedikuar kryesisht pagesave të shërbimeve publike (faturat e kompanive të shërbimeve publike, institucioneve qeveritare si shërbimi doganor dhe Agjensioni Kosovar i Pronave) (tabela 12).

**Tabela 12. Pjesëmarrja e instrumenteve të pagesave në gjithsej transaksionet e SPN-së, në përqindje**

Përshkrimi	Numri i gjithsej transaksioneve		Vlera e gjithsej transaksioneve	
	2017	2018	2017	2018
Të rregullta	12.1%	13.4%	11.2%	11.3%
Prioritare	0.9%	1.0%	35.0%	36.6%
Të rregullta - masive	36.0%	40.2%	5.9%	5.7%
Prioritare - masive	42.7%	40.2%	8.1%	8.1%
Pagesat giro	7.8%	5.0%	10.2%	9.1%
Letrat me vlerë	0.0%	0.0%	6.8%	6.4%
Debitim direkt	0.2%	0.0%	0.1%	0.0%
Bankë-bankë	0.1%	0.1%	22.8%	22.7%
Te kthyer	0.3%	0.1%	0.1%	0.1%

Burimi: BQK (2019)

Ndërsa sa i përket vlerës së transaksioneve, pagesat prioritare janë kategoria me pjesëmarrjen më të lartë në transaksionet e realizuara, dhe arritën vlerën në 4.7 miliardë euro, pasuar nga kategoria bankë – bankë, që arritën vlerën prej 2.9 miliardë euro në vitin 2018. Numri i gjithsej llogarive të vlefshme

bankare<sup>43</sup> në dhjetor 2017 arrin në 2.05 milionë, që paraqet një rritje vjetore prej 4.4 përqind.

Zhvillimi i infrastrukturës virtuale është duke u bërë me ritëm të shpejtë dhe të sigurt. Llogaritë bankare E-banking, përmes të cilave shërbimet bankare kryhen 'online', kanë

<sup>43</sup> Numri i gjithsej llogarive bankare përfshinë: numrin e llogarive rrjedhëse, të kursimit dhe të tjera në bankë.

vazhduar të rriten. Në dhjetor 2018 numri i gjithsej llogarive E-banking ishte 250.7 mijë<sup>44</sup> (tabela 13).

Numri i gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking gjatë vitit 2018 arriti në 4.4 milionë, ndërsa vlera e gjithsej transaksioneve të realizuara përmes llogarive E-banking arriti në 9.04 miliardë euro.

Struktura e llogarive E-banking vazhdon të dominohet nga llogaritë individuale me

pjesëmarrje prej 83.1 përqind të gjithsej llogarive E-banking, pasuar nga ato afariste me pjesëmarrje prej 16.9 përqind.

Numri i gjithsej kartelave (kartela debiti dhe krediti) që ofrojnë shërbime për tërheqje të parave të gatshme dhe pagesa të ndryshme u rrit për 8.7 përqind në vitin 2018. Në kuadër të kartelave, numri i kartelave me funksion debiti arriti në 1,011,888 kurse me funksion krediti në 173,471.

**Tabela 13. Rrjeti i sektorit bankar**

Përshkrimi	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018
Numri i degëve bankare	45	45	45	47
Numri i nëndegëve bankare	210	207	183	165
Numri i ATM-ve	540	522	512	491
Numri i POS-ve	9,705	10,589	11,501	13,183
Numri i llogarive 'e-banking'	187,297	230,905	301,841	250,733

Burimi: BQK (2019)

Numri i kartelave të debitit u karakterizua me rritje vjetore prej 9.3 përqind, përderisa kartelat e kreditit me rritje vjetore prej 5.3 përqind. Pjesëmarrjen më të lartë në kuadër të kartelave sipas operatorëve e kishin kartelat Visa (67.0 përqind) pasuar nga ato Master Card (31.4 përqind), kurse kartelat lokale kishin një pjesëmarrje prej 1.7 përqind. Infrastruktura bankare në vend është zgjeruar në kontekst të rrjetit së pajisjeve POS (angl. Point-of-Sale) përderisa numri i bankomatëve (angl. Automated Teller Machine: ATM) është zvogëluar krahasuar me dhjetor 2017 (tabela 13). Përkundër zvogëlimit të numrit të bankomatëve, numri i tërheqjeve përmes ATM-ve është rritur në 15.2 milionë (13.8 milionë deri në dhjetor 2017), me një qarkullim prej 2.4 miliardë euro (1.9 miliardë deri në dhjetor 2017) (tabela 13). Vlera e tërheqjes së

parave përmes ATM-ve ndaj gjithsej transaksioneve me kartela qëndroi në 58.9 përqind në vitin 2018, që tregon për nivel të lartë të përdorimit të parave të gatshme. Rritja e numrit të ATM-ve, të cilët mundësojnë depozitim të parave në llogaritë të klientëve, ka ndikuar që vlera e depozitimeve të rris pjesëmarrjen në 30.9 përqind të gjithsej vlerës së transaksioneve me kartela përmes terminaleve, nga 10.5 përqind sa ishte tri vite më parë (tabela 13). Në të njëjtën periudhë, numri i pagesave përmes pikave të shitjeve me kartela në терминалет POS arriti në 10.9 milionë në vlerë prej 393.8 milionë euro. Vlera e pagesave përmes POS ndaj gjithsej transaksioneve me kartela në vitin 2017 arriti në 9.8 përqind.

<sup>44</sup> Me hyrjen në fuqi të 'Rregullores për raportimin e statistikave të instrumenteve të pagesave' nga viti 2018 ka ndryshuar edhe metodologjia e raportimit të numrit të llogarive të qasshme (aksessueshme) nga interneti.

Ky numër paraqet numrin e llogarive rrjedhëse që kanë qasje në e-banking, kurse sipas metodologjisë së mëhershme kanë qenë të raportuara të gjitha llogaritë, duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, të kursimit dhe të afatizimit.

**Tabela 14. Pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve me kartela sipas terminaleve në gjithsej vlerën e transaksioneve me kartela, në përqindje**

Përshkrimi	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018
ATM tërheqje në para të gatshme	70.8%	63.4%	61.9%	58.9%
ATM depozitime	10.5%	26.5%	29.3%	30.9%
Kredit transfere nëpërmjet ATM	0.0%	0.0%	0.0%	0.1%
Tërheqje cash në terminale POS	1.2%	0.3%	0.2%	0.2%
Pagesa me kartela në terminale POS	17.5%	9.9%	8.5%	9.8%

Burimi: BQK (2019)

**Kutia 5. Korniza rregullative në funksion të stabilitetit financiar****Rregullorja për aktivitetin e Faktoringut**

Në kuadër të avancimit të sektorit financiar dhe aktiviteteve të tij, si dhe rritjes së mundësive për qasje në financa, BQK është angazhuar në përpilimin e rregullativës përkatëse për aktivitetin financiar të Faktoringut. Rregullorja për Faktoringun është miratuar nga Bordi i BQK-së me datë 29 tetor 2018. Të gjitha bankat që operojnë në Kosovë janë licencuar/regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë së faktoringut, përfshirë edhe një institucion financiarë jo-bankar i licencuar në Kosovë. Ushtrimi i veprimtarisë së faktoringut pritet të kontribuoj në qasjen në financa të segmentit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, i cili ballafaqohet me sfida të shumta në këtë aspekt. Faktoringu, duke iu mundësuar ndërmarrjeve, kryesisht tregtare, që të kenë qasje në financa bazuar në të hyrat e tyre të pritshme, do të rrisë mundësinë e këtyre ndërmarrjeve për qasje në financim afatshkurtër për përmbushjen e nevojave të tyre afatshkurtra për likuiditet, dhe rrjedhimisht do të mund të kontribuoj në stabilitetin e tyre financiar.

**Korniza ligjore dhe rregullative për rimëkëmbjen, përmbylljen dhe likuidimin bankar**

Në vitin 2018 BQK ka hartuar kornizën ligjore dhe rregullative të procesit të rimëkëmbjes dhe përmbylljes së bankave. Rregullimi fillimisht është bërë në kuadër të në Ligjit të Banka, i cili në kapitull të veçantë adreson rregullimin e procesit të rimëkëmbjes dhe likuidimit. Paralelisht punës në rregullimin e procesit të rimëkëmbjes dhe likuidimit bankar përmes Ligjit të Bankave, i cili pritet të miratohet gjatë vitit 2019, është punuar në draftimin e rregulloreve që rrjedhin nga pjesa e re në Ligjin e Bankave për rregullimin e procesit të rimëkëmbjes dhe likuidimit të bankave. Me draftimin e kornizës së re rregullative, të bazuar në

Direktivën Evropiane përkatëse, do të definohet në mënyrë adekuate procesi i plotë i rimëkëmbjes dhe likuidimit të bankave problematike, të cilat mund të bartin efekte negative në stabilitetin e sektorit financiar. BQK është gjithashtu në proces të përgatitjes së legjislacionit terciar - manualin operacional të rimëkëmbjes, përmbylljes dhe likuidimit-, për lehtësimin e operacionalizimit në nivel teknik të këtij procesi. Korniza e plotë rregullative për rimëkëmbjen, përmbylljen dhe likuidimin bankar, avancohet rregullimin bankar në nivel me vendet e rajonit dhe ato evropiane, si dhe do t'i shërbejë BQK-së si instrument shtesë në ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit.

**Korniza rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme**

Vlerësimi adekuat i pasurive të patundshme është faktorë shumë i rëndësishëm për monitorimin e rrezikut të kredisë në sektorin bankar marrë për bazë që pasuria e paluajtshme është forma mbizotëruese e kolateralit për kreditë e lëshuara, si dhe potencialin ekzistues për rritjen e kredive hipotekare. Andaj, informacioni adekuat për vlerën e pasurive të paluajtshme është aspekt kyç i veprimtarisë së sektorit bankar me implikime të rëndësishme për zhvillimin e sektorit si dhe stabilitetin e tij financiar. Gjatë vitit 2018, BQK ka vazhduar punën në projektin e filluar një vit më parë për rishikimin e kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme, në funksion të përditësimit të kërkesave për të përmirësuar praktikën e vlerësimit të pronave të paluajtshme nga ana e institucioneve financiare në përputhje me standardet e reja të Evropës (European Valuation Standards - EVS 2016). Në kuadër të këtij projekti, BQK është duke punuar në Rregulloren e re mbi Vlerësimin e Pronave të Paluajtshme, e cila do të zëvendësojë rregulloren aktuale duke avancuar rregullimin e kësaj fushe. Përmes rregullimit të Programit të licencimit të vlerësuesve të pronave të paluajtshme, si dhe përcaktimit të kërkesave dhe standardeve minimale që duhet të zbatohen nga



institucionet financiare të licencuara nga BQK-ja gjatë vlerësimit të pasurive të paluajtshme të cilat përdoret si kolateral për kreditë e lëshuara, do të kontribuohet në zhvillimin e kornizës së nevojshme në funksion të përmirësimit të cilësisë së vlerësimit të pronave të pajuatshme.

Zhvillimi i kornizës rregullative për vlerësimin e pronave të paluajtshme si dhe rregullimin e profesionit të vlerësuesve të pronave konform standardeve ndërkombëtare pritet të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së vlerësimit të pronave, si dhe në sigurimin e informacionit për monitorimin e rrezikut kreditor si dhe vlerësimin e akumulimit të mundshëm të rrezikut sistemik.

### **Korniza rregullative për sistemin e pagesave me rëndësi sistemike**

Qëndrueshmëria e infrastrukturës financiare është komponentë shumë e rëndësishme e sigurimit të stabilitetit financiar. Në kuadër të infrastrukturës financiare, vëmendja përqendrohet në veçanti në mbikëqyrjen e infrastrukturës financiare me rëndësi sistemike, për shkak të potencialit të saj në nxitjen e krizave sistemike dhe efekteve potenciale në mosfunksionimin e sistemit financiar dhe të ekonomisë në tërësi.

BQK gjatë vitit 2018 ka aprovuar Metodologjinë për Vlerësimin e Sistemeve të Pagesave me Rëndësi Sistemike. Ky dokument është përgatitur duke u bazuar në Parimet për Infrastrukturën e Tregut Financiar të publikuara nga Banka për Rregullime Ndërkombëtare<sup>45</sup> dhe Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve për Letra me Vlerë, në vitin 2012 si dhe në dokumentet përkatëse rregullative të Bankës Qendrore Evropiane për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e sistemeve të pagesave të rëndësisë sistemike. Implementimi i metodologjisë për vlerësimin e sistemeve të pagesave me rëndësi sistemike për pajtueshmëri me parimet e lartcekura është paraparë të filloj gjatë vitit 2019. Avancimi i kornizës rregullative dhe infrastrukturës së sistemeve të pagesave të rëndësisë sistemike, kontribon në rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të pagesave përmes garantimit të strukturave efikase në menaxhimin e rreziqeve të infrastrukturës së tregut financiar në përgjithësi dhe sistemit të pagesave në veçanti.

<sup>45</sup> Bank for International Settlements and International Organization of Securities Commissions. *Principles for financial market infrastructures*. April 2012, <https://www.bis.org/cpmi/publ/d106.pdf>



## 8. Korniza për Makroprudencë

Në vitin 2016, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore i cili mandaton BQK-në për përpilimin dhe implementimin e politikave për ruajtjen e stabilitetit financiar në vend, ka adaptuar Politikën për Makroprudencë, e cila tashmë është publikuar në faqen zyrtare të BQK-së.

Me qëllim të përforcimit të bazës ligjore të BQK-së në ushtrimin e mandatit për makroprudencë, draft ligji i ri për banka që pritet të aprovohet në vitin 2019, përcakton BQK-në si autoritetin e vetëm përgjegjës për mbikëqyrje makroprudenciale të bankave. Gjithashtu, ligji i ri i jap autoritet BQK-së të nxjerrë instrumente rregullative përkatëse.

### 8.1. Përmbledhje e zhvillimeve në tregues të zgjedhur të makroprudencës

Në vitin 2018, dinamikat e përgjithshme në tregues të zgjedhur të makroprudencës në Kosovë u karakterizuan me qëndrueshmëri, duke rezultuar në parametra lartë mbi kërkesat rregullative.

Përkundër zgjerimit të ndërmjetësimit financiar, konkretisht, rritjes dyshifrore të kreditimit, cilësia e portofolit kreditor të sektorit bankar vazhdoi të jetë e lartë dhe me trend përmirësimi. Pjesëmarrja e kredive jo-performuese (KJP) ndaj gjithsej kredive vazhdoi të ndjekë trend rënës, nivel që rezulton më i ulëti në nivel rajoni dhe nën mesataren e Bashkimit Evropian. Krahas ngritjes së cilësisë së portofolit kreditor, është shënuar rritje e normës së mbulueshmërisë së kredive jo-performuese me provizione për humbje nga kreditë, që tregon për mbrojtje të mirë të sektorit nga humbjet e mundshme nga kreditë.

Sektorit bankar në tërësi por edhe bankat sistemike në veçanti vazhdojnë të mbeten mirë të kapitalizuara dhe likuide në vitin 2018. Raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar dhe bankat sistemike qëndrojnë lartë mbi kërkesat rregullatore.

Kapitalizimi i mirë i sektorit bankar mbështetet edhe nga analiza e alokimit të kapitalit shtesë në raport me shkallën e rëndësisë sistemike të bankave.

Ngjashëm me treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, raporti i levës së gjithsej sektorit bankar dhe i bankave me rëndësi sistemike vazhdoi të mbetet mbi kërkesat minimale ligjore. Indikatorët e likuiditetit ishin në nivel të kënaqshëm, në veçanti raporti i mjeteve likuide ndaj detyrimeve afatshkurta që ishte mbi kërkesat rregullative. Koncentrimi i ekspozimeve të mëdha në sistem bankar qëndroi në nivel adekuat me tendencë uljeje.

Treguesit e profitabilitetit, në veçanti Kthimi në Mesataren e Kapitalit (KMK), qëndroi në nivel të lartë, përderisa hendeku Kredi/BPV (anglisht: *credit to GDP gap*) jep sinjale se sektori bankar në Kosovë ka hapësirë për zgjerim të mëtejshëm të aktivitetit kreditues në kuadër të kornizës së ambientit makro-financiar në të cilin vepron. Në dhjetor 2018, sektori bankar rezultoi të ketë pesë banka me rëndësi sistemike, përderisa rezultatet e analizës stres-test për këto banka në vazhdimësi sugjerojnë aftësi të kënaqshme të sektorit bankar për të përballuar situata ekstreme të ekspozimit ndaj rrezikut të tregut apo rrezikut të likuiditetit.

Edhe analiza e përgjithshme e treguesve të shëndetit të sektorit të sigurimeve, si indikatorë potencialisht të rëndësishëm për makroprudencën, sugjeron që stabiliteti financiar i Kosovës nuk kërcënohet nga sektori i sigurimeve, marrë parasysh peshën e vogël të sektorit në sistem financiar. Gjithashtu, ndërlidhja në mes të sektorit të sigurimeve dhe atij mikrofinanciar dhe segmenteve tjerë të sistemit financiar është ende në nivel të ulët, gjë që minimizon mundësitë e shpërndarjes së rreziqeve ndërmjet segmenteve të ndryshme të sistemit financiar të Kosovës.

### 8.2. Kapitali shtesë kundërciklik

Kapitali shtesë kundërciklik ka për qëllim forcimin e stabilitetit financiar përmes mbrojtjes së sektorit bankar ndaj humbjeve që mund të shkaktohen nga akumulimi i rrezikut

sistemik ciklik në një ekonomi, si dhe përmes ndikimit në sigurimin e qëndrueshmërisë së ofertës kreditore përgjatë gjithë ciklit financiar. Kapitali shtesë kundër-ciklik është pjesë e kornizës rregullative të Bazeli III dhe njëherit një ndër instrumentet kryesore të politikës makroprudenciale për të adresuar dimensionin ciklik të rrezikut sistemik.

Duke rritur kërkesat për kapital në kohën kur kreditimi është në fazën e rritjes përtej fundamentaleve të ekonomisë (rritet në shpejtësi më të madhe se sa bruto prodhimi i një vendi dhe perceptohet si rritje e tepërt e kreditimit), ky instrument synon rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit (solvencës së bankave) për të përballuar situatat e stresit financiar që mund të pasojnë nga akumulimi i rrezikut si rezultat i rritjes së tepërt të kreditimit. Njëherit, instrumenti, përmes lirim të rezervave të kapitalit të akumuluar në fazën e rritjes, ndikon në nxitjen e rritjes së kreditimit në periudha të stresit financiar, me qëllim të evitimit të bartjes së pasojave negative të rënies së kreditimit në gjithsej sektorin financiar dhe ekonominë e vendit.

Për llogaritjen e kapitalit shtesë kundër-ciklik, udhëzimet e Komitetit për Mbikëqyrje Bankare të Bazeli<sup>46</sup> sugjerojnë monitorimin e disa parametrave për vlerësimin nëse kreditimi është duke u rritur përtej fundamentaleve të qëndrueshme dhe rrjedhimisht është duke ndikuar në akumulimin e rrezikut sistemik. Krahas vlerësimit të parametrave sipas udhëzimeve përkatëse, autoritetet relevante duhet të gjykojnë relevancën e aplikimit të kërkesave kundër-ciklike të kapitalit.

BQK, në Politikën për Makroprudencë<sup>47</sup>, liston instrumentin e kërkesave kundër-ciklike të kapitalit si instrument të mundshëm të objektivit të ndërmjetëm të politikës makroprudenciale për zvogëlimin dhe parandalimin e rritjes së tepruar të kredive dhe të levës. Konform udhëzimeve të Bazeli, parametri kryesor për përcaktimin e normës së

KCK-së theksohet të jetë hendeku i kreditimit ndaj bruto produktit vendor (BPV) në Kosovë, krahas tregueseve të tjerë relevant që do të informojnë vendimin përfundimtar për aktivizimin e mundshëm të instrumentit.

Në vijim, paraqitet i ashtuquajtur i model për vlerësimin e kërkesës për kapital kundër-ciklik për sektorin bankar të Kosovës. Devijimi i raportit të kreditimit ndaj BPV-së nga trendi i tij afat-gjatë paraqet parametrin kryesor të modelit. Llogaritja e hendekut të kreditimit ndaj BPV-së bëhet duke u bazuar në udhëzimet e Bazeli si dhe praktikatat e unifikuara të bazuara në rekomandime, përmes filterit të njëanshëm Hodrik-Prezcott (parametri zbutës 400,000).

Hendeku i kreditimit është llogaritur në linjë me udhëzimet e Komitetit të Bazeli si dhe praktikatat e unifikuara të mënyrës së kalkulimit nga shumica e vendeve në botë, të bazuara në rekomandime nga hulumtimet empirike. Në kreditim janë përfshirë kreditet ndaj sektorit privat<sup>48</sup> nga bankat si dhe institucionet financiare jo bankare. Këto të fundit, megjithëse në pjesëmarrje të ulët në gjithsej kreditimin, janë duke u rritur më normë të lartë të rritjes dhe duke zgjeruar pjesëmarrjen në sektorë të caktuar. Andaj, përfshirja e kredive të sektorit jo bankar përkundër që ka pjesëmarrje të ulët dhe aktualisht pa ndonjë efekt në rezultat të hendekut të kreditimit, siguron konsistencë në mënyrën e llogaritjes me vendet tjera, si dhe siguron që të përfshihen efektet e rritjes së mundshme të peshës së kreditimit ndaj sektorit privat nga institucionet financiare jo bankare.

Rezultatet e hendekut të kreditimit në fund të vitit 2018 sugjerojnë që sektori privat në Kosovë asnjëherë nuk ka kaluar nëpër periudhë të 'mbi kreditimit'. Ky rezultat përkon me faktin që sektori financiar në Kosovë është ende në fazë të zhvillimit dhe ekonomia e Kosovës është në fazën e rritjes së


<sup>46</sup> Banka për Ndërmjetësime Ndërkombëtare (2010). Udhëzimet për autoritetet nacionale që operojnë shtesën e kapitalit kundër-ciklik, Komiteti për Mbikëqyrje Bankare i Bazeli, dhjetor.

<sup>47</sup> BQK (2018). *Politika për Makroprudencë, Prishtinë, qershor*.

<sup>48</sup> Mospërfshirja e kredive të sektorit publik dhe kredive ndaj ndërmarrjeve financiare në llogaritjen e hendekut të kreditimit siguron që dinamikat në kreditim nuk ndikohet nga ndryshime të mundshme në kreditimin e sektorit publik apo sektorin financiar.

ndërmjetësimit financiar dhe konvergimit me vendet tjera.

Figura 103. Hendeku i kreditimit




Sidoqoftë, rritja më e shpejtë e kreditimit në raport me BPV-në në vitet e fundit ndikoi që në vitin 2018 hendeku i kredisë ndaj BPV-së të kaloj lehtësisht në rrafshin pozitiv (figura 103). Raporti i kredisë së sektorit privat ndaj BPV-së në Kosovë në dhjetor 2018 qëndroi në 44.6 përqind, përderisa mesatarja e këtij raporti në rajon qëndron mbi 50 përqind.

Kalkulimi i kapitalit të nevojshëm shtesë është bërë sipas udhëzimeve përkatëse nga Komiteti i Bazelit me ç' rast kërkesa për kapital shtesë (në përqindje të aseteve të peshuara me rrezik) është zero atëherë kur hendeku është më i vogël se 2 pikë përqindje, dhe me rritjen e hendekut mbi vlerën 2 deri në 10 pikë përqindje kërkohet mbajtje e kapitalit shtesë deri në nivelin maksimal 2.5 përqind. Sipas rezultateve të mësipërme, që sugjerojnë se Kosova sapo ka tejkalar lehtësisht në hendek pozitiv ndaj BPV-së dhe se vazhdon të jetë ende në periudhë graduale të thellimit të ndërmjetësimit financiar për të arritur së paku nivelin e vendeve të rajonit, deri më tani nuk janë paraqitur asnjëherë nevojat për kërkesë të mundshme të kapitalit kundër-ciklik (figura 104).

Duhet theksuar se në vlerësimin përfundimtar të nevojave për kapital shtesë kundër-ciklik me qëllim të përdorimit të instrumentit si mjet të Politikës makroprudenciale në të ardhmen, duhet të konsiderohen fuqia e treguesit të hendekut të Kreditimit në sinjalizimin e ciklit të biznesit dhe akumulimin e rrezikut

sistemik, që për rastin e Kosovës është në një masë të limituar për shkak të historikut të shkurtër të sektorit bankar (serisë kohore të shkurtër si dhe njëtrajtshmërisë së zhvillimeve pa ndonjë periudhë të stresit financiar).

Figura 104. Kapitali shtesë kundër-ciklik



Andaj, në këtë kontekst, duhet të analizohen treguesit shtesë dhe në masë të madhe të përdoren të dhënat kualitative dhe gjykimi i profesionistëve të fushës për vendimmarrjen në përdorimin e mundshëm të këtij instrumenti.


Në këtë kontekst, indikatorë tjerë relevant monitorohen në baza të rregullta krahas hendekut të kreditimit, të cilëve së bashku me informacionet kualitative dhe gjykimin e ekspertëve relevant, iu alokohet peshë e veçantë në formimin e gjykimit përfundimtarë rreth zhvillimeve në fushën e rrezikut sistemik dhe raportit të kredisë ndaj BPV-së. Këta indikatorë, ndër tjera, përfshijnë dinamikën e rritjes kreditore të përgjithshme dhe rritjen në sektorë specifik, ekspozimet kreditore në sektorë të veçantë, raportin e kredisë ndaj kolateralit, raportin e borxhit ndaj të hyrave, etj.

### 8.3. Bankat me rëndësi sistemike

Modeli për identifikimin e bankave me rëndësi sistemike paraqet një vegël të rëndësishme për vlerësimin e vazhdueshëm të dimensionit strukturor dhe ndërsektorial të rrezikut sistematik që ndërlidhet me bankat me rëndësi sistemike.

Rezultatet e përgjithshme të modelit, me të dhëna të muajit dhjetor 2018, sugjerojnë që pesë banka janë me rëndësi të përgjithshme sistemike (figura 105).

Figura 105. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike



Burimi: BQK (2019)

Tabela 15. Indikatorët e përdorur për vlerësimin e rëndësisë sistemike të bankave në Kosovë<sup>49</sup>

Kriteri	Indikatorët
<b>Madhësia (pesha 25%)</b>	Asetet (pa provizione)
<b>Zëvendësueshmëria (pesha 25%)</b>	Vlera e transaksioneve në raport me gjithsej vlerës së transaksioneve të sektorit përmes sistemit të pagesave Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj ekonomive familjare Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave jo-financiare Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e ekonomive familjare
<b>Ndërlidhshmëria (pesha 25%)</b>	Pjesëmarrja në gjithsej kreditë ndaj korporatave tjera financiare dhe plasmaneve në bankat tjera (duke mos përfshirë bankat amë) Pjesëmarrja në gjithsej depozitat e korporatave tjera financiare dhe huazimeve tjera (duke përfshirë edhe depozitat e bankave tjera) Pjesëmarrja në letrat me vlerë
<b>Aktiviteti ndërshtetëror dhe Kompleksiteti (pesha 25%)</b>	Kërkesat ndaj sektorit të jashtëm Detyrimet ndaj sektorit të jashtëm Pjesëmarrja e zërave jashtë-bilancor

Burimi: BQK (2019)


Tri nga këto banka kanë rezultuar me rëndësi sistemike në të gjitha kriteret. Rezultatet po ashtu tregojnë që një bankë e cila nuk ka rëndësi të përgjithshme sistemike ka rezultuar e rëndësishme sistematikisht në kriterin e ndër lidhshmërisë. Shkalla e përgjithshme e rëndësisë sistemike shtrihet nga 1,072 pikë bazë deri në 2,198 pikë bazë, që paraqet rënie në krahasim me vitin 2017. Një nga bankat e cila në vazhdimësi është ndodhur në kufi të rëndësisë sistemike, këtë vit ka shënuar rritje të pikëve sistemike duke kaluar kufirin sistematik, si rezultat i rritjes së aseteve të përgjithshme si dhe ekspozimeve dhe detyrimeve me institucionet tjera financiare.

Ndërsa, kufiri i sipërm i pikëve sistemike ka shënuar rënie si rezultat i rritjes së konkurrencës nga bankat më të vogla të cilat rritën peshën e tyre në gjithsej asetet dhe

kreditë e sektorit, gjë që ka ndikuar në rënien e pikëve sistemike për bankat më të mëdha.

*Kriteri i madhësisë* –Pesë bankat të cilat kanë rëndësi të përgjithshme sistemike, rezultuan të rëndësishme sistematikisht në kriterin e madhësisë (figura 106).

Figura 106. Kriteri i madhësisë



Burimi: BQK (2019)


<sup>49</sup> Për bazën teorike dhe metodologjinë e plotë të vlerësimit të Bankave me Rëndësi Sistemike, shih Materialin Studimor nr. 7 të BQK-së me titull

'Identifikimi i Bankave me Rëndësi Sistemike dhe Kapitalit Shtesë në Kosovë'.

Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,016 pikë bazë në 2,190 pikë bazë. Dy nga bankat më të mëdha u karakterizuan me rënie të rëndësisë sistemike në këtë kriter krahasuar me vitin paraprak. Ndërsa, bankat më të vogla kanë përsheptuar rritjen e aktivitetit të tyre, theksuar aktivitetin kredihënës, duke rritur pjesëmarrjen e aseteve krahasuar me vitin paraprak, ndaj dhe kanë shënuar rritje të pikëve sistemike në këtë kriter.

*Kriteri i zëvendësueshmërisë* – katër banka me rëndësi të përgjithshme sistemike rezultuan sistemikisht të rëndësishme në kriterin e zëvendësueshmërisë. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,420 pikë bazë në 2,398 pikë bazë (figura 107).

Figura 107. Kriteri i zëvendësueshmërisë




Shumica e bankave kanë shënuar rritje të shkallës sistemike në këtë kriter. Ndërsa dy nga bankat sistemike kanë shënuar rënie të pikëve, njëra të ndikuar kryesisht nga rënia e stokut të kredisë dhe depozitave të ekonomive familjare, ndërsa banka tjetër për shkak të rënies së pjesëmarrjes si rezultat i rritjes më të ngadalshme në raport me bankat më të vogla.

*Kriteri i ndërlidhjes* – Ky kriter karakterizohet me luhatjet më të mëdha ngase bankat mund të ndërrojnë me lehtësi bilancin e tyre ndaj institucioneve financiare, si dhe investimet në letrat me vlerë. Në dhjetor 2018, me rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhjes rezultuan pesë banka, për dallim nga tri sa ishin në dhjetor 2017 (gjashtë në dhjetor 2016). Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,047 pikë bazë në 1,680 pikë bazë (figura

108). Një bankë e cila nuk ka rëndësi të përgjithshme sistemike, vazhdon të ketë rëndësi sistemike në kriterin e ndërlidhjes për shkak të pjesëmarrjes më të lartë të detyrimeve ndaj institucioneve tjera financiare.

Figura 108. Kriteri i ndërlidhjes




Sidoqoftë, këtë vit shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter ka shënuar rënie, që nënkupton që bilanci i aseteve dhe detyrimeve me institucione tjera financiare, si dhe investimet në letra me vlerë kanë shënuar rënie të përqendrimit duke u shpërndarë në mënyrë më të barabartë ndërmjet bankave krahasuar me vitin paraprak.

*Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe i kompleksitetit* – Tri nga pesë bankat e rëndësisë së përgjithshme sistemike kanë rezultuar të jenë me rëndësi sistemike në kriterin e aktivitetit ndërshtetëror. Shkalla e rëndësisë sistemike në këtë kriter shtrihet nga 1,776 pikë bazë në 2,868 pikë bazë (figura 109).

Krahasuar me vitin paraprak, shkalla e rëndësisë sistemike ka shënuar rënie si rezultat i rënies së kërkesave ndaj sektorit të jashtëm nga banka me pjesëmarrjen më të lartë në këtë kategori.

Duhet theksuar se sektori ka dëshmuar ndër vite që është mjaftë mirë i kapitalizuar dhe aplikimi i shtesave të kapital për rëndësinë sistemike, mbi kapitalin e klasit të parë siç rekomandohet nga Bazeli dhe ABE, nuk do të tejkalonte nivelin aktual të kapitalit për sektorin bankar në Kosovë.

Figura 109. Kriteri i aktivitetit ndërshtetëror dhe kompleksitetit



Andaj, modeli aktualisht shërben vetëm për monitorimin e dinamikës së rëndësisë sistemike dhe mbikëqyrjen më të informuar dhe adekuate të institucioneve konform rëndësisë së tyre sistemike, dhe nuk paraqet rekomandim për aplikim të shtesës së kapitalit për institucione me rëndësi sistemike vendore.

## 9. Shtojca Statistikore





Shtojca 1. Harta e Stabilitetit Financiar - Dinamika e ndryshimit të rrezikut të treguesve dhe kontributi në rrezik nga komponentët përkatës

Figura 1. Ekonomia e jashtme




Figura 2. Ekonomia e brendshme




Figura 3. Ekonomitë familjare






Figura 4. Sektori i ndërmarrjeve




Burimi: BQK (2019)

Figura 5. Sektori qeveritar




Burimi: BQK (2019)

Figura 6. Struktura e sektorit bankar




Burimi: BQK (2019)

Figura 7. Kapitalizmi dhe profitabiliteti



Burimi: BQK (2019)

Figura 8. Likuiditeti dhe financimi



Burimi: BQK (2019)

Tabela 1. Indikatorët e qëndrueshmërisë financiare, në përqind

Sektori bankar	Grupi bazë i indikatorëve	Dhjetor 2015	Dhjetor 2016	Dhjetor 2017	Dhjetor 2018
<b>Mjaftueshmëria e kapitalit</b>	Kapitali rregullativ ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	19.0	17.9	18.1	17.0
	Kapitali i klasit të parë ndaj asetëve të peshuara ndaj riskut	16.7	15.9	16.2	15.5
	Kreditë jo-performuese neto ndaj kapitalit	3.0	2.2	1.2	1.5
<b>Cilësia e asetëve</b>	Kreditë joperformuese ndaj totalit të kredive	6.2	4.9	3.1	2.7
<b>Shpërndarja sektoriale e kredive ndaj totalit të kredive</b>	Korporatat tjera financiare	0.4	0.4	0.2	0.2
	Korporatat publike jofinanciare	0.03	0.00	0.00	0.00
	Korporatat tjera jofinanciare	65.6	63.9	63.6	63.4
	Ekonomitë familjare	33.9	35.7	36.2	36.3
	OJSHEF	0.01	0.02	0.01	0.01
	Jo-rezidente	0.02	0.02	0.02	0.01
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0
<b>Profitabiliteti</b>	Kthimi në asete (KNA)*	2.5	2.4	2.8	2.3
	Kthimi në kapital (KNK)*	21.6	19.9	22.1	18.3
	Margjina e interesit ndaj të hyrave bruto	75.8	68.1	65.1	78.4
	Shpenzimet e jo-nteresit ndaj të hyrave bruto	51.6	49.6	45.3	48.2
<b>Likuiditeti</b>	Asetet likuide (bazë) ndaj totalit të asetëve	24.2	26.3	25.4	29.0
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj totalit të asetëve	29.2	31.7	30.1	23.8
	Asetet likuide (bazë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	30.9	34.5	32.2	32.2
	Asetet likuide (baza e gjërë) ndaj detyrimeve afatshkurtëra	37.3	41.5	38.2	40.0
<b>Senzitiviteti ndaj riskut të tregut</b>	Pozicionet neto të hapura në valutë të huaj ndaj kapitalit	1.8	4.4	1.2	3.8
<b>Grupi i zgjeruar i indikatorëve</b>					
	Kapitali ndaj asetëve	12.2	12.1	12.6	12.2
	Ekspozimi kreditor ndaj kapitalit	63.5	66.9	81.7	65.9
	Shpenzimet e personelit ndaj shpenzimeve nga jointerеси	36.8	36.4	40.3	44.0
	Dallimi në mes të normës së interesit për kredi dhe depozita	6.5	6.0	5.5	4.5
	Depozitat e klientëve ndaj totalit të kredive (jo ndërbankare)	130.3	125.8	119.5	122.8
	Detyrimet në valutë të huaj ndaj gjithsej të detyrimeve	3.7	4.1	3.9	5.0

\*Janë konsideruar të hyrat neto para taksës.

Udhëzuesi: Financial Soundness Indicators, Compilation Guide, IMF (2006)



Rruga Garibaldi, Nr.33, Prishtinë,  
Republika e Kosovës  
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763  
Web: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)